



**Instituti i Kosovës për Drejtësi**

# **LUFTIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË, PRIORITET NË LETËR**

**Prishtinë, dhjetor 2015**

**Autorë:** Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

**Juristë dhe monitorues:** Genc Nimoni, Adem Krasniqi, Valdet Hajdini, Erlina Tafa, Arbelina Dedushaj, Diana Berisha

**Monitoruese:** Hyrije Mehmeti, Bukurezë Surdulli, Gita Lushi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

### **RRETH IKD**

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë

IKD

Objekti C2, Hyrja II, Kati IV, Nr. 8

Rr. Hajdar Dushi

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
II.	METODOLOGJIA .....	9
III.	HETIMET PËR RASTET E KORRUPSIONIT - PP.....	11
	a) Performanca e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës .....	17
	b) Profili i ndjekjes së korrupsionit .....	21
	c) Ndjekja e profilit të lartë të korrupsionit në periudhën (1 janar – 30 shtator 2015).....	25
	d) Performanca e Prokurorive Themelore të Republikës së Kosovës .....	30
	e) Performanca e kallëzimeve penale të parashtruesve të ndryshëm.....	40
IV.	ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT: ZGJIDHJA E RASTEVE TË REGJISTRUARA DERI MË 4 NËNTOR 2013 .....	45
	a) Krahasimi i rasteve të zgjidhura të korrupsionit mes vitit 2014 dhe nëntë mujorit të vitit 2015.....	48
V.	HETIMET PRELIMINARE NË RASTET E KORRUPSIONIT - PPN .....	49
	a) Rastet e korrupsionit të iniciuara prej raporteve të mediave, shoqërisë civile.....	50
VI.	RASTET E PAZGJIDHURA TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL MË 30 SHTATOR 2015.....	52
VII.	DËSHTIMET E PROKURORËVE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË KORRUPSIONIT .....	56
VIII.	LLOGARIDHËNIA E PROKURORËVE.....	77
	a) Dështimet në Mekanizmin Përcjellës për rastet e korrupsionit.....	77
	b) Hetimet disiplinore ndaj prokurorëve si rezultat i gjetjeve të monitorimit të IKD-së.....	81
IX.	MONITORIMI I PROCESVE GJYQËSORE NË RASTET E KORRUPSIONIT .....	83
	a) Analiza e rasteve të monitoruara për periudhën tre mujore (1 korrik – 30 shtator 2015) .....	84
	b) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore .....	86

c)	Kohëzgjatja e rasteve të korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit (10 raste të monitoruara nga IKD) .....	98
d)	Dënimet për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës KGJK (nëntë mujori 2015).....	102
X.	KONFISKIMI I PASURIVE TË FITUARA PËRMES VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT .....	105
XI.	REKOMANDIMET .....	107

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrupsioni vazhdon të mbizotëroj në shumë fusha dhe është shqetësim i madh për popullin e Kosovës. Indeksi i perceptimit të korrupsionit në Kosovë sipas Amnesty International është 2.9, dhe klasifikohet si nivel i korrupsionit të “shfrenuar”. Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, ka raportuar gjithashtu se “Kosova mbetet tolerante ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet, që nënkupton se rrezikun i të qenurit (apo edhe është aktualisht) “shtet i kapur” është i lartë 3P.<sup>1</sup> Përtej këtij perceptimi, lufta kundër korrupsionit në Kosovë vazhdon të mbetet prioritet absolut për të gjitha institucionet shtetërore. Kjo luftë është shndërruar në retorikë politike nga paria udhëheqëse e Kosovës, drejtuesit e institucioneve të drejtësisë, përfshi edhe udhëheqësit ndërkombëtarë të Misionit të EULEX-it. Fatkeqësisht, përtej kësaj retorike nuk ka pasur vullnet dhe rezultate konkrete për të luftuar korrupsionin në Kosovë, sidomos korrupsionin e profilit të lartë. Mungesa e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit nga institucionet përgjegjëse, është bërë pengesë në rrugën drejt integritit evropian. Kosova, mbetet vendi i vetëm në rajon që nuk ka liberalizim të vizave. Qytetarët e Kosovës, mbesin të vetmit në Evropë që iu kufizohet e drejta e lëvizjes, për shkak të dështimit të politikës dhe sistemit të drejtësisë për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me mandatin me të cilin janë zgjedhur apo emëruar.

Republika e Kosovës nuk vuan nga mungesa e ligjeve dhe politikave për të luftuar korrupsionin. Vuan nga ndikimet politike në sistemin e drejtësisë, të cilat lidhen me mungesën e vullnetit për të përkrahur sistemin gjyqësor dhe prokurorial me resurse të mjaftueshme buxhetore, që ua mundësojnë ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur. Faktor i rëndësishëm pse mungojnë rezultatet në luftimin e korrupsionit mbetet mungesa e llogaridhënies dhe instalimi i kulturës së pandëshkueshmërisë.

IKD si rezultat i monitorimit të performancës së sistemit prokurorial dhe sistemit gjyqësor në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka gjetur se përkundër miratimit të ligjeve dhe risive në drejtësinë penale, politikave adekuate për luftimin e korrupsionit, të njëjtat nuk gjejnë zbatim në praktikë. Trendi i rasteve të pazgjidhura të korrupsionit nëpër prokurori shënon në rritje. Derisa më 4 nëntor 2013 ishin 516 raste të korrupsionit të pazgjidhura me 1682 persona, më 30 shtator 2015 ky numër është rritur në 636 raste të pazgjidhura me 1753 persona. Ky trend dëshmon mungesën e vullnetit praktik për të trajtuar rast e korrupsionit me prioritet absolut. Luftimi i korrupsionit mbetet vetëm përkushtim dhe vullnet në letër. Prej 4 nëntorit 2013 deri më 30 shtator 2015, Prokuroritë Themelore dhe PSRK, kanë pasur në punë 1334 raste me 3308 persona, prej tyre i kanë zgjidhur 766 raste me 1757 persona. Karakteristikë e këtyre rasteve është mënyra e zgjidhjes së tyre nga prokuroritë. Nga numri prej 1757 personave, ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, vërehet numër i madh i mbylljes së rasteve ndaj personave të dyshuar për korrupsion. Nga 1757 persona që kanë qenë subjekt të

---

<sup>1</sup>Ndihma e Bashkimit Evropian për Kosovën lidhur me Sundimin e Ligjit. Gjykata Evropiane e Auditorëve. Raport Special. Nr. 18, 2012. Shih linkun [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12\\_18/SR12\\_18\\_EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF)

procedurave penale për korrupsion, ndaj 882 personave rastet janë mbyllur nëpër prokurori. Respektivisht, prokuroritë gjatë kësaj periudhe kohore kanë ngritur aktakuza ndaj 875 personave, kanë hudhur kallëzimet penale ndaj 476 personave dhe kanë pushuar hetimet ndaj 406 personave. Numri i madh i rasteve të mbyllura nëpër prokurori, dëshmon disa anë të medaljes, se sistemi i drejtësisë në Kosovë i persekuton qytetarët e saj, ose sepse mungon ekspertiza dhe profesionalizmi i zyrtarëve që iniciojnë dhe hetojnë rastet e korrupsionit, apo institucionet e drejtësisë në Kosovë janë nën presion të lartë nga faktori vendor dhe ndërkombëtar për të treguar rezultate dhe nën këtë presion iniciojnë numër të madh të procedurave penale, të cilat në fund përfundojnë me mbyllje të rasteve dhe shkelje të drejtave dhe lirive të qytetarit. Gjatë kësaj periudhe IKD ka identifikuar 62 raste të korrupsionit të parashkruara, ndërsa vetëm në gjashtë muajt e fundit të monitorimit të prokurorive, janë identifikuar 12 raste të parashkruara.

Ndjekja e profilit të lartë të korrupsionit vazhdon të mbetet sfida kryesore e sistemit prokurorial. Mungesa e vazhdueshme e rezultateve për vite tëra dhe zbatimi i drejtësisë selektive në raste të caktuara në ndjekjen e personave të fuqishëm ka ndikuar në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial. Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e Prokurorit të Shtetit në periudhën mars - shtator 2015 ka shënuar rënien më të madhe të të gjitha kohërave me vetëm 12.8%.

IKD për dështimet më të mëdha në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë ia faturon EULEX-it, i cili deri në qershor 2014 ka udhëhequr me PSRK dhe ka pasur kompetenca ekskluzive në këtë fushë. Kjo natyrisht nuk i amnistion prej përgjegjësisë prokurorët vendorë në PSRK. Performanca e këtyre prokurorëve në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, rezulton se është minimale, pasi të njëjtit kanë arritur të përmbushin normën orientuese vjetore vetëm 13.26 për qind. Prej 1 janarit 2015 deri më 30 shtator 2015, PSRK ka zgjidhur raste ndaj 62 personave, prej tyre ndaj 51 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 6 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 5 personave ka pushuar hetimet. Prej këtyre rasteve, IKD ka gjetur se PSh ka bërë publikimin e informacioneve për këtë periudhë për ngritjen e aktakuzave vetëm në pesë raste, ku të përfshirë në bazë të pozitive janë: një (1) ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, një (1) ish-Kryetar Komune, një (1) ish-Sekretar i Përgjithshëm, 18 zyrtarë komunalë, gjashtë (6) pronar të kompanive, një (1) drejtor, një (1) drejtor instituti, tre (3) menaxherë, dy (2) zyrtar dhe një rast ndaj personave që ndërlidhet me dyshimet për keqpërdorime në ish-Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit. Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit, IKD ka gjetur se PSh në publikimin e informatave dhe në informimin e publikut zbaton drejtësi selektive, duke aplikuar standarde të dyfishta për personat ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, ku në raste të caktuara publikon detajet e emrave të të akuzuarve, ndërsa në raste tjera i kursen.

Monitoruesit e IKD-së, prej 1 korrikut 2015 deri më 30 nëntor 2015 kanë monitoruar 276 seanca gjyqësore, ku përfshihen 171 raste të korrupsionit me 367 persona. Bazuar në analizën e detajuar të bërë në 60 raste të monitoruara, rezulton se në secilën fazë të

procedurës penale, ka shkelje të afateve ligjore si prej prokurorëve si prej gjykatësve. Prej këtyre proceseve gjyqësore janë analizuar 10 rate të korrupsionit, për të cilat është shpallur aktgjykimi. Rasti që ka zgjatur më së shumti prej kohës së ngritjes së kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë ka marrë kohë 1405 ditë (Gjykata Themelore në Prishtinë), ndërsa rasti që ka marrë kohë më të shkurtër ka qenë në 281 ditë (Gjykata Themelore në Ferizaj). Gjatë monitorimit të këtyre rasteve, IKD gjen se profili i personave subjekt i procedurave gjyqësore ishin vetëm 4 zyrtarë të lartë, prej tyre dy kryetar komunash, një ish-anëtar të KGJK-së dhe Kryetari i OSHP-së, ndërsa pjesa tjetër e të akuzuarve janë kryesisht profil i ulët eventualisht profil i mesëm.

Problemet e njëjta me të cilat përballet sistemi prokurorial përballet edhe sistemi gjyqësor sa i përket trajtimit me prioritet të lëndëve të korrupsionit. Për t'iu qasur seriozisht këtyre lëndëve, KGJK më 25 shtator 2015 ka miratuar një plan të veprimit, përmes të cilit janë identifikuar të gjitha rastet e korrupsionit nëpër gjykata dhe të njëjtat janë caktuar për tu proceduar.

Mosrespektimi i afateve ligjore dhe politikave për luftimin e veprave penale të korrupsionit ndikojnë në shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në amnistinë e personave të përfshirë në korrupsion. Zvarritja e zgjidhjes së rasteve me vite të tëra nëpër institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet dështimi më i madh i këtij sistemi në realizimin e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. IKD vlerëson se avancimi i legjislacionit penal nuk i është përgjigjur rrethanave dhe kushteve ekzistuese të sistemit të drejtësisë si dhe ka munguar vullneti politik që të njëjtat të ndryshohen pozitivisht për të mundësuar zbatimin e kodeve në praktikë. Ndryshe, nëse do të ekzistonte një vullnet i tillë i pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, pushteti gjyqësor do të kishte mundësinë që të dëshmojë vetën, duke u këndellur, për të ofruar drejtësi në mënyrë të barabartë dhe të paanshme për të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë të njejtë, respektivisht duke mbrojtur liritë dhe të drejtat e qytetarëve, duke zbatuar me efikasitet dhe efektivitet dispozitat e dy kodeve, për të trajtuar rastet në një kohë të arsyeshme në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe obligimet e përcaktuara më Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Penale. Me qëllim të adresimit të kësaj çështje jo vetëm në rastet e korrupsionit por edhe tek veprat tjera penale, është e domosdoshme që Ministria e Drejtësisë, të filloj procesin e rishikimit të drejtësisë penale për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga institucionet e drejtësisë.

Edhe sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, në rastet e korrupsionit, nuk shihet se ka progres. Prokurorët ende nuk po gjejnë rrugën për të aplikuar dispozitat e ligjit të aplikueshëm lidhur me këtë fushë, të rëndësishme. Çështja e raportimeve në publik rreth sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive të fituara përmes veprave penale ka krijuar keqkuptime rreth realitetit të rezultateve që ndërlidhen me veprat penale të korrupsionit. Fillimisht, IKD vlerëson se performanca në luftimin e kryesve të veprave penale që kanë përfituar dobi pasurore përmes veprave penale duhet të matet

ekskluzivisht me aktgjykime përfundimtare që sjellin konfiskim, në të kundërtën, veprimet procedurale nuk janë reprezentative për të treguar gjendjen reale, gjithnjë bazuar në praktikat e mbrapshta të ndërtuara deri më tash.

Monitorimi i IKD-së tregon se ka minimalisht rezultate të dobisë së sekuestruar dhe konfiskuar që ndërlidhen me veprat penale të korrupsionit, ndërsa të dhëna të sakta për këtë kategori nuk janë të sistemuar në asnjë institucion të drejtësisë, edhe pse janë proklamuar mekanizma në praktikë për të gjurmuar këto raste.

## II. METODOLOGJIA

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirëse dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Kjo për shkak se sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave. Prandaj, hulumtimi trajtimin të rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Hulumtimi përfshin monitorimin e rasteve të korrupsionit në shtatë Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, shtatë Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre. Në fokus të monitorimit kanë qenë aktivitetet e Koordinatorës Nacionale Kundër Korrupsionit në Prokurori të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në zbatimin e politikave dhe planeve të veprimit. IKD gjithashtu ka të siguruar të dhënat statistikore nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe Departamenti i Statistikës në Këshillin Gjyqësor si dhe ka mbledhur të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat.

Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhur në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërliken me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave dhe grafikave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilin prokurori dhe gjykatë, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit, për vjetërsinë e rasteve të denoncuar për korrupsion dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

IKD ka vazhduar të monitoroj aktet prokuroriale rreth vendimeve për hudhje të kallëzimeve penale dhe vendimeve për pushim të hetimeve. Të njëjtat janë analizuar karshi obligimeve ligjore dhe është bërë identifikimi i shkeljeve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në procedurën penale, përfshi identifikimin e rasteve të parashkruara.

Risi e këtij raporti janë rastet e korrupsionit të proceduara në shtatë Gjykatat Themelore dhe Degët e saj, ku hulumtuesit e IKD-së për periudhën 1 korrik – 30 nëntor 2015 kanë monitoruar 276 seanca gjyqësore, ku përfshihen 171 raste të korrupsionit me 367 persona të akuzuar. IKD për herë të parë tenton të bëjë matje të sakta të kohëzgjatjes së rasteve të korrupsionit nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë nga gjykatat. Analiza përfshin

të gjitha trendet e trajtimit të këtyre rasteve dhe kohëzgjatjen e procedurave në rastet e korrupsionit. Në fokus të analizës në këtë raport janë 10 raste të korrupsionit, të cilat kanë përfunduar me aktgjykim në shkallë të parë.

Aspekt i rëndësishëm i monitorimit ka qenë performanca e mekanizmave të llogaridhënies për prokurorët dhe gjykatësit, të cilët për shkak të performancës së tyre në rastet e korrupsionit janë bërë subjekt i procedurave disiplinore.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Koordinatorës Nacionale Kundër Korrupsionit, Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykatave Themelore, Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Poashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në luftimin e korrupsionit, përkatësisht në zbatimin sa më efikas dhe efektiv të obligimeve ligjore dhe obligimeve të planeve të veprimit, IKD ka analizuar bazën ligjore, si dhe analizuar në detaje dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

### III. HETIMET PËR RASTET E KORRUPSIONIT - PP

Këshilli Prokurorial i Kosovës (në vazhdim, KPK) vazhdon të mbetet institucion, i cili prin me politika dhe vendime për luftimin e korrupsionit. Promovimi i këtyre politikave dhe dështimi për t'i zbatuar ato në praktikë tashmë një kohë të gjatë e ka shndërruar dukurinë e luftimit të korrupsionit në një retorikë të përditshme. Subjekt i hetimeve dhe ngritjes së aktakuzave për korrupsion, vazhdojnë të mbesin personat e profilit ulët, eventualisht të mesëm. Rrallë ndodhë të ngritën aktakuza për profilet e larta të korrupsionit, sidomos ato që ndërlidhen me politikan apo njerëz të fuqishëm të biznesit. Instituti i Kosovës për Drejtësi (në vazhdim, IKD) konsideron se pjesa dërrmuese e lëndëve të korrupsionit, që gjenden nëpër procedura penale nuk e reprezentojnë veprimtarinë e vërtetë korruptive që zhvillohet në segmente të ndryshme të jetës në Kosovë, sidomos në institucione publike. Prokuroritë sfidohen me numër të madh të parashtrimit të rasteve të korrupsionit, por rrugës këto raste filtrohen. Ekzistojnë shumë faktor pse nuk ka luftë të vërtetë kundër korrupsionit, duke filluar prej ndikimeve politike<sup>2</sup>, mungesë së pavarësisë së sistemit të drejtësisë përmes mos përkrahjes së nevojshme buxhetore nga dy pushtetet tjera, zbatimi i drejtësisë selektive nga prokurorët dhe gjykatësit, mungesa e një sistemi efikas të llogaridhënies për prokurorët dhe gjykatësit, si dhe mungesa e profesionalizmit dhe guximit për tu ballafaquar me profilin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit. Rezultati përfundimtar përkundër shumë rasteve të parashtruara për vepra penale të korrupsionit, mungon. Pjesë e bankës së të akuzuarve në pjesën dërrmuese të rasteve mbesin profili i personave të ulët, eventualisht të mesëm, por rastet ndaj profilit të lartë vështirë formalizohen në aktakuza. Edhe atëherë kur shndërrohen në aktakuza, rrëzohen në gjykata, ose nëse dënohen, dënimi jepet me kusht edhe pse konstatohet se dëmet e shkaktuara kapin shifra milionëshe.<sup>3</sup>

*“Lufta kundër korrupsionit është shndërru me një farsë, me një zhurmë të madhe ku flitet gjithkund për korrupsion, por po më duket është bërë vetëm një kamuflazhë për të dyshuarit e vërtetë që mos me i ndjekë, por me i ndjekë ata, të cilët kanë kry, ndoshta ndonjë vepër penale irrelevante”, Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit. 8 tetor 2015.*

Pavarësisht miratimit të politikave të avancuara për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet absolut, sistemi prokurorial nuk po arrin të ulë numrin e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit. Dështimi për të zbatuar në praktikë obligimet e planit të veprimit, dhe mungesa e efikasitetit të mekanizmave të llogaridhënies ka ndikuar që vazhdimisht të ketë rritje të trendit të rasteve të

<sup>2</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovë. Fq. 12. Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

<sup>3</sup> Salihi Nj. “Nuhi Uka: Gjykimi që stimulon korrupsionin”. Gazeta JNK. Publikuar më 29 shtator 2014. Shih linkun <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,9145>

pazgjidhura të korrupsionit. Të gjitha këto vlerësime IKD i mbështetë në monitorimin e përditshëm, të cilin ia ka bërë aktiviteteteve të Prokurorit të Shtetit (PSh) dhe KPK-së rreth zbatimit të Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit (në vazhdim, Plani i Veprimit), të miratuar nga KPK me 4 nëntor 2013<sup>4</sup>.

Ky raport përfshin monitorimin e PSh dhe KPK lidhur me trajtimin e rasteve të korrupsionit prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit deri më 30 shtator 2015. Në fokus të analizës përfshihet edhe tremujori i tretë i vitit 2015 (ku përfshihen muajt korrik, gusht dhe shtator 2015). IKD tashmë ka një përvojë të gjashtë në monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të zbatimit të Planit të Veprimit<sup>5</sup> dhe ky është raporti i shtatë periodik.


IKD në bazë të të gjeturave dhe vlerësimit të raporteve statistikore gjen se trendi i numrit të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit dhe personave të përfshirë në këto raste që janë punë në shtatë PTh-të dhe PSRK, ka shënuar rritje prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit. Shih tabelën 1.

---

<sup>4</sup> Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit:

[http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani\\_i\\_Veprimit\\_per\\_Rritjen\\_e\\_Efikasitetit\\_te\\_Sistemit\\_Prokurorial.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf)

<sup>5</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi me datën 27 dhjetor 2013 kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi "Lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit lidhur me Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit". Këshilli Prokurorial i Kosovës, 27 dhjetor 2013.



**Grafika 1 - Rastet e pazgjidhura të korrupsionit në sistemin prokurorial**

Përkundër faktit, se plani i veprimit ka përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në sistemin prokurorial, lidhur me ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, praktika ka dëshmuar të kundërtën. Planin e veprimit ka qenë një e arritur e KPK-së në hartimin e politikave për të adresuar luftimin e korrupsionit. Mekanizmat e sistemit prokurorial përfshi KPK-në, Kryeprokurorët dhe prokurorët nuk kanë shprehur vullnet dhe angazhim të nevojshëm për të zbatuar planin në praktikë. IKD vlerëson se bartësit e sistemit prokurorial ende nuk e kanë marrë seriozisht përmbajtjen e këtij plani të veprimit dhe zbatimin e tij. Sa seriozisht është kuptuar ky plan dhe sa ka pasur angazhim për zbatim të tij dëshmohet në diskutimet e anëtarëve të KPK-së në mbledhjen e mbajtur më 8 tetor 2015. Kryeprokurori i Shtetit, njëherësh Kryetari i KPK-së, z. Aleksandër Lumezi, në këtë mbledhje ka deklaruar se deri për këtë mbledhje të KPK-së asnjëherë nuk e ka lexuar seriozisht planin e veprimit.<sup>6</sup> Një qasje e tillë është dëshmuar në praktikë nga gjithë sistemi

<sup>6</sup> “A ka qenë ky Plan i Veprimit i suksesshëm apo jo? Unë mbrëmë e kam lexu, jam marrë me këtë punë. Me ju thënë të drejtën deri tash kurrë se kam lexu seriozisht këtë Plan të Veprimit, mbrëmë e kam lexu edhe e kam pa që e kemi pasë një Plan të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit shumë shumë të mirë. Unë kam pasë kontakte edhe me Kryeprokurorin e Kroacisë besoni ata ma kanë tregu Planin e Veprimit nuk dallon nga ky Plan i Veprimit, nuk është hiç më i mirë. Por kemi problem me zbatimin e këtij Plan të Veprimit. Ne i kemi

prokurorial në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Një varg obligimesh të këtij plani të veprimit nuk janë zbatuar dhe IKD ka raportuar në vazhdimësi për këto dështime.<sup>7</sup> Dështimet e njëjta janë ngritur për diskutim dy herë në mbledhje të KPK-së dhe janë konfirmuar në përpikëri nga vetë anëtarët e KPK-së.<sup>8</sup> Anëtarët e KPK-së kanë qenë vetëkritik, duke pranuar faktin se Kryeprokurorët dhe vetë KPK ka dështuar të zbatojë planin e veprimit dhe disiplinimi i prokurorëve që kanë dështuar në rastet e korrupsionit ka ardhur si rezultat i gjetjeve të IKD-së, të cilat kanë shërbyer për Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD), që të iniciojë procedura hetimore sipas detyrës zyrtare ndaj prokurorëve.<sup>9</sup>

Në bazë të tabelës më lartë, shihet se përderisa me hyrjen në fuqi të planit të veprimit, prokuroritë kanë pasur në punë 516 raste të pazgjdhura me 1,682 persona, më 30 shtator 2015, ky numër është rritur në 636 raste të pazgjdhura me 1,753 persona të përfshirë. Në bazë të këtyre të dhënave, konfirmohet se sistemi prokurorial ende nuk ka arritur të zvogëlojë numrin e rasteve të pazgjdhura të korrupsionit që ka në punë. Këto të dhëna konfirmojnë gjetjet dhe vlerësimet e IKD-së të raportuara në vazhdimësi përmes raporteve periodike dhe hulumtimeve të publikuara se ende nuk ka vullnet dhe përkushtim të sistemit prokurorial për të luftuar korrupsionin

---

*identifiku në fillim 532 raste*", citat i Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh Kryetarit të KPK-së, z. Aleksandër Lumezi. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 8 tetor 2015.

<sup>7</sup> Shih publikimet e IKD-së rreth monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit të miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Shih linkun <http://kli-ks.org/publikime/>

<sup>8</sup> Anëtarët e KPK-së gjatë vitit 2015 pas emërimit të Kryeprokurorit të ri të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi, në dy mbledhje të mbajtura kanë diskutuar për trajtimin e rasteve të korrupsionit, përkatësisht zbatimin e planit të veprimit. Anëtarët e KPK-së kanë qenë vetëkritik, duke pranuar gjetjet e IKD-së se sistemi prokurorial ka dështuar në zbatimin e obligimeve të planit të veprimit. Diskutimet janë zhvilluar në mbledhjet e mbajtura më 26.06.2015 dhe 08.10.2015. Shih linket <https://www.youtube.com/watch?v=JgngHpVQW38> dhe <https://www.youtube.com/watch?v=kNL1bTf1bJ4>

<sup>9</sup> Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, njëherësh anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, në mbledhjen e KPK-së të mbajtur më 8 tetor 2015 ka deklaruar se Kryeprokurorët, Koordinatorja Nacionale Kundër Korrupsionit dhe KPK kanë dështuar që të mbajnë përgjegjësi prokurorët që kanë dështuar në rastet e korrupsionit. Z. Maloku ka thënë se dështimin e mekanizmave të KPK-së për të mbajtur llogaridhënës prokurorët e ka mbuluar IKD, e cila e ka marrë sipas tij, iniciativën që të ofrojë gjetjet e shkeljeve të prokurorëve për ZPD. Citat i z. Maloku: *"Derisa IKD-ja del me rekomandime edhe plus dërgon raport në ZPD për hapjen e procedurave disiplinore për prokurorë të caktuar, ku në sirtarët e tyre vjetërsohen lëndët, parashkruhen lëndët, ne nga brenda as Koordinatorin, as Kryeprokurorët, këtu ku jemi, s'kemi gjetur fuqi dhe mundësi që t'i paraqesim prokurorët e tanë, që brenda zyreve të tyre janë vjetërsu apo janë parashkru këto lëndë. Atëherë shtrohet pyetja, pse ne presim që dikush nga jashtë të na bëjë përgjegjës, apo të na tërheqin për përgjegjësi... A ne nga brenda nuk kemi qenë në gjendje që këta prokurorë, ose ata Kryeprokurorë të këtyre prokurorëve t'i bëjmë përgjegjës për shkak të parashkrimit të këtyre lëndëve. Ku është përgjegjësia jonë? Pse ne mos me i paraqitë këto raste? Pse ne të mos kemi procedura disiplinore kundër prokurorëve që ne i kemi paraqitur rastet, ne e kemi marrë iniciativën e këtyre rasteve...". "...Është vjetërsu lënda e natyrës së tillë (korrupsionit) te një prokuror, ne duhet ta hapim atë çështje pse ka ndodhë kjo dhe jo ta merr iniciativën, tash fjala vjen, fati ka dashtë apo një organizatë jo-qeveritare (IKD) e ka paraqitë rastin, e ka çu raportin dhe sot është në procedure (në ZPD), edhe plotë prokurorë, neve s'na kanë ardhë raporte për prokurorët që pikërisht janë vjetërsu këto lëndë të korrupsionit".* Mbledhja e KPK-së e mbajtur më 8 tetor 2015. Shih linkun <https://www.youtube.com/watch?v=kNL1bTf1bJ4>

në Kosovë. Këto gjetje poashtu, janë konfirmuar edhe përmes Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovën, të publikuar në muajin nëntor 2015.<sup>10</sup>

*“Kosova është në fazën e hershme të luftimit të korrupsionit. Pak progres është arritur gjatë viteve të kaluara, kryesisht në ngritjen e bashkëpunimit në mes të Agjencisë Kundër Korrupsionit me prokuroritë, dhe në obligimin e zyrtarëve për të deklaruar pasurinë dhe dhuratat. Sidoqoftë, progresi i përgjithshëm është i kufizuar dhe nevojitet vullnet dhe përkushtim i fortë politik për të adresuar këtë fenomen në mënyrë të përshtatshme. Një qasje strategjike dhe gjithëpërfshirëse është e domosdoshme për të siguruar rezultate reale në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë”. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovë.*

Mungesën e vullnetit dhe përkushtimit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit e ka potencuar edhe Kryeprokurori i Shtetit, njëherësh Kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Aleksandër Lumezi<sup>11</sup> në takimin e Këshillit Prokurorial të mbajtur me datë 8 tetor 2015, gjatë diskutimit të planit të veprimit për rastet e korrupsionit.

<sup>10</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovën. “Luftimi i Korrupsionit”. Fq. 15 Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

<sup>11</sup> “Nga kjo që e tha Koordinatorja, po shihet që është bërë një punë nga ana e prokurorëve. Mirëpo në anën tjetër kemi perceptione shumë të mëdha por jo vetëm perceptione, por edhe vlerësime edhe të partnerëve ndërkombëtar, që në këtë drejtim janë shumë real. Por edhe vlerësimet e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, por edhe të shumë Ambasadave në Republikën e Kosovës, Ambasadorëve me të cilët jam taku unë se në këtë drejtim PSh nuk ka treguar rezultate të mjaftueshme. Edhe pse dikun 660 lëndë, ose 700 që janë kry, por në anën tjetër e shikojmë një statistikë të lëndëve të cilat kanë qenë më 4 nëntor të vitit 2013 kur ka fillua të zbatohet Plani i Veprimit për Efikasitetin ndaj Luftës Kundër Korrupsionit, gjithsej në punë i kemi pasur 532 raste penale. Ndërsa tani pas dy viteve kemi ardhur në situatë ku i kemi 589 raste penale të pakryera. Domethënë numri i rasteve të kallëzimeve penale tani është më i madh se sa në kohën kur ka fillu me u zbatu ky Plani i Veprimit. Në anën tjetër sipas këtij raporti po shihet që sa i përket numrit me persona një efikasitet më të madh. Kemi prej disa personave që kemi kry më shumë lëndë se sa kanë qenë në momentin kur ka fillu të zbatohet ky Plani i Veprimit. Në anën tjetër ju e përmendët që edhe këto rastet me, tek raportet e veçanta që i themi ne PPN, me persona të panjohur, në fillim të zbatimit të këtij Plani të Veprimit kemi pasë 235 raste ndërsa kemi 346 raste me raporte penale të pakryera që domethënë se kemi 119 raste më shumë se kur ka fillu me u zbatu ky Plani i Veprimit”, citat i Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi, gjatë diskutimit të pikës 5 të rendit të ditës së takimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; “Raportimi i Koordinatorës Nacionale Kundër Korrupsionit, znj. Laura Pula”. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 8 tetor 2015.

IKD përmes tabelës së më poshtme pasqyron numrin e rasteve dhe personave të përfshirë në rastet e korrupsionit. Shumica e prokurorive, ende nuk po arrijnë të zvogëlojnë numrin e rasteve të korrupsionit dhe personave të përfshirë në këto raste. Shih tabelën 2.

<b>RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL (04.11.2013 - 30.09.2015)</b>											
<b>Prokurori i Shtetit</b>	<b>Prokurori i Shtetit</b>										
	Të pazgjidhura në fillim (04.11.2014)		Të pranuar (04.11.2013 deri më 30.09.2015)		Të zgjidhura		Mënyra e zgjidhjes			Të pazgjidhura në fund (30.09.2015)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Raste	Persona
							Persona	Persona	Persona		
<b>PSRK</b>	35	232	44	174	39	223	35	101	87	49	253
<b>Prishtinë</b>	224	777	336	628	203	410	95	94	221	391	1,094
<b>Prizren</b>	70	175	94	192	133	294	72	90	132	24	63
<b>Pejë</b>	37	86	94	156	92	176	34	87	55	40	77
<b>Gjilan</b>	23	81	66	116	82	187	59	43	84	16	25
<b>Mitrovicë</b>	64	141	73	143	67	150	49	11	90	69	148
<b>Ferizaj</b>	37	126	66	119	83	193	34	26	133	24	52
<b>Gjakovë</b>	26	64	45	98	67	125	28	24	73	23	41
<b>Total:</b>	<b>516</b>	<b>1682</b>	<b>818</b>	<b>1,626</b>	<b>766</b>	<b>1757</b>	<b>406</b>	<b>476</b>	<b>875</b>	<b>636</b>	<b>1,753</b>

**Tabela 1 - Trendet e rasteve të korrupsionit prej 04.11.2013 deri më 30.09.2015**

Sipas trendit të paraqitur në tabelën 2, rezulton se shumica e prokurorive ende janë në gjendjen fillestare me numrin e rasteve të pazgjidhura dhe personave të përfshirë, të cilat i kanë pasur në punë në fillim të planit të veprimit. PSRK dhe PTh në Prishtinë, vazhdojnë me trendin negativ të rritjes së numrit të rasteve dhe personave të përfshirë në rastet e korrupsionit.

Në bazë të kësaj tabele shihet se PSh që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më datë 30 shtator 2015, ka pranuar 818 raste të reja të korrupsionit, me 1626 persona të përfshirë. Përderisa, PSh që nga hyrja në fuqi e këtij plani deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur 766 raste me 1757 persona. Në bazë të kësaj analize, rezulton se PSh, gjatë të njëjtës periudhë kohore ka pranuar me shumë raste (818), se sa ka qenë në gjendje t'i zgjedhë (766). Ndërsa, në raport me numrin e personave të përfshirë, PSh ka zgjidhur më shumë raste (1757) se sa ka pranuar gjatë të njëjtës periudhë kohore (1626).

Karakteristikë e këtij raporti po ashtu, është mënyra e zgjidhjes së rasteve në të gjitha prokuroritë e Kosovës. Nga numri prej 1757 personave, ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, vërehet numër i madh i mbylljes së rasteve ndaj personave të dyshuar për korrupsion. Nga 1757 persona që kanë qenë subjekt të procedurave penale për korrupsion, ndaj 1351 personave rastet janë mbyllur nëpër prokurori. Respektivisht, prokuroritë gjatë kësaj periudhe kohore kanë ngritur aktakuza ndaj 636 personave, kanë hudhur kallëzimet penale ndaj 476 personave dhe kanë pushuar hetimet ndaj 875 personave.

#### **a) Performanca e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës**

Në PSRK funksionin e prokurorit e ushtrojnë 10 prokurorë<sup>12</sup>. Nga ky numër 7 prokuror janë të caktuar të trajtojnë rastet e korrupsionit, por të njëjtit ngarkohen të trajtojnë edhe lëndë të tjera që hyjnë në kuadër të veprave penale të terrorizmit dhe krimin të organizuar.<sup>13</sup>

PSRK me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 35 raste me 232 persona, përderisa kjo prokurori në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 49 raste me 253 persona. Kjo prokurori nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 44 raste të reja me 174 persona, përderisa gjatë të njëjtës periudhe ka zgjedhur 39 raste me 222 persona. Prej këtyre rasteve të zgjidhura, ndaj 35 personave janë hudhur kallëzimet penal, ndaj 101 personave janë pushuar hetimet, përderisa janë ngritur aktakuza ndaj 87 personave. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PSRK gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 87 persona, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 136 personave.

Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PSRK ka arritur të zgjidhë raste ndaj 22 personave, prej tyre ndaj 15 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 4 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 3 personave i ka pushuar hetimet.

<sup>12</sup> Në këtë numër nuk janë përfshirë prokurorët ndërkombëtar të EULEX-it që ushtrojnë funksionin e prokurorit në këtë Prokurori. Megjithatë, për PSRK janë të lejuara 18 pozita për prokurorë, por të cilat nuk janë plotësuar ende.

<sup>13</sup> IKD intervistë me u.d. Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Reshat Millaku. Nëntor 2015.

IKD ka analizuar vazhdimisht performancën dhe rezultatet e punës së kësaj prokurorie, e cila ka kompetenca ekskluzive në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë.<sup>14</sup> Nga monitorimi rezulton se performanca dhe rezultatet e arritura nga kjo prokurori në trajtimin e rasteve të korrupsionit janë shqetësuese, krahasuar me numrin e prokurorëve të caktuar për lëndët e korrupsionit dhe numrin e rasteve të zgjidhura. Analiza tregon se 7 prokurorët e caktuar në lëndët e korrupsionit në PSRK është dashur të zgjidhin të gjithë së bashku<sup>15</sup>, brenda një viti 154 raste të korrupsionit, ndërsa për 23 muaj nga hyrja në fuqi e planit të veprimit është dashur të zgjidhen 294 raste të korrupsionit. Përderisa, të gjithë së bashku kanë zgjidhur vetëm 39 raste të korrupsionit me 223 persona, që rezulton se kjo prokurori në përqindje ka arritur të zgjidhë vetëm 13.26 për qind të rasteve të normës orientuese vjetore të përcaktuar për secilin prokurorë për sa i përket rasteve të korrupsionit.

Performanca e kësaj prokurorie, rezulton të jetë e dobët në përgjithësi edhe në raport me trajtimin e veprave penale të krimit të organizuar, terrorizmit, shpërlarjes së parave, dhe veprave penale tjera të trajtuara nga kjo prokurori. Duke u bazuar edhe në raportin vjetor të punës së PSh-së për vitin 2014<sup>16</sup>, kjo prokurori për një vit ka zgjidhur 78 raste, ndërsa ka pranuar në punë 152 raste të reja. Sipas normës orientuese vjetore, PSRK do duhej të përfundonte gjatë vitit 264 raste në raport me numrin prej 12 prokurorëve që kanë punuar në vitin 2014 në këtë prokurori, që rezulton se kjo prokurori ka realizuar normën vjetore të punës për vetëm 29.54 për qind. Drejtuesit e PSRK-së arsyetojnë këtë performancë të dobët me numrin e vogël të prokurorëve, me lëndët të cilat ngarkohen nga EULEX kohë pas kohë dhe komplikueshmërinë e rasteve të korrupsionit për t'i hetuar.<sup>17</sup>

Ka vlerësime të ndryshme për normat orientuese të vendosura për prokurorët e PSRK-së. Politikat e zbatueshme të KPK-së përkrahin normat në fuqi, derisa diskutimet e ngritura në mbledhje të KPK-së kanë shqyrtuar idenë e heqjes së normës për prokurorët e kësaj prokurorie. Anëtarët e KPK-së kanë diskutuar për heqjen e normës kuantitative dhe kanë shqyrtuar vendosjen e një norme orientuese për të kryer lëndë kualitative, duke synuar ngritjen e aktakuzave për profil të lartë të korrupsionit.

---

<sup>14</sup> Udhëzim për caktimin e korrupsionit të nivelit të lartë të nënshkruar nga Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori i Prokurorëve të EULEX-it dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, 13 nëntor 2013. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezim\\_kur\\_nje\\_veper\\_e\\_korrupsionit\\_do\\_te\\_konsiderohet\\_si\\_e\\_nivelit\\_te\\_larte.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezim_kur_nje_veper_e_korrupsionit_do_te_konsiderohet_si_e_nivelit_te_larte.pdf)

<sup>15</sup> Prokurori i Prokurorisë Speciale është i obliguar që të i kryej 2 lëndë brenda vitit, neni 2 pika 1.5 e Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e normës orientuese vjetore për Prokurorë, miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me date 24 janar 2012. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezimi\\_Administrativ\\_Nr.01-2012,per\\_Percaktimin\\_e\\_Normes\\_Orientuese\\_Vetore\\_per\\_Prokurore.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezimi_Administrativ_Nr.01-2012,per_Percaktimin_e_Normes_Orientuese_Vetore_per_Prokurore.pdf)

<sup>16</sup> Raporti Vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2014. Shih linkun

[http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr\\_529\\_2015-Raporti\\_Vjetor\\_2014-Prokurori\\_i\\_Shtetit1.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr_529_2015-Raporti_Vjetor_2014-Prokurori_i_Shtetit1.pdf)

<sup>17</sup> IKD intervistë me u.d. Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Reshat Millaku. Nëntor 2015.

Kryeprokurori i Shtetit, njëherësh Kryetari i KPK-së, z. Aleksandër Lumezi, ka vlerësuar se këto norma po e dëmtojnë kualitetin e punës dhe realisht PSRK po ngarkohet me lloj lloj lëndësh dhe në fund nuk po tregohen rezultate konkrete në natyrën e lëndëve, të cilat i kompetencë ekskluzive kjo prokurori.<sup>18</sup> IKD vlerëson se diskutimet rreth normës kualitative për prokurorët e PSRK-së dëshmojnë se anëtarët e KPK-së nuk janë në dijeni për udhëzimin, i cili përcakton normat orientuese, në këtë rast edhe për PSRK-në, se pikërisht për këtë prokurori, neni 6 i këtij udhëzimi, ka përcaktuar normën kualitative, të cilën nëse e arrijnë prokurorët e PSRK-së arsyetohen për mospërbushjen e normës kuantitative. Sipas këtij udhëzimi, neni 6<sup>19</sup>, rezulton se një prokuror special e përmbush normën nëse brenda një viti arrin të përfundon tri raste të ndërlikuara me sukses.

Për dallim prej PSRK-së, prokuroria simotër, e cila vepron në Kroaci, me kompetenca pothuajse të njëjta sikurse PSRK, në vitin 2012, në përgjithësi prej 283 aktakuzave të ngritura dhe të përfaqësuara në gjykatat kroate ka arritur të mbrojë 95 për qind të tyre, duke u shpallur 252 aktgjykime dënuese për këto aktakuza.<sup>20</sup>

Sistemi prokurorial, sidomos PSRK për shkak të kompetencave që ka, vazhdon të sfidohet përditë me raporte të ndryshme të monitorimit si vendore ashtu edhe ndërkombëtare që dëshmojnë dështimin e sistemit në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë<sup>21</sup>.

IKD po ashtu, ka monitoruar ueb faqen e PSh-së, lidhur me informimin e publikut rreth ngritjes së aktakuzave për rastet e korrupsionit nga PSRK prej hyrjes në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015. IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjatë kësaj periudhe kohore PSh ka publikuar gjithsej 19 komunikata për media lidhur me rastet e korrupsionit, ku përfshihen arrestime apo aktakuza të ngritura ndaj personave të ndryshëm për kryerjen e veprave penale të korrupsionit. Në bazë të këtij monitorimi, rezulton

---

<sup>18</sup> Diskutimet e anëtarëve të KPK-së rreth performancës së prokurorive dhe PSRK-së në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 26 qershor 2015.

<sup>19</sup> Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në rast se kryen tri lëndë brenda vitit që janë të ndërlikuara llogaritet se e ka përmbushur normën e punës, njëjtë sikurse të kryente 22 lëndë brenda vitit. Vlerësimin për përfundimin me sukses të këtyre lëndëve të komplikuar bëhet nga Kryeprokurori i PSRK-së në bashkëpunim me Kryeprokurorin e Shtetit. Neni 6 “Lënda shumë e ndërlikuar dhe shumë e veçantë”; Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e normës orientuese vjetore për Prokurorë, miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me date 24 janar 2012. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezimi\\_Administrativ\\_Nr.01-2012,per\\_Percaktimin\\_e\\_Normes\\_Orientuese\\_Vetore\\_per\\_Prokurore.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezimi_Administrativ_Nr.01-2012,per_Percaktimin_e_Normes_Orientuese_Vetore_per_Prokurore.pdf)

<sup>20</sup> Musliu B. “Në kërkim të rrugës për luftimin e korrupsionit: Në mes dy zjarreve, persekutimit dhe dështimit (Analizë dhe rekomandime rreth zbatimit të Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit). Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë. Gusht 2015. Shih linkun <http://kli-ks.org/ne-kerkim-te-rruges-per-luftimin-e-korrupsionit-ne-mes-dy-zjarreve-persekutimit-dhe-deshtimit-2/>

<sup>21</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovën. “Luftimi i Korrupsionit”. Fq. 15 Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

se PSRK ka bërë publike ngritjen e aktakuzave në pesë raste, ku përfshihen profil i lartë në përputhje me Udhëzimin. PSRK ka ngritur aktakuza ndaj një ish-Kryetari të Gjykatës Kushtetuese, ndaj një ish-Kryetari të Komunës, ndaj një ish-Sekretari të Përgjithshëm, ndaj 18 zyrtarëve komunalë, ndaj gjashtë pronarëve të kompanive, ndaj një drejtori, ndaj një drejtori të institutit, ndaj tre menaxherëve, ndaj dy zyrtarëve dhe në një rast ndaj personave që ndërlidhen me dyshimet për keqpërdorime në ish-Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

GjTh në Prishtinë, në të cilën kryesisht deponohen aktakuzat e ngritura nga PSRK, nuk është sfiduar ende mjaftueshëm me lëndë që konsiderohen serioze dhe që i përkasin natyrës së korrupsionit. Luftimi i korrupsionit të profilit të lartë, përkatësisht numri i personave që konsiderohen profil i lartë i korrupsionit mund të numërohet në gishtat e një dore.<sup>22</sup>

#### **Karakteristikat për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës:**

1. Numri i lartë i personave ndaj të cilëve janë pushuar hetimet apo janë hudhur kallëzimet penale, në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat;
2. Efikasiteti i ultë i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
3. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale;
4. Numër shumë i ulët i luftimit të korrupsionit të nivelit të lartë;
5. Mos plotësimi i pozitave të lejuara për prokurorë në këtë prokurori.

Akterë të shoqërisë civile vlerësojnë se performanca e PSRK-së ka dështuar në shumë segmente në luftimin e kriminalitetit, me theks të veçantë në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë.<sup>23</sup> Aktet procedurale nuk janë reprezentative për të dëshmuar suksesin e PSRK-së në luftën kundër korrupsionit, pasi që në shumicën e rasteve ato kanë dështuar në gjykata. Deri tash nuk ekziston një rast i

<sup>22</sup> IKD intervistë me Kryetarin e GjTh në Prishtinë, z. Hamdi Ibrahim. Nëntor 2015.

<sup>23</sup> IKD intervista me Hulumtuesen e Lartë të Institutit KIPRED, znj. Ariana Qosaj Mustafa; Drejtorin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, z. Fisnik Korenica, Përfaqësuesin Ligjor të Organizatës Çohu, z. Arton Demhasaj. Nëntor 2015.

korrupsionit që i takon profilit të lartë që vjen nga politika, i cili është gjykuar me aktgjykim përfundimtar dhe të cilit iu është konfiskuar dobia pasurore e fituar përmes korrupsionit.<sup>24</sup>

IKD vlerëson se është koha e fundit që PSRK të dëshmojë vullnet dhe përkushtim në zbatim të ligjit. Sikurse në çdo prokurori, edhe në PSRK duhet të rritet llogaridhënia e prokurorëve dhe shkeljet e ligjit duhet të ndëshkohen në mënyrë meritore për të mundësuar ngritjen e nivelit të performancës përmes prokurorëve me ekspertizë dhe guxim në ndjekjen e kryerësve të veprave penale që bien në kompetencë të kësaj prokurorie.

### **b) Profili i ndjekjes së korrupsionit**

Profili i luftimit të korrupsionit të nivelit të lartë vazhdon të mbetet retorikë e gjithë udhëheqësve shtetërorë të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe udhëheqësve të Misionit të EULEX-it.<sup>25</sup> Përtej kësaj retorike nuk ka pasur vullnet dhe rezultate konkrete për të luftuar korrupsionin e profilit të lartë<sup>26</sup>. Dështimet për luftimin e këtij profili, padyshim se më së shumti i faturohen Misionit të EULEX-it, i cili kishte kompetenca ekskluzive në kuadër të PSRK-së, të cilën e kishte udhëhequr deri në maj 2014.<sup>27</sup>

Duke parë dështimet e vazhdueshme në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, ishte themeluar PSRK<sup>28</sup> si prokurori e specializuar në kuadër të PSh-së. Kjo prokurori që nga themelimi i saj, deri më 30 maj të vitit 2014<sup>29</sup>, ishte udhëhequr dhe menaxhuar nga prokurorët ndërkombëtar. Kompetencat dhe përgjegjësitë për të udhëhequr dhe menaxhuar me këtë prokurori, prokurorët e EULEX-it i kanë pranuar në fund të vitit 2008, atëherë kur ky mision ka ndërtuar kapacitetet fillestare operative në Kosovë, kurse në prill të

---

<sup>24</sup> IKD intervistë me Përfaqësuesin Ligjor të Organizatës Çohu, z. Arton Demhasaj. Nëntor 2015.

<sup>25</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2015 për Kosovën. "Luftimi i Korrupsionit". Fq.15 Shih linkun [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

<sup>26</sup> Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi, në mbledhjen e KPK-së të mbajtur 8 tetor 2015, ka thënë se lufta kundër korrupsionit është shndërruar në retorikë dhe se sistemi prokurorial ka dështuar në zbatimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit të miratuar më 4 nëntor 2013 nga KPK. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 8 tetor 2015.

<sup>27</sup> Ndihma e Bashkimit Evropian për Kosovën lidhur me Sundimin e Ligjit. Gjykata Evropiane e Auditorëve. Raport Special. Nr. 18, 2012. Shih linkun [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12\\_18/SR12\\_18\\_EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF)

<sup>28</sup> Kjo prokurori është themeluar dhe funksionalizuar me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në vitin 2008. (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2014 [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_al.pdf))

<sup>29</sup> Vendim i ish-Kryeprokurorit të Shtetit, z. Ismet Kabashi, për caktimin e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit në PSRK. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Vendim\\_588-2014\\_per\\_caktimin\\_e\\_Sevdije\\_Morina\\_UD\\_Kryeprokurore\\_ne\\_PSRK.PDF](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Vendim_588-2014_per_caktimin_e_Sevdije_Morina_UD_Kryeprokurore_ne_PSRK.PDF)

vitit 2009, ishte bërë tërësisht funksional kur edhe kishte pranuar pothuajse të gjitha rastet dhe përgjegjësitë që kanë qenë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë të UNMIK-ut.<sup>30</sup>

PSRK me përbërje të prokurorëve vendor dhe ndërkombëtar prej themelimit të misionit të EULEX-it ishte menaxhuar nga ndërkombëtarët dhe ka vepruar në mënyrë tërësisht të pavarur nga sistemi prokurorial në Kosovë. Zëvendës-kryeprokuror i kësaj prokurorie është caktuar një prokuror nga radhët e prokurorëve vendor që e kanë ushtruar funksionin e prokurorit në këtë prokurori. KPK prej themelimit dhe PSh nuk kanë pasur asnjë kompetencë apo autoritet mbi këtë prokurori deri në vitin 2014, kur me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës, është vendosur që kjo prokurori të udhëhiqet nga prokurorët vendorë.<sup>31</sup>

Themelimi i PSRK-së ishte rezultat i nevojës dhe kërkesave që Kosova të luftonte me sukses krimin e organizuar, shpërlarjen e parave dhe terrorizmin, korrupsionin dhe veprat penale karakteristike. Menaxhimi i saj fillimisht iu ishte besuar ndërkombëtarëve që me kohë të bëhej profesionalizmi i kapaciteteve vendore, në mënyrë që pas përfundimit të mandatit të EULEX-it të mund të udhëhiqet dhe menaxhohet nga prokurorë vendore.

Synimet e mëdha dhe pritjet e krijuara prej PSRK-së ishin luftimi i kryesve të veprave penale karakteristike, duke përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar, por realiteti ka dëshmuar të kundërtën. Arritjet më të mëdha të kësaj prokurorie që nga themelimi i saj janë kufizuar në arrestime që janë vlerësuar si spektakle mediale të udhëhequra nga prokurorë vendorë dhe ndërkombëtarë, përderisa ndjekja efikase dhe dënimi i tyre pothuajse ka mbetur një mision ende i parealizuar. Praktika

---

<sup>30</sup> Në fakt, EULEX-i ka deklaruar të ketë arritur "kapacitetin fillestar operacional" në dhjetor 2008. Fillimisht misioni ishte parashikuar të jetë shumë më e vogël. Megjithatë, përgjatë fazës përgatitore, numrat është rishikuar vazhdimisht dhe rritur, derisa përfundimisht ka arritur një nivel të ngjashëm me atë të UNMIK-ut. Që nga Janari 2009, EULEX-i ka pasur një staf prej 2364 persona, prej të cilëve 1642 kanë qenë personel ndërkombëtar dhe 722 staf lokal, të alokuar në komponentën e policisë, në komponentën e drejtësisë (diku 70 në sistemin e burgjeve, 40 gjyqtarë dhe 20 prokurorë) dhe relativisht një komponent e vogël në dogana (27). "Kapaciteti fillestar operacional" do të thotë, se në kuadër të komponentës së drejtësisë, për shembull, puna në dosjet gjyqësore dhe në rastet që mund të kenë filluar. Nga këto "reduktive" në Dhjetor 2008, rreth pesë muaj i janë nevojitur "EULEX Kosovo" që të marrë në Prill 2009 të ashtuquajturin "përgjegjësi e plotë operacionale", si prezencë ndërkombëtare në Kosovë për drejtësi, polici dhe në sektorin doganor. EULEX KOSOVO - Mandati, struktura dhe zbatim: Sqarime esenciale për një Mision të paparë të BE-së, Martina Spornbauer\*, Qendra për të Drejtën e Marrëdhënive të Jashtme të BE-së. Shih linkun [http://www.asser.nl/upload/documents/7302010\\_24440CLEER%20WP%202010-5%20-%20SPERNBAUER.pdf](http://www.asser.nl/upload/documents/7302010_24440CLEER%20WP%202010-5%20-%20SPERNBAUER.pdf)

<sup>31</sup> Ligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës. Shih linkun <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/04-L-273%20sh.pdf>

e spektakleve ka qenë karakteristikë edhe prokurorëve të EULEX-it, të cilët nuk kanë arritur të dëshmojnë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit.

Megjithatë, duhet theksuar se gjatë gjithë kësaj periudhe kohore edhe prokurorët vendor nuk kanë dëshmuar vullnet, përkushtim apo seriozitet për të hetuar apo ndjekur penalisht korrupsionin e nivelit të lartë. Përkundrazi, me mos veprimin e kësaj prokurorie, në praktikë është dëshmuar një nënshtrim i përgjithshëm i saj në raport me pushtetin ekzekutiv. Përditë raportohen nga shoqëria civile, mediat apo publiku raporte lidhur me keqpërdorimin e parasë publike nga funksionarët e lartë, por nuk ka veprime ligjore për të bërë ndjekjen e tyre.

Nënshtrimi i PSRK-së ndaj ekzekutivit tashmë është shndërruar në fenomen. Për çdo vjet, kjo prokurori kërkon buxhet për aprovimin e shtesave të rrezikshmërisë për prokurorët dhe vullneti i ekzekutivit asnjëherë nuk ka qenë i plotë që të ardhurat e PSRK-së t'i rrisë dhe t'i sistemojë si kategori ligjore, por vazhdimisht i ka lënë peng prokurorët dhe punonjësit e kësaj prokurorie, të cilëve jo rrallë herë iu ka vonuar aprovimin e shtesave.<sup>32</sup> IKD vlerëson se kjo mënyrë e trajtimit të PSRK-së nga ekzekutivi paraqet ndërhyrje të drejtpërdrejtë në pavarësinë e këtij institucioni. Në asnjë mënyrë siguria e prokurorëve të kësaj prokurorie dhe prokurorëve të të gjitha niveleve nuk guxon të mbetet në mëshirën e vullnetit të ekzekutivit, por ajo duhet të rregullohet ekskluzivisht me ligj, në mënyrë që të ketë siguri juridike për ushtrimin e funksionit në mënyrë të pavarur nga prokurorët.

Pritjet e qytetarëve të Kosovës ishin maksimalisht të larta nga Misioni i EULEX-it për Sundim të Ligjit në luftimin e korrupsionit, besimi në këtë mision se ka kompetencë, vullnet dhe përkushtim për të luftuar korrupsionin në Kosovë, janë zbehur maksimalisht në vitin 2014, kur zyrtarët e këtij misioni, të cilët ishin ftuar nga Republika e Kosovës, për të ndihmuar sistemin e drejtësisë në Kosovë, në luftimin e kësaj dukurie, bëhen vet subjekt i dyshimeve për korrupsion, ku të përfshirë ishin prokuror, gjykatës dhe pozita të larta në këtë mision. Misioni i cili kishte ardhur për të luftuar korrupsionin në Kosovë, tanimë ishte në qendër të vëmendjes të mediave vendore dhe ndërkombëtare për dyshimet për përfshirje në korrupsion. Për këto dyshime për korrupsion në EULEX, ishte caktuar

---

<sup>32</sup> Gjatë vitit 2014 kur është aprovuar buxheti për PSRK për vitin 2015 nuk janë paraparë shtesat për prokurorët special dhe stafin mbështetës të kësaj prokurorie. Pas kërkesave të shumta të PSRK-së përfundimisht në mars 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vendosur t'ua aprovojë shtesat për PSRK, të cilët i kanë marrë retroaktivisht edhe për muajin janar, shkurt 2015.

Prof. Jane Paul Jacque, për të përgatitur raport lidhur me rishikimin e zbatimit të misionit të EULEX-it në Kosovë, me fokus të veçantë në trajtimin e dyshimeve të fundit.<sup>33</sup>

Përveç dështimeve në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë në PSRK, duhet theksuar praktikën e mbrapsht të ndërtuar në Kosovë të përpjekjeve për luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, ku organet e ndjekjes në bashkëpunim me policinë kanë ndërmarr veprime ligjore për arrestimin dhe ndalimin e zyrtarëve të lartë shtetërorë, në raste të caktuar edhe janë ngritur aktakuza, por që në fund kanë rezultuar me dështime<sup>34</sup>. IKD vazhdimisht ka ngritur debatin publik rreth këtyre veprimeve të pabazuara në ligj dhe të padrejta, të cilat në fund kanë rrënjësuar personalitetin e individëve të caktuar, të cilët përfundimisht janë shpallur të pafajshëm, por të cilëve u është bërë gjykimi në publik si persona të korruptuar. IKD vlerëson se ndërmarrja e veprimeve hetimore duhet të jetë e bazuar në ligj dhe në një shkallë të lartë të profesionalizmit dhe autorizimi për arrestimin, ndalimin dhe paraburgosjen e të dyshuarve, duhet të bëhet vetëm atëherë kur ka dyshim të arsyetuar dhe të bazuar mirë. Në të kundërtën, bazuar në rastet e shumta, në të cilat ka pasur spektakle të tilla të arrestimeve dhe ngritjes së aktakuzave, të cilat kanë përfunduar me dështime, IKD i konsideron si persekutime ndaj këtyre individëve dhe zbatim i drejtësisë selektive nga institucionet e drejtësisë.

Po ashtu, shqetësuese mbetet fakti se në shumicën e rasteve apo mbi 60% të rasteve të korrupsionit hudhen kallëzimet penale apo pushojnë hetimet ndaj kryesve të këtyre veprave penale. IKD gjatë monitorimit të rasteve ku janë hudhur kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet ka gjetur se në rastet kur subjekt të procedurave penale për vepra penale të korrupsionit kanë qenë ministra apo funksionarë të lartë, të njëjtat janë hudhur poshtë apo janë pushuar edhe me arsye të kundërligjshme se ministrat gëzojnë imunitet nga ndjekja penale.<sup>35</sup> IKD vlerëson se në këto raste, mekanizmat e llogaridhënies do duhej të vepronin me urgjencë në mënyrë që të merren masat adekuate ndaj të gjithë shkelësve të ligjit. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët mund të sigurohen se ligji

---

<sup>33</sup>Raporti i Prof. Jane Paul Jacque, drejtuar Përfaqësueses së lartë dhe nën Kryetares së Komisionit Evropian, Frederica Mogherini, Rishikimi i zbatimit të Misionit të EULEX-it në Kosovë, me fokus të veçantë në trajtimin e dyshimeve të fundit. 21 mars 2015. Shih linkun [http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150331\\_jacque-report\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/statements-eeas/docs/150331_jacque-report_en.pdf)

<sup>34</sup>**Shënim:** IKD rikujton se në Kosovë nuk kanë munguar përpjekjet e organeve të drejtësisë, të cilat në publik, në prani të medieve, kanë bërë arrestime, kanë ngritur dhe komentuar aktakuza ndaj zyrtarëve të lartë shtetërorë, por të cilat në fund kanë rezultuar me dështime. Raste të tilla njihen si rasti: i Guvernatorit të Bankës Qendrore, z. Hashim Rexhepi, rasti i Aeroportit të Kosovës, Rasti i ish-Këshilltarit të Ministrit të Financave dhe Drejtorit në Doganat e Kosovës, z. Lulzim Rafuna, Rasti i njohur si Kolektori në Komunën e Prishtinës etj.

<sup>35</sup> "Rinisin hetimet ndaj Alush Gashit", Portali Indeksonline. Në këtë rast, Prokuroria në këtë rast ka pushuar hetimet ndaj ministrit Alush Gashi me arsyetimin se i njëjti gëzon imunitet nga ndjekja penale, edhe pse në rastin konkret ka pasur dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Hetimet për këtë rast ishin kryer nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit e Policisë së Kosovës, e cila kishte parashtruar kallëzim penal. Shih linkun <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=151913>

zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë ndaj të gjithëve pavarësisht pozitës dhe se ndëshkimi i shkelësve të ligjit në këto raste, do të kthente besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

### c) Ndjekja e profilit të lartë të korrupsionit në periudhën (1 janar – 30 shtator 2015)

Korrupsioni vazhdon të mbizotëroj në shumë fusha dhe është shqetësim i madh për popullin e Kosovës. Indeksi i perceptimit të korrupsionit në Kosovë sipas Amnesty International është 2.9, dhe që është klasifikuar si nivel i korrupsionit të “shfrenuar”. Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, ka raportuar gjithashtu se “ Kosova mbetet tolerante ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet, që nënkupton rrezikun e të qenurit (apo edhe është aktualisht) “shtet i kapur” është i lartë 3P.<sup>36</sup>

Ndjekja e profilit të lartë të korrupsionit vazhdon të mbetet sfida kryesore e sistemit prokurorial. Dështimet e vazhdueshme për vite tëra dhe zbatimi i drejtësisë selektive në raste të caktuara<sup>37</sup> në ndjekjen e personave të fuqishëm ka ndikuar në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial.<sup>38</sup> Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e Prokurorit të Shtetit në periudhën mars – shtator 2015 ka shënuar rënien më të madhe të të gjitha kohërave me vetëm 12.8%.<sup>39</sup>

Prokurorët e PSRK-së si kompetent për luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, rezultojnë se në lëndët e korrupsionit kanë arritur të përmbushin normën orientuese vjetore vetëm 13.26 për qind. Prej 1 janarit 2015 deri më 30 shtator 2015, PSRK ka zgjidhur raste ndaj 62 personave, prej tyre ndaj 51 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 6 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 5 personave ka pushuar hetimet. Ndërsa, vetëm në këtë periudhë të fundit tre mujore, (korrik, gusht, shtator 2015), PSRK ka akuzuar 15 persona.

<sup>36</sup>EUROPEAN UNION ASSISTANCE TO KOSOVO RELATED TO THE RULE OF LAW, European Court of Auditors, Special report, Nr. 18, 2012, shih në: [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12\\_18/SR12\\_18\\_EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF)

<sup>37</sup> “Rinisin hetimet ndaj Alush Gashit”, Portali Indeksonline. Në këtë rast, Prokuroria në këtë rast ka pushuar hetimet ndaj ministrit Alush Gashi me arsyetimin se i njëjti gëzon imunitet nga ndjekja penale, edhe pse në rastin konkret ka pasur dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Hetimet për këtë rast ishin kryer nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit e Policisë së Kosovës, e cila kishte parashtruar kallëzim penal. Shih linkun <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=151913>

<sup>38</sup> *Shënim*: Sistemi prokurorial prej vitit 2007 kur UNDP ka zhvilluar anketa për kënaqëshmërinë e qytetarëve rezultojnë se ka pasur përqindje të ulët. Përqindja më e lartë e kënaqëshmërisë është shënuar në vitin 2009 (31.7%). IKD vlerëson se kjo përqindje mund të ndërlidhet me procesin e riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve si dhe me funksionalizimin e tërësishëm të Misionit të EULEX-it në Kosovë. Në vitet pasuese kënaqëshmëria e qytetarëve me Prokurorin e Shtetit vetëm ka shënuar rënie, ndërsa në shtator 2015, ka shënuar rënien më të madhe. “Pulsi Publik 8” (Prishtinë: UNDP Kosovë, nëntor 2014), f.2.

<sup>39</sup> *Shënim*: Sistemi prokurorial në periudhën mars– shtator 2015 ka shënuar pikën më të ulët të të gjitha kohërave të besimit të qytetarëve në punën e prokurorisë prej vetëm 12.8% (përqindje të përafërt të kënaqëshmërisë kishte pasur vetëm në tetor 2012 me vetëm 15.0%) . Prokurori i Shtetit vetëm prej marsit deri në shtator 2015 ka pësuar një rënie prej 4.2% të kënaqëshmërisë, duke shënuar një trend të rënies së kënaqëshmërisë që paraqet shqetësim serioz. “Pulsi Publik 8” (Prishtinë: UNDP Kosovë, nëntor 2014), f.2.

Në mungesë të një baze unike të të dhënave në sistemin prokurorial, e cila identifikon profilet e personave të cilët janë subjekt i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, IKD ka monitoruar ueb faqen e PSh-së për periudhën nëntë mujore (1 janar – 30 shtator 2015) në lidhje me publikimin e aktakuzave në rastet e korrupsionit, duke përfshirë profilin e personave të akuzuar, numrin e zyrtarëve të akuzuar apo personave tjerë, vlerën e supozuar për dëmin e shkaktuar nga dyshimet për kryerjen e veprave penale të korrupsionit, dhe vlerën e paraqitur në aktakuzë për sekuestrim dhe konfiskim të dobisë së fituar me vepër penale.

Në bazë të këtij monitorimi, IKD ka gjetur se PSh ka bërë publikimin e informacioneve për ngritjen e aktakuzave në pesë raste, ku të përfshirë në bazë të pozitive janë: një (1) ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, një (1) ish-Kryetar Komune, një (1) ish-Sekretar i Përgjithshëm, 18 zyrtarë komunalë, gjashtë (6) pronar të kompanive, një (1) drejtor, një (1) drejtor instituti, tre (3) menaxherë, dy (2) zyrtar dhe një rast ndaj personave që ndërlidhet me dyshimet për keqpërdorime në ish-Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

IKD gjatë monitorimit të ueb faqes së PSh-së lidhur me publikimin e rasteve të korrupsionit ka gjetur se nuk aplikohen standarde dhe praktika të njëjta për të gjithë personat e akuzuar. Në raste të caktuara publikohen informata të detajuara lidhur me emrin, mbiemrin, pozitën e personave të dyshuar për vepra korruptive, përderisa në raste të caktuara, i referohen vetëm pozitive të personave të dyshuar, e në raste të tjera kur ka të përfshirë persona të profilit të lartë, nuk jepen fare informata lidhur me personin e dyshuar apo pozitën e tij. IKD ka vërejtur se PSh në publikimin e informatave dhe në informimin e publikut zbaton drejtësi selektive, duke aplikuar standarde të dyfishta për personat ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat.

Kjo vërehet, në rastin e ish-Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin PSh ka publikuar informata të detajuara lidhur me emrat<sup>40</sup> dhe pozitën e personave të dyshuar, ndërsa në rastin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit ku të akuzuar janë ish-Ministri Fatmir Limaj<sup>41</sup> dhe katër zyrtarë të kësaj ministrie, komunikata kufizohet vetëm në informimin e ngritjes së aktakuzës ndaj pesë të pandehurve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit. Përderisa, në rastin e Ministrisë së Shëndetësisë<sup>42</sup>, PSh gjatë publikimit të aktakuzës ndaj zyrtarëve të dyshuar për korrupsion, i referohet tetë të pandehurve, duke përfshirë pozitën që kanë

---

<sup>40</sup> Komunikatë nga PSRK lidhur me ngritjen e aktakuzës kundër z. Enver Hasani, ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës: 31 korrik 2015. Shih linkun <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,780>

<sup>41</sup> Komunikatë nga PSRK lidhur me ngritjen e aktakuzës së konsoliduar kundër z. Fatmir Limaj, ish-Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit: 29 korrik 2015. Shih linkun <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,804>

<sup>42</sup> Rasti i Ministrisë së Shëndetësisë. 6 korrik 2015. Shih linkun <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,769>

pasur. Poashtu, në rastin e Komunës së Prishtinës<sup>43</sup>, komunikata e publikuar i referohet vetëm pozitive të pandehurve, duke mos paraqitur emrat e personave të akuzuar.

Në rastin e Komunës së Prishtinës, sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, rezulton se të gjithë të pandehurit, si zyrtarë të Komunës së Prishtinës, së bashku u kanë mundësuar investitorëve që të ndërtojnë objekte kolektive banesore, në kundërshtim me ligjin për ndërtim, duke iu siguruar atyre dobi të mëdha materiale, si dhe nga shitja e banesave dhe lokaleve, dobi financiare në shumë të përgjithshme prej 28.503,922,00 euro. Përderisa, në komunikatën e publikuar nga PSRK, thuhet se nga të pandehurit janë konfiskuar dobi pasurore të fituar me veprën penale në vlerë prej 111.740.00 euro, 2.600.00 dollar dhe një (1) banesë 76.3 m<sup>2</sup>. Përderisa në rastin konkret, PSRK konfirmon se dobia financiare nga veprat penale e paraqitur në aktakuzë kap vlerën prej 28.503.922.00 euro, konfiskimi kap vlerën minimale që nuk shkon mbi 200.000.00 euro, apo as 1 % të vlerës së dëmit të shkaktuar. Nuk është e qartë se si PSRK kësaj pasurie i referohet si pasuri e konfiskuar<sup>44</sup> në këtë fazë të ngritjes së aktakuzës, pasi konfiskimi bëhet me vendim gjyqësor, siç përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale.<sup>45</sup> Po ashtu, gjatë monitorimit të rasteve të publikuara nga PSh, dhe informatave të dhëna, shihet një tendencë e rrallë dhe me vlera monetare minimale të parashtruara në kërkesën për sekuestrim apo konfiskim të dobisë pasurore të fituar përmes veprës penale. Kjo konfirmohet nga raportet dhe intervista e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike.<sup>46</sup> Në rastet kur ka potencial për sekuestrim dhe konfiskim dhe prokurorët e gjykatës nuk zbatojnë obligimet e tyre ligjore, ndaj tyre duhet të merren masa adekuate nga mekanizmat e llogaridhënies.<sup>47</sup> Akterë të shoqërisë civile vlerësojnë se KPK dhe KGJK nuk kanë arritur të adresojnë mjaftueshëm çështjen e ngritjes së resurseve dhe njohurive të

<sup>43</sup> Rasti i Komunës së Prishtinës. 12 qershor 2015. Shih linkun <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,759>

<sup>44</sup> IKD sqaron se këto informacione rreth konfiskimit janë referuar ekskluzivisht prej komunikatës së publikuar në ueb faqen e PSh-së. Nuk është e qartë se si dobia pasurore në vlerë prej rreth 200.000.00 euro, PSRK i referohet si pasuri e konfiskuar në fazën e ngritjes së aktakuzës. Dispozitat ligjore përcaktojnë qartë se kur konfiskohet një pasuri dhe nga kush dhe autoriteti i vetëm për konfiskimin e dobive pasurore është gjykata.

<sup>45</sup> Neni 115, "Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht". Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Miratuar më 13 dhjetor 2012. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

<sup>46</sup> "Përderisa jemi në një situatë sado kudo më të mirë rreth konfiskimit sipas KPRK-së dhe KPP-së, jemi në një situatë krejtësisht tjetër sa i përket konfiskimit të zgjeruar. Në këtë drejtim ky është një obligim ekskluziv i prokurorive ngase gjykatat nuk mund të vendosin pa një kërkesë nga ana e prokurorisë. Sipas informatave tona, në këta 36 muaj të hyrjes në fuqi të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurive të Fituara me Vepër Penale, ky ligj është aplikuar në një rast në PTh në Prishtinë (neni 8), një rast tjetër në PTh në Gjilan (neni 6), një rast tjetër potencial në PTh në Prishtinë (neni 8) dhe mbase në një rast tjetër në PSRK. Përpos rastit në PSRK, të gjitha rastet tjera janë inicuar nën sugjerimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike. Nuk do mend shumë për të konstatuar se ky ligj paraqet një sfidë të prokurorisë në zbatimin e tij, ngase për këta 36 muaj, aplikimi i tij është thuajse në nivelin fillestar. Konsiderojmë se kjo është shumë më tepër përgjegjësi e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore". IKD intervistë me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, z. Shqipdon Fazliu. Dhjetor 2015.

<sup>47</sup> IKD intervistë Drejtorin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, z. Fisnik Korenica. Nëntor 2015.

prokurorëve dhe gjykatësve rreth zbatimit të dispozitave të reja të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurive të Fituara me Vepër Penale. Edhe kjo është një prej aspekteve pse nuk ka zbatim të dispozitave të këtij ligji.<sup>48</sup>

IKD vlerëson se performanca në luftimin e dobive pasurore duhet të matet ekskluzivisht me aktgjykime përfundimtare që sjellin konfiskim, në të kundërtën, veprimet procedurale nuk janë reprezentative për të treguar gjendjen reale, gjithnjë bazuar në praktikat e mbrapshta të ndërtuara deri më tash.<sup>49</sup>

Çështja e raportimeve në publik rreth sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive të fituara përmes veprave penale nga akterë të shoqërisë civile vlerësohet më shumë si presion i institucioneve të drejtësisë për të dëshmuar rezultate në procesin e liberalizimit të vizave se sa që realisht ka rezultate konkrete. Suksesi në luftimin e pasurive të fituara përmes krimit duhet të matet me aktgjykime përfundimtare të gjykatave dhe jo me statistikave të masave të përkohshme, përmes të cilave mëtohet të krijohet përshtypja se janë konfiskuar miliona pasuri që në realitet nuk qëndron.<sup>50</sup> Në tabelën më poshtë janë paraqitur rastet e ngritjes së aktakuzave ndaj personave që disa prej tyre konsiderohen pozita të larta.

---

<sup>48</sup> IKD intervistë me Përfaqësuesin Ligjor të Organizatës Çohu, z. Arton Demhasaj. Nëntor 2015.

<sup>49</sup> IKD rikujton se veprime procedurale në drejtim të arrestimit, ngritje së aktakuzave dhe sekuestrimit të pasurive ka pasur edhe në të kaluarën, por në procedurë gjyqësore, pjesa dërrmuese e këtyre rasteve kanë përfunduar me dështime për organin e akuzës. Prandaj, veprimet procedurale nuk janë reprezentative përderisa të njëjtat nuk përfundojnë me aktgjykime përfundimtare, duke provuar në gjykata, pretendimet e prokurorëve në aktakuza.

<sup>50</sup> IKD intervistë me Huluntuesen e Lartë në Institutin KIPRED, znj. Ariana Qosaj Mustafa. Nëntor 2015.

<b>Data</b>	<b>Pozita e personit të akuzuar</b>	<b>Vlera e dëmit të shkaktuar</b>	<b>Kërkesa për sekuestrim/konfiskim</b>	<b>Numri i personave</b>	<b>Prokuroria</b>
<b>08.05.2015</b>	1 ish-Kryetar Komune; 8 zyrtarë komunal; 3 pronar të operatorëve ekonomikë; 2 qytetar	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	14	PSRK
<b>12.06.2015</b>	10 zyrtar komunal; 1 zyrtar kompanie	28.503,922,00 Euro	111.740.00 euro; 2.600.00 dollar, 1 banesë; 76.3m <sup>2</sup>	11	PSRK
<b>06.07.2015</b>	1 ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë; 1 Drejtor MSh; 1 ish-menaxher i prokurimit; 3 zyrtarë MSh, 2 bashkëpronarë biznesesh	700.000.00 Euro	Janë ngrirë dy prona të paluajtshme dhe një ndërtesë	8	PSRK
<b>31.07.2015</b>	1 ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese; 1 ish-shef i prokurimit në UP; 1 Drejtor i Institutit - Tiranë	70.426.90 Euro	Nuk ka informacion	3	PSRK
<b>29.07.2015</b>	Aktakuzë e konsoliduar në rastin MTPT	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	5	PSRK

Tabela 2 - Tabela nga monitorimi i ueb faqes së PSh-së (1 janar-30 shtator 2015)

#### d) Performanca e Prokurorive Themelore të Republikës së Kosovës

##### 1) Performanca e Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Në PTh në Prishtinë, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 49<sup>51</sup> prokurorë. Me hyrjen në fuqi të planit të veprimit, PTh në Prishtinë kishte në punë 224 raste me 777 persona, përderisa kjo prokurori në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 391 raste me 1094 persona. Nga hyrja në fuqi e këtij plani deri më 30 shtator 2015, kjo prokurori ka pranuar në punë 336 raste të reja me 628 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhe ka zgjidhur 203 raste me 410 persona. Nga ky numër i përgjithshëm, ndaj 95 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 94 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 221 personave janë ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Prishtinë gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 221 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 189 personave.

Vetëm për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Prishtinë ka arritur të zgjidhë raste ndaj 44 personave, prej tyre ndaj 24 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 10 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 10 personave i ka pushuar hetimet.

PTh në Prishtinë edhe gjatë kësaj periudhe kohore vazhdon të përballet me një trend të ulët të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, dhe me ngritje të numrit të rasteve të pazgjidhura dhe ndaj personave të përfshirë në këto raste. Si rezultat, kjo prokurori nuk ka arritur të ndikoj në uljen e numrit të rasteve të pazgjidhura, përkundrazi ka shënuar rritje. Në raport me numrin e 45 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, del se çdo prokuror i kësaj prokurorie ka zgjidhur afërsisht 4.5 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokuror ka zgjidhur brenda një viti ka 2.25 raste.

IKD në të gjitha raportet periodike të monitorimit ka ofruar gjendjen reale të trajtimit të rasteve të korrupsionit në PTh në Prishtinë dhe ka ofruar rekomandime konkrete se si të adresohen problemet për të shtuar efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. Me qëllim të mbështetjes së PTh në Prishtinë, për të adresuar me prioritet rastet e korrupsionit, IKD ka zhvilluar takime të vazhdueshme në kuadër të monitorimit me Kryeprokurorin e kësaj prokurorie, z. Imer Beka. Duke pasur parasysh problemet me të

---

<sup>51</sup> PTh në Prishtinë ka 54 pozita të lejuara për prokurorë, por i ka të plotësuara 49 pozita.

cilat përballet kjo prokurori, si prokuroria më e madhe në sistemin prokurorial, takimet janë fokusuar në zbatimin e rekomandimeve të IKD-së, për hartimin e një plani të veprimit për ngritjen e efikasitetit të PTh në Prishtinë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Në këtë drejtim, IKD ka hartuar planin e veprimit, i cili plan është diskutuar në kolegjiunin e prokurorëve të PTh në Prishtinë dhe i njëjti plan është miratuar më 25 gusht 2015<sup>52</sup>. Si rezultat i miratimit të këtij plani janë krijuar dy komisione të prokurorëve, të udhëhequra nga Kryeprokurori Imer Beka, për të trajtuar me prioritet rastet e vjetra të korrupsionit të regjistruara deri më 4 nëntor 2013. IKD është duke monitoruar PTh në Prishtinë në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe zbatimit të këtij plani të veprimit, për të cilin do të paraqes rezultatet në raportet e ardhshme.

Sfidat kryesore më të cilat ballafaqohet PTh në Prishtinë në trajtimin e rasteve të korrupsionit janë rastet e vjetra të trashëguara ndër vite dhe numri i pamjaftueshëm i prokurorëve për t'iu bërë ballë të gjitha lëndëve të gjitha natyrave.<sup>53</sup> Kjo prokurori ende përballet me lëndë të vjetra të korrupsionit të parashtruara qysh në vitin 2004 e tutje. Zvarritjet në zgjidhjen e këtyre lëndëve të vjetra të korrupsionit, humbin efektin me kalimin e kohës dhe vështirësohet çështja e zbulimit të provave dhe dëshmitarëve për të zbardhur korrupsionin, i cili mund të ketë ndodhur, sipas parashtrimit të kallëzimit penal.

Në të njëjtën kohë, mostrajtimi i këtyre rasteve të vjetra të korrupsionit, paraqet paradoks në vete, për shkak të pasojave të mëdha që mund të shkaktohen në shumë dimensione. Fillimisht shkelen liritë dhe të drejtat e individëve të përfshirë në këto evidenca penale dhe kjo krijon pasiguri të madhe juridike tek secili prej personave që përfshihet në kallëzime penale, të cilat nuk trajtohen me dekada. Poashtu, nëse supozohet se kallëzimi penal i parashtruar vërteton përfshirjen e një zyrtari në vepra penale të korrupsionit, dhe i njëjti nuk trajtohet me dekada, atëherë ky zyrtar mund të punoj pa pengesa me vite të tra në institucione për shkak të mos trajtimit të rastit ndaj tij.<sup>54</sup>

PTh në Prishtinë është prokuroria më e madhe në Republikën e Kosovës dhe njëherësh prokuroria më e ngarkuar me numrin e lëndëve të korrupsionit, për shkak të për qëndrimit të administratës shtetërore në Kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën. Prej miratimit të planit të veprimit për PTh në Prishtinë, gjatë monitorimit vërehet një frymë më pozitive për të trajtuar rastet e vjetra të

<sup>52</sup> Kryeprokurori i PTh në Prishtinë, z. Imer Beka, ka shprehur gatishmërinë që të bashkëpunojë me IKD-në në hartimin e planit të veprimit, duke pasur parasysh përvojën e monitorimit të gjendjes me rastet e korrupsionit dhe rekomandimet e vazhdueshme të bëra për këtë prokurori për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Vullneti i Kryeprokurorit Beka dhe bashkëpunimi kanë rezultuar me hartimin e një dokumenti me vlerë, i cili nëse zbatohet do të sjellë rezultate konkrete në trajtimin e rasteve të vjetra të korrupsionit, të cilat po e rëndojnë punën e PTh në Prishtinë.

<sup>53</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë, z. Imer Beka. Nëntor 2015.

<sup>54</sup> "Mos me dalë ne mandej me u bo gaz i botës, e kemi lëndën e vitit 2001 s'është kry deri në 2015. Edhe çfarë efekti ka nëse sot e ndjekim dikë për korrupsion që e ka kry një vepër penale në 2008, 2009, 2010 ai është hala duke ushtrru funksion publik në ndërmarrje publike ose në administratë të Qeverisë a Kuvendit apo ku po e di unë", citat i Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh Kryetari i KPK-së, z. Aleksandër Lumezi. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 8 tetor 2015.

korupsionit, por kjo mbetet të shihet si do të rezulton në praktikë. IKD vlerëson se numri i tanishëm i prokurorëve dhe respektimi i planit të veprimit të miratuar nga PTh në Prishtinë duhet të sjellin rezultate konkrete në trajtimin e rasteve të korupsionit.

#### **Karakteristikat për PTh në Prishtinë:**

1. Numri i lartë i rasteve të korupsionit dhe personave të përfshirë në raste të korupsionit;
2. Numri i ultë i rasteve të trajtuara të korupsionit,
3. Numër më i madh i ngritjes së aktakuzave ndaj personave të përfshirë në korupsion në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë mbyllur rastet;
4. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale;

## **2) Performanca e Prokurorisë Themelore në Prizren**

Në PTh në Prizren, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 16 prokurorë.<sup>55</sup> Kjo prokurori me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 70 raste të pazgjidhura me 175 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 24 raste të pazgjidhura me 63 persona. Kjo prokurori prej hyrjes në fuqi të këtij plani deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 94 raste të reja me 192 persona, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 133 raste me 294 persona. Prej tyre ndaj 72 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 90 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 132 personave ka ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor rezulton se PTh në Prizren gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve më shumë ka mbyllur raste sesa që ka akuzuar persona të përfshirë në rastet e korupsionit, përkatësisht ka mbyllur rastet ndaj 162 personave, ndërsa ka akuzuar 132 persona për vepra penale të korupsionit.

Vetëm për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Prizren ka arritur të zgjidhë raste ndaj 30 personave, prej tyre ndaj 18 personave ka ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 12 personave i ka pushuar hetimet.

<sup>55</sup> PTh në Prizren ka 18 pozita të lejuara për prokurorë, por 2 pozita ende nuk janë plotësuar.

PTh në Prizren që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit. Respektivisht, kjo prokurori ka arritur rezultate sa i përket uljes së numrit të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit dhe personave të përfshirë në këto vepra penale. Në raport me numrin e 13 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, del se çdo prokuror i kësaj prokurorie ka afërsisht 10.2 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht secili prokuror ka zgjidhur brenda një viti 5.1 raste.

Sfidat kryesore në trajtimin e rasteve të korrupsionit mbesin numri i vogël i prokurorëve dhe komplikueshmëria e rasteve të korrupsionit, të cilat kërkojnë më shumë kohë në përfundimin e suksesshëm të hetimeve.<sup>56</sup>

Kryetari i GjTh në Prizren duke ju referuar rasteve të korrupsionit që janë në trajtim nga gjykatësit e kësaj gjykate, pohon se profili i personave të akuzuar prej PTh në Prizren llogaritet profili i mesëm ku hyjnë drejtorët e institucioneve të ndryshme dhe zyrtarët komunal.<sup>57</sup> Cilësia e aktakuzave në raste të caktuara nuk është e nivelit të kërkuar, prandaj të njëjtat ndodhë të kthehen mbrapsht për përmirësim apo të hudhen poshtë për shkak të moskompletimit apo mungesës së provave<sup>58</sup>.

#### **Karakteristikat për PTh në Prizren:**

1. Trend pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
2. Numri më i lartë i personave ndaj të cilëve janë pushuar hetimet apo janë hudhur kallëzimet penale, në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat;
3. Nuk ka pasur asnjë kërkesë për sekuestrim dhe konfiskim

### **3) Performanca e Prokurorisë Themelore në Pejë**

<sup>56</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Prizren, z. Sylë Hoxha. Nëntor 2015.

<sup>57</sup> IKD intervistë me Kryetarin e GjTh në Prizren, z. Ymer Hoxha. Nëntor 2015.

<sup>58</sup> Po aty.

Në PTh në Pejë, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 13 prokurorë.<sup>59</sup> Kjo prokurori me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 37 raste me 86 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 40 raste me 77 persona. PTh në Pejë nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 94 raste të reja me 156 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 92 raste me 176 persona. PTh në Pejë në rastet ndaj 176 personave, ndaj 34 personave është hudhur kallëzimi penal, ndaj 87 personave janë pushuar hetimet, përderisa ka ushtruar aktakuzë ndaj 55 personave. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Pejë gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 55 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 121 personave.

Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Pejë ka arritur të zgjidhë raste ndaj 3 personave, prej tyre ndaj 2 personave ka ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 1 personi ka hudhur poshtë kallëzimin.

PTh në Pejë që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend negativ të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, respektivisht nga 37 raste që ka pasur në punë në kohën e hyrjes në fuqi të planit të veprimit, në shtator të vitit 2015, ky numër është ngritur në 40 raste. Përderisa, në raport me numrin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit, kjo prokurori ka zvogëluar numrin nga 86 persona sa kishte më 4 nëntor 2013, në 77 persona në fund të shtatorit 2015. Në raport me numrin e 11 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, rezulton se çdo prokuror i kësaj prokurorie ka zgjidhur afërsisht 8.4 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokuror brenda një viti ka zgjidhur nga 4.2 raste.

#### **Karakteristikat për PTh në Pejë:**

1. Trend i ultë i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
2. Numri i lartë i personave ndaj të cilëve janë pushuar hetimet apo janë hudhur kallëzimet penale, në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat;
3. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

<sup>59</sup> PTh në Pejë ka 15 pozita të lejuara për prokurorë, por 2 pozita ende nuk janë plotësuar.

Kryetarja e GjTh në Pejë pohon se niveli i korrupsionit që ndiqet dhe profili i personave që akuzohen në këtë Gjykatë i takon kryesisht profilit të ulët. Në raste të rralla, prokurorët ngrisin aktakuza ndaj profilit të mesëm që mund të vijnë kryesisht prej administratës lokale në Pejë.<sup>60</sup>

Kryeprokurori i PTh në Pejë vlerëson performacën e prokurorëve të kësaj prokurorie, duke renditur atë në mesin e prokurorive që kanë shënuar sukses në zbatimin e obligimeve të planit të veprimit. Sa i përket luftimit të profilit të lartë, prokurorët ndërmarrin veprime për të gjitha rastet që iniciohen nga parashtruesit apo edhe me vetëiniciativë, por nuk mund të ndiqet askush pa pasur prova dhe dëshmi.<sup>61</sup>

#### 4) Performanca e Prokurorisë Themelore në Gjilan

Në PTh në Gjilan, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 15 prokurorë.<sup>62</sup> Kjo prokurori me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 23 raste të pazgjidhura me 81 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 16 raste të pazgjidhura me 25 persona. PTh në Gjilan nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 66 raste të reja me 116 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 82 raste me 187 persona. Prej tyre, ndaj 59 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 43 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 84 personave janë ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Gjilan gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 84 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 102 personave. Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Gjilan ka arritur të zgjidhë raste ndaj 8 personave, prej tyre ndaj 6 personave ka ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 2 personave i ka pushuar hetimet.

PTh në Gjilan që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, respektivisht nga 23 raste që ka pasur në punë në kohën e hyrjes në fuqi të planit të veprimit, në shtator të vitit 2015, ky numër është ulur në 16 raste. Përderisa, në raport me numrin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit, kjo prokurori po ashtu ka ulur numrin nga 81 persona sa kishte më 4 nëntor 2013, në 25 persona në fund të shtatorit 2015. Në raport me numrin e 15 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, del se çdo prokuror i

---

<sup>60</sup> IKD intervistë me Kryetaren e GjTh në Pejë, znj. Elmaze Sylja. Nëntor 2015.

<sup>61</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Pejë, z. Agron Galani. Nëntor 2015.

<sup>62</sup> PTh në Gjilan ka 17 pozita të lejuara për prokurorë, por 2 pozita ende nuk janë plotësuar.

kësaj prokurorie ka zgjidhur afërsisht 5.5 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokurorë brenda një viti ka zgjidhur nga 2.25 raste.

#### Karakteristikat për PTh në Gjilan:

4. Trend pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
5. Numri me i lartë i personave ndaj të cilëve janë pushuar hetimet apo janë hudhur kallëzimet penale, në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat;
6. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

Performanca e kësaj prokurorie sa i përket rasteve të vjetra të korrupsionit ka shënuar suksesin më të madh prej të gjitha prokurorive, duke i trajtuar me prioritet këto lëndë.<sup>63</sup> Profili i personave të ndjekur nga kjo prokurori në raste të caktuara arrin profilin e lartë, duke përfshi ish-Kryetarët e Komunave të Rajonit të Gjilanit, të cilët tanimë gjenden në procedura gjyqësorë në GjTh në Gjilan.<sup>64</sup>

#### 5) Performanca e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

Në PTh në Mitrovicë, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 10 prokurorë.<sup>65</sup> Kjo prokurori, e cila prej shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, vazhdon të përballet me kushte elementare për punë, me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 64 raste të pazgjidhura me 141 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 69 raste me 148 persona. PTh në Mitrovicë nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 73 raste të reja me 143 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 67 raste me 150 persona. Prej tyre ndaj 49 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 11 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 90 personave janë ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Mitrovicë gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 90 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 60 personave.

<sup>63</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Gjilan, z. Jetish Maloku. Dhjetor 2015.

<sup>64</sup> IKD intervistë me Kryetarin e GjTh në Gjilan, z. Zyhdi Haziri. Nëntor 2015.

<sup>65</sup> PTh në Mitrovicë ka 14 pozita të lejuara për prokurorë, por 4 prej tyre ende nuk i ka plotësuar.

Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Mitrovicë ka arritur të zgjidhë raste ndaj 12 personave, prej tyre ndaj 6 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 2 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 4 personave i ka pushuar hetimet.

#### Karakteristikat për PTh në Mitrovicë:

1. Trend i ultë i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
2. Numër më i madh i ngritjes së aktakuzave ndaj personave të përfshirë në korrupsion në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë mbyllur rastet;
3. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

PTh në Mitrovicë që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend negativ të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, respektivisht nga 64 raste të pazgjidhura që ka pasur në punë në kohën e hyrjes në fuqi të planit të veprimit, në shtator të vitit 2015, ky numër është ngritur në 69 raste. Përderisa, në raport me numrin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit, në këtë prokurori është rritur numri i personave të përfshirë në rastet e korrupsionit nga 141 persona sa kishte më 4 nëntor 2013, në 148 persona në fund të shtatorit 2015. Në raport me numrin e 8 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, rezulton se çdo prokurorë i kësaj prokurorie ka zgjidhur afërsisht 8.4 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokuror ka zgjidhur brenda një viti 4.2 raste.

Performanca e prokurorëve të kësaj prokurorie ka qenë e kënaqshme duke pasur parasysh kushtet në të cilat punojnë prokurorët dhe stafi i kësaj prokurorie.<sup>66</sup> Rritja e kësaj performance do të ndodhë krahas rritjes së numrit të prokurorëve dhe kushteve adekuate për punë në prokurori.<sup>67</sup>

<sup>66</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja. Tetor 2015.

<sup>67</sup> IKD intervistë me ud. Kryeprokurorin e PTh në Mitrovicë, z. Ismet Ujkani. Nëntor 2015.

## 6) Performanca e Prokurorisë Themelore në Ferizaj

Në PTh në Ferizaj, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 12 prokurorë.<sup>68</sup> Kjo prokurori me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 37 raste të pazgjidhura me 126 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 24 raste të pazgjidhura me 52 persona. PTh në Ferizaj nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 66 raste të reja me 119 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 83 raste me 193 persona. Prej tyre, ndaj 34 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 26 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 133 personave janë ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Ferizaj gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 133 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 60 personave.

Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Ferizaj ka arritur të zgjidhë raste ndaj 36 personave, prej tyre ndaj 20 personave ka ngritur aktakuza, ndaj 4 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 12 personave i ka pushuar hetimet.

### Karakteristikat për PTh në Ferizaj:

1. Trend pozitiv i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
2. Numër më i madh i ngritjes së aktakuzave ndaj personave të përfshirë në korrupsion në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë mbyllur rastet;
3. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

PTh në Ferizaj që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, respektivisht nga 37 raste që ka pasur në punë në kohën e hyrjes në fuqi të planit të veprimit, në shtator të vitit 2015, ky numër është ulur në 24 raste. Përderisa, në raport me numrin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit, kjo prokurori po ashtu ka ulur në mënyrë të ndjeshme numrin nga 126 persona sa kishte me 4 nëntor 2013, në 52 persona në fund të shtatorit 2015. Në raport me numrin e 9 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda me numrin e rasteve të

<sup>68</sup> PTh në Ferizaj ka 14 pozita të lejuara për prokurorë, por 2 pozita ende nuk janë plotësuar.

zgjidhura, rezulton se çdo prokuror ka zgjidhur afërsisht 9.2 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokurorë ka zgjidhur brenda një viti 4.6 raste.

Shumica e rasteve të aktakuzave të ngritura në GjTh në Ferizaj janë të profilit të ulët, eventualisht të mesëm, ndërsa ekziston një rast i profilit të lartë (Kryetar Komune), i cili është në proces në këtë gjykatë.<sup>69</sup>

### 7) Performanca e Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Në PTh në Gjakovë, funksionin e prokurorit e ushtrojnë 12 prokurorë.<sup>70</sup> Kjo prokurori me hyrjen në fuqi të planit të veprimit kishte në punë 26 raste të pazgjidhura me 64 persona, përderisa në fund të muajit shtator 2015, ka në punë 23 raste të pazgjidhura me 41 persona. PTh në Gjakovë nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, ka pranuar në punë 45 raste të reja me 98 persona të përfshirë, përderisa gjatë të njëjtës periudhë ka zgjidhur 67 raste me 125 persona. Prej tyre, ndaj 28 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 24 personave janë pushuar hetimet, përderisa ndaj 73 personave janë ngritur aktakuza. Në bazë të këtij raporti statistikor, rezulton se PTh në Gjakovë gjatë kësaj periudhe kohore prej 23 muajve ka akuzuar 73 persona për vepra penale të korrupsionit, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 52 personave.

Për periudhën tre mujore (korrik, gusht, shtator 2015), PTh në Gjakovë ka arritur të zgjidhë raste ndaj 4 personave, ndaj të cilëve ka ngritur aktakuza.

#### Karakteristikë për PTh në Gjakovë:

1. Trend pozitiv i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit;
2. Numër më i madh i ngritjes së aktakuzave ndaj personave të përfshirë në korrupsion në raport me numrin e personave ndaj të cilëve janë mbyllur rastet;
3. Numri dhe vlera e ulët e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.

<sup>69</sup> IKD intervistë me Kryetarin e GjTh në Ferizaj, z. Bashkim Hyseni. Nëntor 2015.

<sup>70</sup> PTh në Gjakovë ka 14 pozita të lejuara për prokurorë, por 2 pozita ende nuk i ka plotësuar.

PTh në Gjakovë që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka arritur trend të lehtë pozitiv të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, respektivisht nga 26 raste që ka pasur në punë në kohën e hyrjes në fuqi të planit të veprimit, në shtator të vitit 2015, ky numër është ulur në 23 raste. Përderisa, në raport me numrin e personave të përfshirë në rastet e korrupsionit, kjo prokurori ka zvogëluar numrin nga 64 persona sa kishte më 4 nëntor 2013, në 41 persona në fund të shtatorit 2015. Në raport me numrin e 10 prokurorëve në këtë prokurori të caktuar në Departamentin e Përgjithshëm dhe atë të Krimeve të Rënda dhe me numrin e rasteve të zgjidhura, rezultoi çdo prokuror i kësaj prokurorie ka zgjidhur afërsisht 6.7 raste që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit, respektivisht çdo prokuror ka zgjidhur brenda një viti 3.5 raste.

## ZGJIDHJA E RASTEVE TË KORRUPSIONIT SIPAS PARASHTRUESVE TË VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT

### e) Performanca e kallëzimeve penale të parashtruesve të ndryshëm

IKD përmes tabelës së mëposhtme, pasqyron trendin e numrit të personave të paraqitur përmes kallëzimeve penale të iniciuara nga institucionet dhe agjencitë që zbatojnë ligjin në Kosovë, qytetarët, të dëmtuarit, rastet e iniciuara me vet-iniciativë nga prokurorët etj, mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve dhe numrin e personave ndaj të cilëve rastet e korrupsionit ende nuk janë zgjedhur.

RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL (04.11.2013 - 30.09.2015)							
Parashtruesit e kallëzimeve penale	Të pazgjidhura në fillim (04.11.2014)	Të pranuar (04.11.2013 deri më 30.09.2015)	Të zgjidhura	Mënyra e zgjidhjes			Të pazgjidhura në fund (30.09.2015)
				Hudhje	Pushim	Aktakuzë	
	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona
<b>Agjencia Kundër Korrupsionit</b>	341	266	217	42	70	105	391
<b>Agjencia Kosovare e Pronës</b>		5	15	5		10	
<b>Administrata Tatimore e Kosovës</b>	2						2
<b>Doganat e Kosovës</b>	13	8	1			1	20
<b>EULEX</b>	39	3	13	1	1	11	25
<b>Inspektorari Policor i Kosovës</b>	30	68	47	5	12	30	61
<b>Policia e Kosovës</b>	855	750	1,028	141	267	620	668
<b>Qytetari</b>	139	148	126	46	64	16	158
<b>I dëmtuari</b>	134	239	206	135	37	34	225
<b>Organi i Administratës Komunale</b>	9	4	9	2	3	4	3
<b>Titullari i Pronës</b>	56	15	28	14	4	10	46
<b>Autoriteti Pyjor i Kosovës</b>	14		12		11	1	2
<b>Prokurori me Vetëiniciativë</b>	46	19	6	4	2		56
<b>Njësia për Inteligjencë Financiare</b>	2		2		2		
<b>I paidentifikuar</b>	2	7	12	9		3	1
<b>Pranuar në kompetencë</b>		94	35	2	3	30	95
<b>Total:</b>	1,682	1,626	1,757	406	476	875	1,753

Tabela 3 - Trendet e rasteve të korrupsionit sipas parashtruesve prej 04.11.2013 deri më 30.09.2015

Prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 shtator 2015 PTh-të dhe PSRK kanë pasur në punë 1,334 raste me 3308 persona. Prokuroritë kanë zgjidhur rastet ndaj 1757 personave, përderisa kanë mbetur në punë raste të pazgjidhura ndaj 1753 personave.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së këtyre rasteve ndaj 1757 personave, numri më i madh i rasteve është mbyllur. Prej tyre ndaj 406 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 476 personave janë pushuar hetimet, ndërsa ndaj 875 personave janë ngritur aktakuza.

### **1) Performanca e kallëzimeve penale të Policisë së Kosovës**

Policia e Kosovës (në vazhdim si PK) vazhdon të jetë parashtruesi me numrin më të madh të rasteve të korrupsionit në PSh. Përderisa në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit me 4 nëntor 2013, PSh kishte në punë raste të pazgjidhura të parashtruara nga PK ndaj 855 personave të përfshirë, më 30 shtator 2015, ky numër është zvogëluar në rastet të pazgjidhura të parashtruara nga PK, ndaj 668 personave të përfshirë. PK që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka parashtruar raste të reja në Prokurori, ndaj 750 personave të përfshirë. PSh që nga plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 1028 personave të paraqitura nga PK, prej të cilave, ndaj 141 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 267 personave janë pushuar hetimet, kurse ndaj 620 personave janë ngritur aktakuza. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 60.31% të personave janë ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 39.69% të personave janë mbyllur rastet.

### **2) Performanca e kallëzimeve penale të Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Agjencia Kundër Korrupsionit (në vazhdim si AKK), pas PK-së, vazhdon të jetë parashtruesi me numrin më të madh të rasteve të korrupsionit. Përderisa në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013, PSh kishte në punë raste të pazgjidhura të parashtruara nga AKK me 341 persona të përfshirë, më 30 shtator 2015, ky numër është rritur në rastet e pazgjidhura të parashtruara nga AKK, me 391 persona të përfshirë. AKK që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka parashtruar raste të reja në prokurori, ndaj 266 personave të përfshirë. PSh që nga plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 217 personave të paraqitura nga AKK, prej të cilave, ndaj 42 personave janë hudhur kallëzimet penale, ndaj 70 personave janë pushuar hetimet, kurse ndaj 103 personave janë ngritur aktakuza. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 47.46 % të personave janë ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 52.54 % të personave janë mbyllur rastet. Performanca e sistemit prokurorial dhe sistemit gjyqësor karrshi parashtrimin të kallëzimeve penale nga AKK vlerësohet e dështuar.<sup>71</sup>

---

<sup>71</sup> "Akuzat e Hasanit"; Gazetaexpress.com Shih linkun <http://www.gazetaexpress.com/arkiva/akuzat-e-hasanit-65321/>

### **3) Performanca e kallëzimeve penale të EULEX-it**

Në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013, PSh kishte në punë raste të pazgjidhura të parashtruara nga EULEX-i ndaj 39 personave të përfshirë, përderisa më 30 shtator 2015, ky numër është ulur në rastet e pazgjidhura të parashtruara nga EULEX-i në 25 persona të përfshirë. EULEX-i që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka parashtruar raste të reja në Prokurori, ndaj 3 personave të përfshirë. PSH që nga Plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 13 personave të paraqitura nga EULEX-i, prej të cilave, ndaj 1 personi është hudhur kallëzimi penal, ndaj 1 personi janë pushuar hetimet, kurse ndaj 11 personave është ngritur aktakuzë. Përqindja: Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 84.61 % të personave është ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 15.49 % të personave janë mbyllur rastet.

### **4) Performanca e kallëzimeve penale të Inspektoratit Policor të Kosovës**

Inspektorati Policor i Kosovës (në vazhdim si IPK ), në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013, kishte raste të pazgjidhura në Prokurori, ndaj 30 personave të përfshirë. Ndërsa më 30 shtator 2015, ky numër është rritur në rastet e pazgjidhura të parashtruara nga IPK, me 61 persona të përfshirë. IPK që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit ka parashtruar raste të reja në Prokurori, ndaj 68 personave të përfshirë. PSh që nga plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 47 personave të paraqitura nga IPK, prej të cilave, ndaj 5 personave është hudhur kallëzimi penal, ndaj 12 personave janë pushuar hetimet, kurse ndaj 30 personave është ngritur aktakuzë. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 63.82 % të personave është ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 36.18 % të personave janë mbyllur rastet.

### **5) Performanca e kallëzimeve penale të qytetarëve**

Në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013, PSh kishte në punë raste të pazgjidhura të parashtruara nga qytetarët ndaj 139 personave të përfshirë, përderisa me 30 shtator 2015, ky numër është ngritur në rastet e pazgjidhura të parashtruara nga qytetarët në 158 persona të përfshirë. Qytetarët që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit kanë parashtruar raste të reja në Prokurori, ndaj 148 personave të përfshirë. PSh që nga Plani i veprimit deri me 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 126 personave të paraqitura nga qytetarët, prej të cilave, ndaj 46 personave është hudhur kallëzimi penal, ndaj 64 personave janë

pushuar hetimet, kurse ndaj 16 personave është ngritur aktakuzë. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 12.69 % të personave është ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 87.31 % të personave janë mbyllur rastet.

#### **6) Performanca e kallëzimeve penale te palëve të dëmtuara**

Në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit me 4 nëntor 2013, PSH kishte në punë raste të pazgjidhura të parashtruara nga të dëmtuarit nga veprat penale të korrupsioni ndaj 134 personave të përfshirë, përderisa me 30 shtator 2015, ky numër është ngritur në rastet e pazgjidhura të parashtruara nga të dëmtuarit në 225 persona të përfshirë. Të dëmtuarit që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit kanë parashtruar raste të reja në Prokurori, ndaj 239 personave të përfshirë. PSh që nga plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 206 personave të paraqitura nga të dëmtuarit, prej të cilave, ndaj 135 personave është hudhur kallëzimi penal, ndaj 37 personave janë pushuar hetimet, kurse ndaj 34 personave është ngritur aktakuzë. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 16.50 % të personave është ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 83.50 % të personave janë mbyllur rastet.

#### **7) Performanca e kallëzimeve penale të prokurorëve me vetiniciativë**

Në fillim të hyrjes në fuqi të planit të veprimit më 4 nëntor 2013, PSh kishte në punë raste të pazgjidhura raste të iniciuara me vet iniciativë nga prokurorët veprat penale të korrupsioni ndaj 46 personave të përfshirë, përderisa më 30 shtator 2015, ky numër është ngritur në rastet e pazgjidhura të iniciuara nga prokurorët me vet iniciativë në 56 persona të përfshirë. Prokurorët që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit kanë iniciuar raste të reja me vet iniciativë ndaj 19 personave të përfshirë. PSh që nga plani i veprimit deri më 30 shtator 2015, ka zgjidhur rastet ndaj 6 personave të iniciuara nga prokurorët me vet iniciativë, prej të cilave ndaj 4 personave është hudhur kallëzimi penal, ndaj 2 personave janë pushuar hetimet, kurse nuk është ngritur asnjë aktakuzë lidhur me të këto raste. Nëse analizohet me përqindje, rezulton se ndaj 100% të personave janë mbyllur rastet.

#### **IV. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT: ZGJIDHJA E RASTEVE TË REGJISTRUARA DERI MË 4 NËNTOR 2013**

Me hyrjen në fuqi të planit të veprimit PSh, ka pasur në punë 516 raste të pazgjidhura të korrupsionit ndaj 1632 personave. Prej hyrjes në fuqi të këtij plani deri më datë 30 shtator 2015, prokuroritë kanë zgjidhur rastet ndaj 1001 personave. Prej tyre ndaj 214 personave prokuroritë kanë hudhur kallëzimet penale, apo ndaj 21.38% të tyre, ndaj 317 personave kanë pushuar hetimet, apo 31.67% të tyre, ndaj 35 personave kanë ngritur aktakuzë me urdhër ndëshkimor apo ndaj 3.5% të tyre, ndaj 44 personave kanë ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë apo ndaj 4.40% të tyre dhe ndaj 391 personave kanë ngritur aktakuzë pas hetimeve apo ndaj 39.06% perqind të tyre.

Sa i përket përmbushjes së planit të veprimit, respektivisht raportit në mes numrit të personave që kanë qenë subjekt të procedurave penale lidhur me veprat penale të korrupsionit të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, me numrin e personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet e korrupsionit prin PTh në Pejë dhe Gjiilan me 100% të normës së plotësuar. Përderisa, PTh në Ferizaj, ka zgjidhur 95% të rasteve, PTh në Prizren 90% të rasteve, PTh në Gjakovë 85% të rasteve, PTh në Mitrovicë 82% të rasteve. Performancën më të dobët të zgjidhjes së rasteve të korrupsionit e mbyllin PSRK me vetëm 59% të rasteve të zgjedhura dhe PTh në Prishtinë me vetëm 30% të rasteve të zgjidhura.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, PSRK prin me numrin e madh të hudhjeve të kallëzimeve penale dhe të pushimit të hetimeve, ndaj gjithsej 97 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale të korrupsionit, apo ndaj 70.29% prej tyre. Përderisa vetëm ndaj 41 personave është ngritur aktakuzë apo 29.71% të tyre. PTh në Prishtinë, ka ngritur aktakuzë ndaj 102 personave dhe ka pushuar hetimet apo ka hudhur kallëzimin penal ndaj 138 personave. Në përqindje, ndaj 42.5 personave është ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 57.5% të personave janë mbyllur rastet. Përderisa, PTh në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj 22 personave, ka hudhur kallëzimet penale ndaj 6 personave dhe ka pushuar hetimet ndaj 64 personave. Në përqindje kjo prokurori, ka ngritur aktakuza ndaj 23.91% të personave ndërsa kanë mbyllur rastet ndaj 76.09% të personave.

Performancë të ulët të ngritjes së aktakuzave në raport me mbylljen e rasteve ndaj personave të përfshirë në raste të korrupsionit kanë edhe PTh në Gjilan. Kjo prokurori ka ngritur aktakuza ndaj 36 personave, përderisa ka pushuar hetimet apo ka hudhur kallëzimet penale ndaj 45 personave. Në përqindje, ndaj 45% të personave është ngritur aktakuzë, kurse ndaj 55% të personave janë mbyllur rastet. Performancë të njëjtë ka edhe PTh në Prizren. Kjo prokurori ka ngritur aktakuzë ndaj 71 personave, ndërsa ka pushuar hetimet ndaj 58 personave dhe ka hudhur kallëzimet penale ndaj 38 personave. Në përqindje, kjo prokurori ka ngritur aktakuza ndaj 44.66% të personave dhe ka mbyllur rastet ndaj 53.44% të personave.

ZGJIDHJA DHE MËNYRA SË ZGJIDHJES SE RASTEVE TË REGJISTRUARA NË PLANIN E VEPRIMIT MË 04.11.2013													
Zgjidhja e rasteve të vjetra prej 04.11.2013 deri më 30.09.2015	Totali i personave të pazgjidhura më 4 nëntor 2013	Totali i personave të zgjidhur prej 04.11.2013 - 30.09.2015	Përmbushja e Planit të Veprimit	Hudhje		Pushim		Urdhër Ndëshkimor		Aktakuza të drejtpërdrejta		Aktakuza pas hetimeve	
				Persona	Perqindja	Persona	Perqindja	Persona	Perqindja	Persona	Perqindja	Persona	Perqindja
PSRK	232	138	59.0%	10	7.25%	87	63.04%					41	29.71%
Prishtinë	777	240	30.0%	76	31.67%	62	25.83%			9	3.75%	93	38.75%
Prizren	175	159	90.0%	38	23.90%	50	31.45%			3	1.89%	68	42.77%
Pejë	86	92	100.0%	6	6.52%	64	69.57%					22	23.91%
Gjilan	81	81	100.0%	18	22.22%	27	33.33%			20	24.69%	16	19.75%
Mitrovicë	141	116	82.0%	46	39.66%	7	6.03%			10	8.62%	53	45.69%
Ferizaj	126	120	95.0%	13	10.83%	15	12.50%	35	29.2%	2	1.67%	55	45.83%
Gjakovë	64	55	85.0%	7	12.73%	5	9.09%					43	78.18%
<b>Total</b>	<b>1,632</b>	<b>1,001</b>	<b>61.0%</b>	<b>214</b>	<b>21.38%</b>	<b>317</b>	<b>31.67%</b>	<b>35</b>	<b>3.5%</b>	<b>44</b>	<b>4.40%</b>	<b>391</b>	<b>39.06%</b>

Tabela 4 - Zgjidhja dhe mënyra së zgjidhjes se rasteve të regjistruara në planin e veprimit më 04.11.2013


PTh në Ferizaj ka ngritur aktakuza ndaj 92 personave, ndërsa ka pushuar hetimet ndaj 15 personave, kurse ka hudhur kallëzimet penale ndaj 13 personave. Në përqindje kjo prokurori ka ngritur aktakuza ndaj 77% të personave, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 23% të personave.

PTh në Mitrovicë ka ngritur aktakuza ndaj 63 personave, ndërsa ka pushuar hetimet ndaj 7 personave, kurse ka hudhur kallëzimet penale ndaj 46 personave. Në përqindje kjo prokurori ka ngritur aktakuza ndaj 55.31% të personave, ndërsa ka mbyllur rastet ndaj 44.69% të personave.

PTh në Gjakovë konsiderohet prokuroria me përqindjen dhe numrin më të lartë të ngritjes së aktakuzave ndaj personave të përfshirë në vepra penale të korrupsionit në raport me numrin e hudhjeve të kallëzimeve penale apo pushimit të hetimeve. Kjo prokurori ka ngritur aktakuza ndaj 43 personave, ka pushuar hetimet ndaj 5 personave dhe ka hudhur kallëzimet penale ndaj vetëm 7 personave. Në përqindje, PTh në Gjakovë ka ngritur aktakuza ndaj 78.18% të personave dhe janë mbyllur rastet ndaj 21.82% të personave.

**a) Krahasimi i rasteve të zgjidhura të korrupsionit mes vitit 2014 dhe nëntë mujorit të vitit 2015**

PSh gjatë vitit 2014 ka pasur në punë 976 raste me 2569 persona të përfshirë në rastet e korrupsionit. Nga ky numër, PSh gjatë këtij viti ka zgjidhur 444 raste 1011 persona. Sipas mënyrës së zgjidhjes së kallëzimeve penale për këta 1011 persona, prokurorët në vitin 2014 kanë marrë këto veprime: për 248 persona (ose 24.53%) është hudhur kallëzimin penal, për 297 persona (ose 29.38%), janë pushuar hetimet dhe për 471 persona (53.92%) janë ngritur aktakuza.<sup>72</sup>



**Grafika 2 - Krahasimi i rasteve të zgjidhura të korrupsionit: Viti 2014 dhe nëntëmujori 2015**

Përderisa gjatë vitit 2015, PSh ka pasur në punë 844 raste me 2241 persona të përfshirë në rastet e korrupsionit. Nga ky numër PSh ka zgjedhur 215 raste me 490 persona (Grafika 2). Nga 490 personat ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, PSh ka ndërmarr këto veprime: për 101 persona (ose 20.61%) kanë hudhur kallëzimi penal; për 81 persona (ose 16.53%) kanë pushuar hetimet dhe për 304 persona (ose 62%) kanë ngritur aktakuzë.

<sup>72</sup> Raporti i Mekanizmit Përcjellës për harmonizimin e raporteve statistikore për vitin 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_2014\\_MEKANIZMI\\_PERCJELLES.PDF](http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_MEKANIZMI_PERCJELLES.PDF)

PSh gjatë vitit 2015, në bazë të dhënave të lartë përmendura nga Mekanizmi Përcjellës për harmonizimin e raporteve statistikore shihet se ka një efikasitet shumë të ultë në krahasim me vitin 2014. Përderisa PSh gjatë tërë vitit 2014, kishte zgjidhur 444 raste, në nëntëmujorin e parë të vitit 2015, ka zgjidhur vetëm 215 raste apo në përqindje vetëm 48.42% të normës së vitit 2014. Ndërsa sa i përket zgjidhjes së rasteve me persona, PSh gjatë vitit 2014, kishte zgjidhur rastet ndaj 1011 personave, ndërsa në nëntëmujorin e vitit 2015, vetëm 490 persona, apo në përqindje 48.46%.

## **V. HETIMET PRELIMINARE NË RASTET E KORRUPSIONIT - PPN**

Trajtimi i rasteve të korrupsionit në PSh, të pasqyruara në tabelën 6, ka vazhduar edhe tek lëndët e korrupsionit të kategorizuara në regjistrin PPN, apo lëndët të cilat gjenden në fazën e grumbullimit të informatave. Përderisa, në fillim të nëntorit 2013 me hyrjen në fuqi të planit të veprimit, në PSh kishte 232 lëndë PPN me 543 persona, në fund të shtatorit 2015, ky numër nga kjo kategori është rritur në 375 lëndë me 803 persona të përfshirë në lëndët e korrupsionit. Që nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, PSh ka pranuar në punë 352 raste të reja të korrupsionit në regjistrin PPN, me 650 persona të përfshirë. Përderisa, gjatë kësaj periudhe raportuese PSh ka zgjidhur 375 raste me 803 persona të përfshirë. Nga të gjitha rastet e trajtuara ndaj 457 personave PSh ka hudhur raportet e paraqitura nga parashtruesit.

Numri më i madh i raporteve të hudhura i përkasin PTh në Prishtinë ndaj 143 persona, pasuar nga PSRK me 84 persona, PTh në Pejë me 76 persona, PTh në Prizren me 72 persona, PTh në Mitrovicë me 29 persona, PTh në Gjiçan me 24 persona, PTh në Ferizaj me 18 persona dhe PTh në Gjakovë me 11 persona.

Numri më i madh rasteve të pazgjidhura tek rastet PPN mbetet në PTh në Prishtinë me 148 raste me 366 persona, pasuar nga PSRK me 45 raste me 144 persona, PTh në Ferizaj me 46 raste me 77 persona, PTh në Pejë me 44 raste me 80 persona, PTh në Mitrovicë me 41 raste me 61 persona, PTh në Prizren me 32 raste me 50 persona, PTh në Gjakovë me 10 raste me 13 persona dhe PTh në Gjiçan me 9 raste me 12 persona.

RASTET PPN TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL (04.11.2013 - 30.09.2015)									
Prokurori i Shtetit - PPN	Prokurori i Shtetit								
	Të pazgjidhura në fillim (04.11.2014)		Të pranuar (04.11.2013 deri më 30.09.2015)		Rastet e zgjidhura me persona	Mënyra e zgjidhjes		Të pazgjidhura në fund (30.09.2015)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Persona	Hudhje	Hetim	Raste	Persona
						Persona	Persona		
<b>PSRK</b>	12	46	49	165	84	84		45	144
<b>Prishtinë</b>	142	356	48	115	143	143		148	366
<b>Prizren</b>	9	18	67	109	72	72		32	50
<b>Pejë</b>	21	43	67	85	76	76		44	80
<b>Gjilan</b>			29	38	24	24		9	12
<b>Mitrovicë</b>	18	32	40	60	29	29		41	61
<b>Ferizaj</b>	22	33	38	62	18	18		46	77
<b>Gjakovë</b>	8	15	14	16	11	11		10	13
<b>Total:</b>	232	543	352	650	457	457		375	803

**Tabela 6 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit për rastet e hetimeve preliminare prej 04.11.2013 deri më 30.09.2015**

**a) Rastet e korrupsionit të iniciuara prej raporteve të mediave, shoqërisë civile**

Organizata të shoqërisë civile dhe gazetarë në media të ndryshme në Kosovë përditë raportojnë për raste të ndryshme të shkeljes së ligjit nga funksionarë të caktuar publik. Në mesin e këtyre raportimeve për shkelje të ligjit, në raste jo të rralla raportohen veprime të cilat hyn në sferën inkriminuese, duke prezantuar elemente veprave penale që hyjnë në kapitullin e korrupsionit. Puna e raportimit të këtyre përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe medieve, me gjasë përfundon me publikimin e raporteve të tyre, për shkak të neglizhencës së organeve ndjekëse, të cilat nuk ndjekin gjurmët për zbulimin e korrupsionit.

Duke vlerësuar këtë kontribut të akterëve të pavarur të shoqërisë civile dhe medieve, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka nxjerr vendim<sup>73</sup>, më 17 qershor 2015, për krijimin e “Komisionit<sup>74</sup> për përcjelljen ditore dhe verifikimin e pretendimeve të rasteve të

<sup>73</sup> Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka nxjerr vendim me numër A. nr.208/2015 më 17 qershor 2015, në pajtim me nenin 11, pika 7 dhe neni 12 pika 3 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Prokurori i Shtetit.

supozuara të krimit të organizuar e të korrupsionit, të publikuara përmes mjeteve elektronike e të shtypit, të parashtresave të qytetarëve dhe paraqitjeve publike të zyrtarëve të organeve e organizatave shtetërore e publike dhe të organizatave joqeveritare”. Pas verifikimit të informacioneve, sipas vendimit, Komisioni ka mandat të verifikojë pretendimet, dhe në rastet kur konsideron se ekziston dyshimi se qëndrojnë elemente inkriminuese për ndjekje penale, menjëherë ndërmerr veprimet në drejtim të adresimit të këtyre rasteve tek prokurorët kompetent, të cilëve edhe mund t’iu sugjerohen veprime procedurale për t’i ndërmarr në këto raste. Në raste se Komisioni, pas verifikimeve të rasteve të paraqitura në media, konsideron se nuk ka dyshim se qëndrojnë elementet inkriminuese për ndjekje penale, atëherë menjëherë me informatë do ta njofton publikuesin apo paraqitësin e rastit e sipas nevojës edhe opinionin publik përmes mjeteve të informimit.

IKD ka tentuar të monitoroj punën e këtij komisioni në aspektin e veprimeve të ndërmarra, duke kërkuar qasje në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.<sup>75</sup> Anëtarët e Komisionit, zëdhënësi i KPK-së nuk kanë kthyer përgjigje zyrtare, duke shkelur afatet ligjore për të kthyer përgjigje. IKD mbetet pranë kërkesës, përderisa nuk ka informacion, nëse ky Komision është takuar ndonjëherë, dhe ka zbatuar vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

IKD ka zhvilluar një hulumtim me një numër të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të gazetarëve të cilët kanë raportuar për shkelje të ndryshme të ligjit si dhe kanë publikuar skandale të përfshirjes së zyrtarëve të lartë në afëra korruptive. Në të gjitha intervistat e zhvilluara nga IKD përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe gazetarët shprehën se PSh ka dështuar në trajtimin e gjetjeve të tyre, të cilat bëhen publike përmes publikimeve dhe raportimeve të përditshme. Suksesi në këto raste për të cilat këta përfaqësues kanë raportuar është minimal.<sup>76</sup> Përderisa skandalet korruptive përditë bëhen publike në media, sipas gazetarëve, nuk ka reagime adekuate të institucionit të PSh. Zbulimi në media i skandaleve të përfshirjes në shkelje të ligjit dhe afëra korruptive, nuk ka prodhuar asgjë më shumë sesa artikuj apo storie gazetareske, pasi të njëjtat nuk janë përcjell me hetime nga organet ndjekëse.<sup>77</sup> Të gjithë gazetarët e intervistuar kanë deklaruar se asnjëherë asnjë zyrtar i PSh-së nuk i ka kontaktuar për t’i njoftuar në lidhje me ndonjë rast, për të cilin

---

<sup>74</sup> Komisionit përbëhet nga Kryetari Lulëzim Sylejmani, prokuror i Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, Kujtim Munishi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan si dhe Ekrem Lutfiu, zëdhënësi i KPK-së.

<sup>75</sup> IKD ka bërë “Kërkesë zyrtare për qasje në dokumentet publike” në KPK, më datën 24 nëntor 2015, duke iu drejtuar kërkesën të gjithë antarëve të komisionit, përgjegjësve për komunikim me publikun si dhe zyrtarit të caktuar në KPK për qasje në dokumentet publike.

<sup>76</sup> IKD intervista me Hulumtuesen e Lartë të Institutit KIPRED, znj. Ariana Qosaj Mustafa; Drejtorin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, z. Fisnik Korenica, Përfaqësuesin Ligjor të Organizatës Çohu, z. Arton Demhasaj. Nëntor 2015.

<sup>77</sup> IKD intervista me z. Besnik Krasniqi “Koha Ditore”, z. Parim Olluri “Gazeta JNK”, znj. Selvije Bajrami “Zëri”, z. Faton Ismajli “Express”, z. Naim Sadiku “KTV”, z. Beadin Sylja “Kosovapress”, znj. Ardita Sylejmani “RTK” dhe z. Shkodran Bajraku “KlanKosova”. Nëntor 2015.

Komisioni ka konstatuar se nuk ka gjetur elemente të veprave penale për korrupsion apo krim të organizuar. Puna e këtij Komisioni, vlerësohet e dështuar përderisa nuk bëhet transparente dhe llogaridhënëse para publikut, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

IKD vlerëson se kontributi i akterëve të jashtëm të pavarur të shoqërisë civile dhe gazetarëve është shumë e çmuar dhe do duhej të shërbente për organet ndjekëse që të shqyrtojnë me seriozitet secilin raportim, në mënyrë që të prodhohen rezultatet e nevojshme për të gjithë shkelësit e ligjit dhe personat e përfshirë në vepra penale të korrupsionit. Nëse ky Komision nuk e bën publike punën e tij, në përputhje me ligjin, Kryeprokurori duhet të mbajë përgjegjës anëtarët e Komisionit, në të kundërtën KPK duhet të mbajë përgjegjës Kryeprokurorin për moszbatimin e vendimeve.

## **VI. RASTET E PAZGJIDHURA TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL MË 30 SHTATOR 2015**

Derisa në fund të periudhës paraprake raportuese (30 qershor 2015) Plani i Veprimit ishte përmbushur 57%, tani në fund të kësaj periudhe raportuese (30 shtator 2015), plani i veprimit sa i përket rasteve të vjetra të zgjidhura është përmbushur 61%. IKD vlerëson trajtimin e rasteve nga PSh që kanë datuar nga vitet 2001-2003, të trajtuara në raportin e gjashtë (6) që ka përfshirë periudhën kohore deri më 30 qershor 2015. Sidoqoftë, shqetësuese mbetet fakti se PSh ende ka në punë raste që datojnë nga vitet 2004 e tutje. Në këto raste, siç është shtjelluar më lartë në këtë raport, në këto raste përveç humbjes së besimit të parashtruesve të kallëzimeve penale për korrupsion dhe mundësisë së shkeljes së drejtave të qytetarëve të përfshirë në këto akte, ekziston mundësia që të gjithë këta persona të jenë pjesë e institucioneve, përderisa të njëjtit poqëse do të trajtoheshin nga prokurorët, do të mund të gjendeshin fajtorë për vepra penale të korrupsionit.<sup>78</sup>

Për të pasur një pasqyrë të qartë për rastet e vjetra të korrupsionit, IKD ka paraqitur në tabelën më poshtë, rastet dhe personat për secilën prokurori, për secilin vit. Sikurse në raportet paraprake, IKD ka ofruar këtë pasqyrë për akterët e sistemit prokurorial, në radhë të parë për të evidentuar dhe përkujtuar këto institucione që këto raste të i trajtojnë me prioritet në pajtim me obligimet që dalin nga plani i veprimit, dhe në të njëjtën kohë për të kuptuar problematikën dhe rrezikun e parashkrimit nga ndjekja penale e

<sup>78</sup> "Mos me dalë ne mandej me u bo gaz i botës, e kemi lëndën e vitit 2001 s'është kry deri në 2015. Edhe çfarë efekti ka ndëse sot e ndjekim dikë për korrupsion që e ka kry një vepër penale në 2008, 2009, 2010 ai është hala duke ushtrru funksion publik në ndërmarrje publike ose në administratë të Qeverisë a Kuvendit apo ku po e di unë", citat i Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh Kryetari i KPK-së, z.Aleksandër Lumezi. Mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. 8 tetor 2015.

këtyre rasteve të pazgjidhura ndër vite. IKD vazhdon të insistoj se rastet e patrajuara dhe pa zgjidhura nga vitet paraprake që datojnë nga viti 2004, ndikojnë drejtpërdrejtë në efikasitetin e punës së prokurorive dhe imazhin e sistemit prokurorial në raport me besimin e publikut në këtë sistem. Po ashtu, IKD vlerëson se prokurorët do ta kenë vështirë mbrojtjen e këtyre rasteve në gjykatë për veprat penale të cilat pretendohet se janë kryer në vitet e largëta sikurse viti 2004. Kjo për faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale, dhe në rast se të njëjtat lëndë nuk kanë arritur tanimë afatin e parashkrimit të ndjekjes penale, do të jetë shumë e vështirë sigurimi i dëshmitarëve, besueshmëria e deklaratave të tyre lidhur me këto raste dhe vërtetimi i gjendjes faktike.

Krahasuar me numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese paraprake (prill, maj dhe qershor) në këtë periudhë raportuese (korrik, gusht dhe shtator 2015), numri i rasteve është rritur nga 589 raste me 1,706 persona, në 636 raste me 1753 persona. IKD shpreh shqetësimin e saj, se vazhdon trendi negativ i zgjidhjes së rasteve, respektivisht, për çdo tremujor kemi ngritje të numrit të rasteve të korrupsionit në raport me periudhën paraprake. Gjatë këtij tremujori, numri i rasteve është rritur nga 589 në 636, përderisa numri i personave të përfshirë në veprat penale të korrupsionit është ngritur nga 1706 persona në 1753 persona. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur të gjitha rastet e korrupsionit, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura më 30 shtator 2015, për secilën prokurori sipas viteve:

Raste të pazgjidhura me persona sipas prokurorive ndërvite (30 shtator 2015)	2004		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK											6	22	5	27	3	25	7	28	18	120	10	31	49	253
Prishtinë	1	1	4	14	5	21	14	39	2	2	12	35	18	95	29	108	56	260	150	302	100	217	391	1,094
Prizren																	2	2	5	16	17	45	24	63
Pejë											1	1					3	11	12	27	24	38	40	77
Gjilan																		2	5	14	20	16	25	
Mitrovicë									1	2			4	4	7	15	8	20	21	44	28	63	69	148
Ferizaj	1	4									2	4					3	3	6	12	12	29	24	52
Gjakovë															1	2	2	5	3	7	17	27	23	41
<b>TOTALI</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	<b>21</b>	<b>14</b>	<b>39</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>21</b>	<b>62</b>	<b>27</b>	<b>126</b>	<b>40</b>	<b>150</b>	<b>81</b>	<b>329</b>	<b>217</b>	<b>533</b>	<b>222</b>	<b>470</b>	<b>636</b>	<b>1,753</b>

Tabela 7 - Gjendja e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit për secilën prokurori më 30.09.2015

PTh në Prishtinë vazhdon të mbetet prokuroria me numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura, e cila më 30 shtator 2015, ka në punë 391 raste të pazgjidhura me 1,094 persona. PTh në Prishtinë dhe PTh në Ferizaj vazhdojnë të jenë prokuroritë e vetme të cilat kanë raste të vjetra të periudhave prej vitit 2004 deri më 2010.

IKD ka bërë kategorizimin e rasteve të pazgjidhura në fund të kësaj periudhe raportuese, sipas prokurorive dhe sipas parashtruesve ndër vite. Në tabelën 8, janë paraqitur rastet e pazgjidhura me persona në fund të kësaj periudhe raportuese (30 shtator 2015).

Raste të pazgjidhura me persona sipas parashtruesve ndërvite (30 shtator 2015)	2004	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Total
AKK			10	16		12	19	88	84	112	50	391
ATK						2						2
Doganat	4								9	1	6	20
EULEX						7	11	1	6			25
IPK								7	5	19	30	61
PK		7	10	14	3	21	23	35	177	201	177	668
Qytetari						9	25	5	17	53	49	158
I dëmtuari			1	1	1	7	5	1	28	73	108	225
Adm. Komunale							1			2		3
Pranuar në kompet.										45	50	95
Titullari i pronës-OP	1	7		8		4		13		13		46
Autoriteti Pyjor									2			2
Prokurori vetiniciativë							41		1	14		56
Paidentifikuar							1					1
<b>Total:</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>21</b>	<b>39</b>	<b>4</b>	<b>62</b>	<b>126</b>	<b>150</b>	<b>329</b>	<b>533</b>	<b>470</b>	<b>1,753</b>


Tabela 8 - Gjendja e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit për sipas parashtruesve më 30.09.2015

Policia e Kosovës vazhdon të jetë parashtruesi më i madh i rasteve të korrupsionit, e cila nga gjithsej 1,753 personat e përfshirë në rastet e tilla, ka parashtruar kallëzime penale për 668 persona. AKK vazhdon të jetë parashtruesi i dytë më i madh me gjithsej 391 persona, duke u pasuar nga të dëmtuarit me 225 persona, qytetarët me 158 persona, IPK me 61 persona, etj.

## VII. DËSHTIMET E PROKURORËVE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË KORRUPSIONIT

### I - RASTET E PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE

IKD në kuadër të monitorimit të performancës në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kërkuar prej të gjitha prokurorive aktet prokuroriale që përfshijnë vendimet e prokurorëve për hudhjen e kallëzimeve penale dhe vendimet për pushimin e hetimeve. Qëllim i sigurimit të këtyre akteve është analizimi i respektimit të afateve ligjore për të vendosur lëndët e korrupsionit. Përgjatë analizimit të këtyre akteve, prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, IKD ka identifikuar 66 raste të parashkrimit të lëndëve të korrupsionit nëpër prokurori. Fenomeni i parashkrimit mbetet jashtëzakonisht shqetësues dhe i paadresuar nga prokuroritë. Në grafikonin më poshtë janë paraqitur rastet e korrupsionit të parashkruara në të gjitha prokuroritë, përfshi edhe PSRK-në, si prokuroria më e re në sistemin prokurorial.



Grafika 3 - Rastet e korrupsionit të parashkruara nëpër prokurori të identifikuar nga IKD që përfshijnë rastet prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit deri më 10 shtator 2015

IKD në vazhdim paraqet të gjitha rastet për të cilat ka siguruar aktet juridike nga të gjitha prokuroritë në përputhje me legjislacionin pozitiv.<sup>79</sup>

## PROKURORIA SPECIALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Lënda PPS me numër 55/2013 vendosur më 14.07.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* për veprat penale: “Krim i organizuar” nga neni 283 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, “Lidhja e kontratës së dëmshme” nga neni 291 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, “Mashtrimi në detyrë” nga neni 341 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 (KPK 2004), “Punimet ndërtimore të kundërligjshme” nga neni 368 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së.<sup>80</sup>

## PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

1. Lënda PP. me numër 973-4/208 vendosur më 14.08.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* për shkak të *parashkrimit relativ të ndjekjes penale*. Vepra penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit”.<sup>81</sup>
2. Lënda PP.II me numër 1069/2014 vendosur më 15.01.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* për shkak se është bërë *parashkrimi i veprës*. Vepra penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>82</sup>
3. Lënda PPI. Me numër 576/2014 vendosur më 29.09.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* kundër personit NN, për shkak të *parashkrimit absolut të ndjekjes penale*. Vepra penale: “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafi 1 të KPK-së.<sup>83</sup>

<sup>79</sup> Sigurimi i akteve juridike prokuroriale nga IKD është bërë përmes kërkesave të veçanta për secilën prokurori në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Aktet janë siguruar në periudha të ndryshme kohore prej muajit prill deri në nëntor 2015.

<sup>80</sup> *Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 14.07.2015, PSRK ka pushuar hetimet, për veprat penale të cekura, për arsye se është bërë parashkrimi i ndjekjes penale.

<sup>81</sup> *Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 14.08.2015 duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i KPPRK-së, PTh në Prishtinë ka pushuar hetimet, për veprën penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit” nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së për arsye se është bërë parashkrimi relativ i ndjekjes penale.

<sup>82</sup> *Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 15.01.2015, duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 KPPRK-së, PTh në Prishtinë pushuar hetimet, për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së për arsye se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer veprën e tillë penale dhe se vepra në fjalë është parashkruar.

<sup>83</sup> *Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 29.09.2015, duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 KPPRK-së, PTh në Prishtinë ka pushuar hetimet për veprën penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafi 1 të KPK-së, me arsyetimin se ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

4. Lënda PP me numër 424/2001 vendosur më 10.09.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* për shkak se është bërë *parashkrimi i veprës penale*. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422.<sup>84</sup>
5. Lënda PP me numër 740-4/2008 vendosur më 09.09.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar prej Njësisë së Krimeve Ekonomike, për shkak të *parashkrimit relativ të ndjekjes penale*. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 KPRK-së.<sup>85</sup>
6. Lënda PP. II me numër 529-4/2011 vendosur më 14.09.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë, për shkak se është bërë *parashkrimi i ndjekjes penale*. Vepra penale “Ushtrimi i ndikimit” neni 345 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së.<sup>86</sup>

### PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN

1. Lënda PP. me numër 102/2015 vendosur më 01.06.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal*, për shkak se është bërë *parashkrimi i ndjekjes penale*. Veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit” dhe “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”.<sup>87</sup>

### PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË

1. Lënda PPN.I me numër 14/2015 vendosur më 02.03.2015. *Aktvendim për hudhjen e kërkesës për zhvillimin e hetimeve* për shkak të *parashkrimit absolut të ndjekjes penale*. Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit”.<sup>88</sup>

<sup>84</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 10.09.2015, PTh e Prishtinës duke u bazuar në nenin 82 kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së me arsyetimin se është bërë *parashkrimi absolut i veprës penale*.

<sup>85</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 09.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së me arsyetimin se ishte bërë *parashkrimi i ndjekjes penale*.

<sup>86</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 14.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 pika 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit” neni 345 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së, me arsyetimin se ishte bërë *parashkrimi i ndjekjes penale*.

<sup>87</sup>*Shënim:* Sipas aktvendimit të datës 01.06.2015, PTh në Prizren, duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. dhe neni 83 paragrafi 2 dhe 5 të KPPRK-së ka hudhur poshtë kallëzimin penal të parashtruar prej disa qytetarëve nga një fshat N.N., për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit” nga neni 422 paragrafi 1 dhe “Falsifikimi i dokumentit zyrtar” nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-së për arsye se ishte bërë *parashkrimi i ndjekjes penale*.

2. Lënda PP. I me numër 212/2015 vendosur më 29.06.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar, për shkak të *parashkrimit absolut të ndjekjes penale*. Vepra penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit”.<sup>89</sup>

## PROKURORIA THEMELORE NË GJAKOVË

1. Lënda PPN/I me numër 38/2013 vendosur më 30.06.2015. *Shënim zyrtar-Nuk ndërmerret ndjekja penale* për shkak të *parashkrimit absolut të ndjekjes penale*. Vepra penale nuk është precizuar.<sup>90</sup>
2. Lënda PP/I me numër 222/14 vendosur më 15.01.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale*. Veprat penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 339 paragrafin 1 lidhur me paragrafin 1; “Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë” nga neni 334 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, “Kontraktimi i përfitimit joproporcional” nga neni 270, “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” nga neni 346 dhe “Krimi i Organizuar” nga neni 274.<sup>91</sup>

## II – RASTET E SHKELJES SË AFATEVE LIGJORE PËR VENDOSJE

Në vijim janë paraqitur rastet e hudhjes poshtë të kallëzimeve penale në kundërshtim me dispozitat e Kodit të ri të Procedurës Penale. Për dallim prej procedurës së vjetër penale, e cila ka qenë në fuqi deri më 1 janar 2013, në procedurale e re penale janë përcaktuar afate strikte kohore për trajtimin e kallëzimeve penale. IKD ka analizuar të gjitha aktet juridike prokuroriale të siguruara nga të gjitha prokuroritë (për periudhën 1 prill – 30 shtator 2015) dhe ka identifikuar shkeljet e prokurorëve sa i përket respektimit të afateve ligjore për trajtimin e kallëzimeve penale. Shkelja e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, rezulton me shkelje të të drejtave të njeriut, duke i mbajtur qytetarët si subjekte në evidencat penale të prokurorisë në rastet kur ndaj tyre nuk ka asnjë bazë që zhvillohen hetime penale. IKD gjatë analizimit të akteve juridike prokuroriale, prej gjithsej 44 rasteve të analizuara, ka identifikuar 8 prej tyre të cilat janë parashtruar para 2013, ndërsa 36 prej tyre janë parashtruar pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri penal.

<sup>88</sup>*Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 02.03.2015, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kërkesën për zhvillimin e hetimeve, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit” për arsye se është bërë parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

<sup>89</sup>*Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 29.06.2015, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 pika 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit” me arsyetimin se është bërë parashkrimi i veprës penale.

<sup>90</sup>*Shënim*: Sipas shënit zyrtar të datës 30.06.2015, PTh në Gjakovë kishte pushuar hetimet për arsye se ishte bërë parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

<sup>91</sup>*Shënim*: Sipas aktvendimit të datës 15.01.2015, PTh në Gjakovë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe 1.5 të KPPRK-së ka hudhur poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 339 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 1; “Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë” nga neni 334 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1, “Kontraktimi i përfitimit jo-proporcional” nga neni 270, “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” nga neni 346 dhe “Krimi i Organizuar” nga neni 274 për arsye se ishte bërë parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Shqetësim mbesim rastet e patrajtuarara të kallëzimeve penale, sikurse është identifikuar rasti ku kallëzimi penal i parashtruar në vitin 2001 kishte pritur 14 vite për t'u trajtuar dhe hudhur poshtë. Në vazhdim janë paraqitur rastet e evidentuara të shkeljes së afateve ligjore nga prokurorët në rastet e korrupsionit në të gjitha prokuroritë.

## PROKURORIA SPECIALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Lënda PPS me numër 69/2015 vendosur më 17.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal.** Vepra penale “Krim i organizuar” nga neni 283 dhe “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit” nga neni 422 të KPRK-së.<sup>92</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës më 27.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 17.09.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PSRK kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 325 ditëve nga data e pranimi të kallëzimit penal.*

2. Lënda PPS. me numër 27/2015 vendosur më 23.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej policisë. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Lidhja e kontratave të dëmshme”.<sup>93</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 03.04.2015, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë në 23.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PSRK kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 81 ditëve nga data e pranimi të kallëzimit penal.*

## PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

1. Lënda PP.II me numër 1069/2014 vendosur më 15.01.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** kundër personit NN **për shkak se është bërë parashkrimi i veprës.** Vepra penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>94</sup>

<sup>92</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 17.09.2015, PSRK duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i KPPRK-së, kishte hudhur poshtë kallëzimin penal për veprat penale, me arsyetimin se nuk është mundur të vërtetohet dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>93</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 23.06.2015 PSRK duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Lidhja e kontratave të dëmshme” me arsyetimin se ka mungesë të provave se personi i tillë ka kryer veprën penale.

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 04.02.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve më 16.12.2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pas 315 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

2. Lënda PPI. me numër 576/2014 vendosur më 29.09.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** kundër personit NN. Vepra penale: “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafi 1 të KPK-së.<sup>95</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 18.06.2009, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t’i fillojë hetimet më 10.09.2014. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 1909 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 618 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

3. Lënda PP. II me numër 6876/13a vendosur më 21.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej AKK. Vepra penale “Mosdeklarimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve tjera financiare ” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>96</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 09.09.2013, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 21.09.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pas 742 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

4. Lënda PPN/I me numër 44/2014 vendosur më 10.09.2015. **Shënim zyrtar për hudhjen poshtë të kallëzimit penal.**

<sup>94</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 15.01.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka pushuar hetimet, për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së për arsye se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer veprën e tillë penale dhe se vepra ne fjalë është parashtruar.

<sup>95</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 29.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. të KPPRK-së ka pushuar hetimet për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit” për arsye se ka kaluar afati i parashkrimit.

<sup>96</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 21.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Mosdeklarimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve tjera financiare ” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 25.02.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 10.09.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 562 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

5. Lënda PP/I me numër 1066/2014 vendosur më 14.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar nga përfaqësuesi N.N. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së.<sup>97</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 13.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 14.09.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 336 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

6. Lënda PP me numër 651/14 vendosur më 28.07.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej një qytetari N.N. nga Prishtina. Veprat penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafin 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.<sup>98</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 13.06.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 28.07.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 410 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

7. Lënda PP me numër 925-1/2011 vendosur më 20.04.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej një qytetari N.N. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 dhe “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 390 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së.<sup>99</sup>

<sup>97</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 14.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se në veprimet e personit nuk janë manifestuar elemente të veprës penale me të cilën ngarkohet.

<sup>98</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 28.07.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 të KPPRK-së kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafi 3 lidhur me par 1 të KPK-së me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi e ka kryer veprën penale.

<sup>99</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 20.04.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 të KPPRK-së kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 dhe “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 390 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së me arsyetimin se në veprimet e personit nuk janë manifestuar elementet të veprës penale me të cilën ngarkohet.

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 09.12.2011, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 20.04.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 1227 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 840 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

8. Lënda PP. II me numër 529-4/2011 vendosur më 14.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prishtinë. Vepra penale “Ushtrimi i ndikimit” neni 345 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së.<sup>100</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 26.05.2011, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 14.09.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 1571 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 987 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

9. Lënda PP me numër 740-4/2008 vendosur më 09.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej Njësisë së Krimeve Ekonomike. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 KPRK-së.<sup>101</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 17.12.2006, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 09.09.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 3186 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 982 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

10. Lënda PPI me numër 1354/2014 vendosur më 25.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej një qytetari NN. Vepra penale “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 431 të KPK-së.<sup>102</sup>

<sup>100</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 14.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 pika 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit” neni 345 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së, me arsyetimin se ishte bërë parashkrimi i ndjekjes penale.

<sup>101</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 09.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së me arsyetimin se ishte bërë parashkrimi i ndjekjes penale.

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 29.12. 2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë në 25.06. 2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 178 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

11. Lënda PP me numër 424/2001 vendosur më 10.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar nga NN. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422.<sup>103</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 10.10.2001, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 10.09.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 5080 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 983 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

12. Lënda PP/II me numër 4014/2014 vendosur më 11.03.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 i paragrafit 1 të KPRK-së.<sup>104</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 29.05.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur të iniciojë hetimet më 17.09. 2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 111 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

13. Lënda PP.II me numër 969/2014 vendosur më 19.01.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 2 i KPRK-së.<sup>105</sup>

<sup>102</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 25.06.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën “Ushtrimi i ndikimit” nga neni 431 të KPRK-së me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi e ka kryer veprën penale.

<sup>103</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 10.09.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 82 të KPRK-së kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së me arsyetimin se është bërë parashkrimi absolut i veprës penale.

<sup>104</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 11.03.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 të KPRK-së, kishte pushuar hetimet për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 par. 1 të KPRK-së me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën penale.

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 29.01.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur të iniciojë hetimet më 17.09.2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 231 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

14. Lënda PP me numër 5203/2014 vendosur më 23.02.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 i KPRK-së.<sup>106</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prishtinë më 10.07.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t’i fillojë hetimet më 24.10.2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prishtinë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 106 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

## PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN

1. Lënda PP me numër 1319/10- II vendosur më 12.01.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal (raportit informues)** të parashtruar prej Njësitit të Hetimeve për Krime Ekonomike dhe Korrupsion. Vepra penale “Marrja e ryshfetit”.<sup>107</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prizren më 25.05.2010, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 12.01.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 1692 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prizren ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 742 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

<sup>105</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 19.01.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 të KPRK-së, kishte vendosur t’i pushojë hetimet për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se personi e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

<sup>106</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 23.02.2015, PTh në Prishtinë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të KPRK-së, kishte vendosur t’i pushojë hetimet për veprën penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave ose i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare” nga neni 437 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase në veprimet e personit nuk janë manifestuar elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet.

<sup>107</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 12.01.2015, PTh në Prizren duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 83 paragrafi 2 dhe 5 i KPRK-së, kishte hudhur poshtë kallëzimi penal (raportit informues) për veprën penale me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshim i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

2. Lënda PP me numër 151/2015 vendosur më 18.09.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit”.<sup>108</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prizren më 27.04.2015, ndërsa Prokuroria kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve më 18.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prizren kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 52 ditëve nga data e pranimi të kallëzimit penal.*

3. Lënda PPN me numër 417/2014 vendosur më 16.06.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar nga disa qytetarë N.N. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit”.<sup>109</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prizren më 29.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte parashtruar kërkesë për mbledhjen e të dhënave plotësuese më 30.03.2015, kurse kishte hudhur kallëzimin penal më 16.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prizren kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 230 ditëve nga data e pranimi të kallëzimit penal.*

4. Lënda PPN me numër 418/2014 vendosur më 16.06.2015. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar nga ana e disa qytetarëve N.N. Vepra penale nuk është precizuar.<sup>110</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Prizren më 24.11.2014, ndërsa Prokuroria kurse kishte hudhur kallëzimin penal më 16.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Prizren kishte nxjerrë vendim me vonesë prej pothuajse pas 204 ditëve nga data e pranimi të kallëzimit penal.*

<sup>108</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 18.09.2015, PTh në Prizren duke u bazuar në nenin 158 të KPPRK-së, kishte pushuar hetimet me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>109</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 16.06.2015, PTh në Prizren duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1. Pika 1.1.i KPPRK-së, kishte hudhur poshtë kallëzimi penal për veprën penale me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>110</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 16.06.2015, PTh e Prizrenit kishte vendosur duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1. Pika 1.1. i KPPRK-së, me anë të cilit ishte hudhur poshtë kallëzimi penal për veprën penale me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

## PROKURORIA THEMELORE NË PEJË

1. Lënda PP. I me numër 350/14 vendosur më 08.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penalë** parashtruar prej një NN qytetari. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>111</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendimin e tillë vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTH në Pejë më 27.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 08.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për rastet e tilla ishte paraparë që të vendosej brenda 30 dite nga pranimi i kallëzimit penal, PTH në Pejë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 224 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

2. Lënda PP. I me numër 422/14 vendosur më 13.05.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej NN avokat. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>112</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTH në Pejë më 19.12.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh ata në 13.05.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTH në Pejë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 145 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

3. Lënda PPN. I me numër 134/15 vendosur më 08.09.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal për veprën penale** “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>113</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimet penale ishte pranuar në PTH në Pejë më 29.12.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh ata në 08.09.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTH në Pejë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 253 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

---

<sup>111</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 08.06.2015, PTH në Pejë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>112</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 13.05.2015, PTH në Pejë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>113</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 08.09.2015, PTH në Pejë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimin penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

4. Lënda PP- I me numër 167/14 vendosur më 22.01.2015. *Aktvendim për pushim të pjesërishëm të hetimeve* për veprat penale “Shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ” dhe “Keqpërdorimi i besimit”.<sup>114</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Pejë më 16 Prill 2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t'i iniciojë hetimet në 29.10.2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Pejë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 196 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

5. Lënda PP./I me numër 232/14 vendosur më 06.05.2015. *Aktvendim për pushimin e hetimeve* për veprën penale “Keqpërdorim i detyrës apo autoriteti zyrtar”.<sup>115</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Pejë më 22.07.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t'i iniciojë hetimet në 09.02.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Pejë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 202 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

#### **PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË**

1. Lënda PP- II me numër 339/2013 vendosur më 10.04.2014. *Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal* të parashtruar prej Hetimeve Rajonale në Mitrovicë. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>116</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Mitrovicë më 02.08.2013, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 10.04.2014. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Mitrovicë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 251 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

<sup>114</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 22.01.2015, PTh në Pejë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur t'i pushojë pjesërisht hetimet me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>115</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 06.05.2015, PTh në Pejë duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPPRK-së, kishte vendosur t'i pushojë hetimet veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personat e tillë kanë kryer veprën penale.

<sup>116</sup>*Shënim:*Sipas aktvendimit të datës 10.04.2014, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 pika 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale.

2. Lënda PP. I me numër 212/2015 vendosur më 29.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar nga Njësia e Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Mitrovicë. Vepra penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit”.<sup>117</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penale ishte pranuar në PTh në Mitrovicë më 14.05.2015, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 29.06. 2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Mitrovicë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 46 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

### PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN

1. Lënda PP.I me numër 16/2015 vendosur më 24.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej N.N. Veprat penale “Përvetësimi në detyrë” nga neni 425 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 dhe “Manipulimi me prova” nga neni 397 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>118</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 12.01.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 24.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 153 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

2. Lënda PP/I me numër 150/2015 vendosur më 07.10.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Gjilan. Vepra penale “Keqërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>119</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 10.08.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.10.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të

<sup>117</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 29.06.2015, PTh në Mitrovicë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 pika 1.2 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit” me arsyetimin se ishte bërë parashkrimi i veprës penale.

<sup>118</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 24.06.2015, PTh në Gjilan në bazë të neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se nuk janë siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë.

<sup>119</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 07.10.2015, PTh në Gjilan në bazë të neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se nuk janë siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë.

*vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 58 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

3. Lënda PP. I me numër 84/2015 vendosur më 29.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej qytetarit NN. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 2 të KPRK-së.<sup>120</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 04.05.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 29.06. 2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 56 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

4. Lënda PP/I me numër 59/2015 vendosur më 15.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej të dëmtuarve. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1 dhe “Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër” nga neni 344 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>121</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 27.03.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 15.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 80 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

5. Lënda PP. I me numër 84/2015 vendosur më 29.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej qytetarit NN. Vepra penale: “Mashtrimi” nga neni 335 paragrafi 3, “Prezantimi i rremë si person zyrtar” nga neni 417 paragrafi 2 dhe “Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme” nga neni 435 paragrafi 1 i KPRK-së.<sup>122</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 04.05.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 23.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të*

<sup>120</sup>*Shënim: Sipas aktvendimit të datës 29.06.2015, PTh në Gjilan në bazë të nenit 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se nuk janë siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë.*

<sup>121</sup>*Shënim: Sipas aktvendimit të datës 15.06.2015, PTh në Gjilan në bazë të nenit 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se nuk janë siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë.*

<sup>122</sup>*Shënim: Sipas aktvendimit të datës 29.06.2015, PTh në Gjilan duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se nuk janë siguruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë.*

*vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 50 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

6. Lënda PPH-I- me numër 41/2015 vendosur më 22.05.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>123</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjilan më 02.03.2015, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t’i fillojë hetimet më 30.04.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjilan kishte nxjerrë vendim pas 59 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

### **PROKURORIA THEMELORE NË GJAKOVË**

1. Lënda PP/I me numër 14/2015 vendosur më 30.03.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej një qytetari N.N. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>124</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjakovë më 06.02.2015, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 30.03.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjakovë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 52 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

2. Lënda PP/I me numër 29/2015 vendosur më 19.05.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimeve penale** të parashtruar prej të dëmtuarve. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>125</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimet penale ishin pranuar në PTh në Gjakovë më 27 dhe 28.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t’i hudh ata më 19.05.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjakovë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 204 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

<sup>123</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 22.05.2015, PTh Gjilan duke u bazuar në nenin 158 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të pushojë hetimet për veprën penale me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>124</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 30.03.2015, PTh e Gjakovë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>125</sup>Shënim:Sipas aktvendimit të datës 19.05.2015, PTh në Gjakovë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

3. Lënda PP/I me numër 240/2014 vendosur më 02.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej disa qytetarëve. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>126</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Gjakovë më 14.10.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 02.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjakovë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 231 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

4. Lënda PP/I me numër 75/2015 vendosur më 01.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej një qytetari NN. Vepra penale “Shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.<sup>127</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTH në Gjakovë më 16.05.2014, ndërsa Prokuroria kishte vendosur ta hudh atë më 01.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Gjakovë kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 380 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

## PROKURORIA THEMELORE NË FERIZAJ

1. Lënda PP.I. 84.A me numër 885-2/15 vendosur më 28.08.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej qytetarit NN. Veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1, “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 398 paragrafi 2, “Legalizimi i përmbajtjes së rremë” nga neni 403 dhe “Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësia” nga neni 222 i KPRK-së.<sup>128</sup>

**IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 27.01.2015, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 28.08.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të

<sup>126</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 02.06.2015, PTh në Gjakovë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>127</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 01.06.2015, PTh në Gjakovë duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPPRK-së, kishte vendosur të hudh poshtë kallëzimi penal për veprën penale “Shpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” me arsyetimin se nuk ekziston asnjë dyshimi i arsyeshëm se personi i tillë ka kryer veprën penale.

<sup>128</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 28.08.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprat penale të lartcekura, për arsye se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen.

*vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Ferizaj kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 213 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

2. Lënda PP.I. me numër 64/15 vendosur më 17.06.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej Njësisë së hetimeve të Krimeve Ekonomike në Ferizaj. Vepra penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar” nga neni 434 paragrafi 1 të KPRK-së.<sup>129</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 13.05.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 17.06.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Ferizaj kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 400 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

3. Lënda PP.I. me numër 198/14 vendosur më 07.04.2015. **Aktvendim për hudhjen poshtë të kallëzimit penal** të parashtruar prej Njësisë së hetimeve për Krime Ekonomikë në Ferizaj. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 paragrafi 1 i KPRK-së.<sup>130</sup>

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 29.09.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.04. 2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Ferizaj kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 190 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.*

4. Lënda PPN/I me numër 379-1/07 vendosur më 28.08.2015. **Shënim zyrtar për mbylljen e raportit informues** të parashtruar prej DHKEK në Ferizaj. Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 par 3 lidhur me paragrafi 1 të KPK-së.<sup>131</sup>

<sup>129</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 17.06.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të KPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprën penale të lartcekur, për arsye se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen.

<sup>130</sup>Shënim: Sipas aktvendimit të datës 07.04.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprën penale të lartcekur, për arsye se nuk ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën penale në fjalë.

<sup>131</sup>Shënim: Sipas shënimit zyrtar të datës 28.08.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 të KPRK-së ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprën penale të lartcekur, për arsye se nuk ekziston baza për iniciimin e procedurës penale.

**IKD:** Bazuar në shënimin zyrtar vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 08.04.2010, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 28.08.2015. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 1967 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 872 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.

5. Lënda PPN/I me numër 49/2013 vendosur më 28.08.2015. **Shënim zyrtar për mbylljen e raportit informues** të parashtruar prej DHKEK- Rajoni Ferizaj. Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 par 3 lidhur me paragrafi 1 të KPK-së.<sup>132</sup>

**IKD:** Bazuar në shënimin zyrtar vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 21.02.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 25.08.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Ferizaj kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 550 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

6. Lënda PPN/I me numër 141/14 vendosur më 07.08.2015. **Shënim zyrtar për mbylljen e raportit informues** të parashtruar prej DHKEK- Rajoni Ferizaj. Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 i KPRK-së.<sup>133</sup>

**IKD:** Bazuar në shënimin zyrtar vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTH në Ferizaj më 10.12.2014, ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.08.2015. Edhe pse me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës për këto raste ishte paraparë që të vendosej brenda 30 ditësh nga pranimi i kallëzimit penal, PTh në Ferizaj kishte nxjerrë vendim pothuajse pas 240 ditëve nga data e pranimit të kallëzimit penal.

7. Lënda PP.I me numër 180-3/11 vendosur më 14.09.2015. **Aktvendim për pushimin e hetimeve** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit” nga neni 339 paragrafi 3 i KPK-së.<sup>134</sup>

<sup>132</sup>Shënim: Sipas shënimit zyrtar të datës 28.08.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 të KPPRK-së ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprën penale të lartëcekur, për arsye senuk ekziston baza për inicimin e procedurës penale.

<sup>133</sup>Shënim: Sipas shënimit zyrtar të datës 07.08.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 82 të KPPRK-së, ka hudhur poshtë kallëzimin penal, për veprën penale të lartëcekur, për arsye senuk ekziston baza për inicimin e procedurës penale.

*IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PTh në Ferizaj më 15.06.2007, ndërsa Prokuroria kishte vendosur t'i fillojë hetimet më 09.12.2013. Koha e trajtimit të kallëzimit penal në këtë rast ka zgjatur 2367 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, në të cilin kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), rezulton se PTh në Prishtinë ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal e ka bërë pas 343 ditëve të llogaritura pas 1 janarit 2013.*

### III – NDËRHJRJET NË PAVARËSINË INDIVIDUALE TË PROKURORËVE NË RASTET E KORRUPSIONIT

IKD konsideron se gjendja shqetësuese e mostrajtit të rasteve të korrupsionit, vërtetohet me analizimin e trendeve të rasteve të pazgjdhura nëpër prokurori, në të cilat ekzistojnë me qindra kallëzime penale të pazgjdhura të parashtruara ndër vite dhe me dekada. IKD ka paraqitur një indikator të tillë në grafikën 3,<sup>135</sup> ku janë identifikuar 66 raste të parashkrimit të lëndëve të korrupsionit nëpër prokurori. Kur këtyre rasteve i shtohen numri i mbi 880 personave ndaj të cilëve janë hudhur poshtë kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet për rastet e korrupsionit, atëherë rezulton se kohëzgjatja e zgjidhjes së rasteve në procedurat penale në sistemin e drejtësisë zgjatë me vite dhe dekada.

IKD vazhdimisht në gjetjet e saj gjatë procesit të monitorimit të prokurorive në trajtimin e rasteve të korrupsionit, ka shprehur shqetësim lidhur me mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve dhe numrin e madh të rasteve të hudhura apo të pushuara. Hudhja dhe pushimi i rasteve të korrupsionit, bazuar në statistikat e prokurorive, rezulton se është shndërruar në një fenomen shqetësues në pothuajse të gjitha prokuroritë, ku mbi 50% të tyre përfundojnë me pushim apo hudhje.

Për këtë arsye, IKD në raportet e saj periodike ka rekomanduar KPK-në, që të themeloj një Komision të përbërë nga prokurorë me përvojë për të analizuar këtë fenomen, dhe për të hartuar një raport lidhur me gjetjet dhe arsyet se pse një numër kaq i madh i rasteve mbyllen në prokurori, duke u hudhur kallëzimet penale apo duke u pushuar hetimet. Rekomandimi i IKD ka pasur për qëllim që KPK të analizoj gjendjen aktuale, të vlerësoj cilësinë e kallëzimeve penale për të identifikuar nëse përgatitja e tyre është e dobët prej parashtruesve apo ka mungesë të profesionalizmit të prokurorëve që t'i trajtojnë këto raste, apo arsyeve tjera që mund të

<sup>134</sup> Shënim: Sipas aktvendimit të datës 14.09.2015, PTh në Ferizaj duke u bazuar në nenin 158 të KPPRK-së, kishte pushuar hetimet për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autorizimit" nga neni 339 paragrafi 3 të KPK-së me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën penale.

<sup>135</sup> Kapitulli "Dështimet e prokurorëve në trajtimin e rasteve të korrupsionit"; Rastet e parashkrimit të ndjekjes penale. Grafika 3.

identifikohen në praktikë. Në bazë të këtyre të gjeturave KPK, do të kishte mundësi të zhvilloj politika për luftimin e suksesshëm të korrupsionit, të mësonte nga gabimet në praktikë që janë zbatuar deri më tani, dhe të adresonte problemin në mënyrë institucionale. IKD ka rekomanduar themelimin e këtij komisioni në pajtim me ligjin e aplikueshëm pasi që Komisioni do të kishte përgjegjësi vetëm në vlerësimin e rasteve të mbyllura me vendim nga prokurorët, dhe çdo vlerësim apo analizë nga ky komision nuk do të mund të konsiderohej ndërhyrje në punën e prokurorëve apo në pavarësinë e tyre të garantuar me Kushtetutë dhe ligj.

Kryeprokurori i Shtetit më 6 tetor 2015,<sup>136</sup> ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.404/2015, për krijimin e një Komisioni Mbikëqyrës për rastet penale të korrupsionit në përbërje me Zëvendës Kryeprokuroren e Shtetit, Sevdije Morina dhe tre prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Lulëzim Sylejmani dhe Laura Pula. Komisioni ka për detyrë të vizitojë të gjitha prokuroritë dhe të kërkoj nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i kanë në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga ta. Pas verifikimit, Komisioni ka për detyrë të përgatisë raport tek Kryeprokurori i Shtetit.

IKD assesi nuk ka rekomanduar dhe nuk pajtohet që të krijohet dhe fuqizohet një Komision i tillë, (*“të kërkojë nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i ka në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga prokurorët e çështjes”*) të cilit i jepet mandat i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me frymën dhe pavarësinë e garantuar me Kushtetutë dhe Ligj për prokurorët gjatë trajtimit të rasteve që i’u janë ndarë në punë.

IKD vlerëson se mandati i këtij Komisioni është i kundërligjshëm dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në pavarësinë e vendimmarrjes së prokurorëve.<sup>137</sup> Ndërhyrjet për të pasur qasje në një lëndë, për t’ia marrë një prokurori dhe për t’ia caktuar një prokurori tjetër, janë drejtë ligjore e përcaktuar ekskluzivisht për Kryeprokurorin e Shtetit, dhe vetëm për raste individuale, dhe një gjë të tillë mund të bëhet përmes vendimit të veçantë në formë të shkruar dhe arsyetuar, por kjo e drejtë assesi nuk mund t’i delegohet dikujt tjetër,

<sup>136</sup> Vendim nga Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi, për Emërimin e Komisionit mbikëqyrës për rastet e korrupsionit; [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr\\_997\\_2015-Vendim-Emerimi\\_i\\_Komisionit\\_mbikeqyres\\_per\\_rastet\\_penale\\_te\\_korrupsionit\\_\(5\).pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr_997_2015-Vendim-Emerimi_i_Komisionit_mbikeqyres_per_rastet_penale_te_korrupsionit_(5).pdf)

<sup>137</sup> *“Garancionet e mos ndërhyrjes në punën e prokurorit individual, përcaktojnë se në shumicën e rasteve vendimi për të ndjekur penalisht duhet të jetë i bazuar vetëm mbi bazën e dëshmive të mjaftueshme. Përfundimisht, në praktikë mund të paraqiten raste kur prokurori do të mund të shkaktonte dëm të interesit më të gjërë, social, ekonomik apo lidhur me çështje të sigurisë. Në ato raste kur interesi publik vihet në pyetje, duhet shtuar kujdesi në mos shkilet sundimi i ligjit, dhe prokurori në këto raste mund të konsultohet me persona që kanë përvojë dhe ekspertizë të veçantë në këto raste, por prokurorit i mbetet në fuqinë e tij për të vendosur nëse ndjekja penale është në interes të publikut. Nëse prokurori pranon ndonjë udhëzim në një rast të tillë, udhëzimi duhet të jetë i arsyetuar dhe kur eshte e mundshme i hapur për publikun”.* REPORT ON EUROPEAN STANDARDS AS REGARDS THE INDEPENDENCE OF THE JUDICIAL SYSTEM:PART II – THE PROSECUTION SERVICE, Adopted by the Venice Commission at its 85th plenary session (Venice, 17-18 December 2010), Fq. 11. Shih [linkun](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/Source/judic_reform/europeanStandards_en.pdf)

sikurse në këtë rast Komisionit. Ndërhyrje të tilla mund të bëhen vetëm për raste të caktuara dhe rrethana specifike, por assesi për të aplikuar gjerësisht për një kategori të veprave penale, sikurse në këtë rast për vepra penale të korrupsionit nga ky Komision, i cili IKD vlerëson se si i tillë ndërhyr rëndë në pavarësinë individuale të prokurorëve në rastet e korrupsionit, pavarësi kjo e garantuar me Kushtetutë, Ligjin për KPK, Ligjin për PSh dhe standardet ndërkombëtare<sup>138</sup>.

## VIII. LLOGARIDHËNIA E PROKURORËVE

### a) Dështimet në Mekanizmin Përcjellës për rastet e korrupsionit

IKD edhe gjatë kësaj periudhe raportuese (korrik, gusht dhe shtator 2015) ka identifikuar raste të regjistruara me vonesë në Mekanizmin Përcjellës, raste të pa-regjistruara në kategorinë e pranuar apo raste të regjistruara drejtpërdrejt në kategorinë e rasteve të zgjidhura, si dhe raste të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, edhe pse të njëjtat lëndë ekzistonin në regjistrat paraprak. Rastet e tilla janë identifikuar në kategorinë e të dhënave PP. Tabela në vijim, ka paraqitur rastet me persona PP të regjistruara me vonesë, raste që nuk ekzistojnë në regjistra si dhe raste të regjistruara tek rastet e zgjidhura.

Tabela e mëposhtme konfirmon dështimet e prokurorive në regjistrimin e rasteve në Mekanizmin Përcjellës, ku nga funksionalizimi i këtij mekanizmi, prokuroritë deri më 30 shtator 2015, kanë regjistruar me vonesë apo nuk kanë regjistruar fare gjithsej 90 raste me 224 persona. IKD gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit, poashtu ka gjetur se nuk janë regjistruar fare apo nuk ekzistojnë në regjistra 43 raste me 102 persona, ndërsa 13 raste me 32 persona janë regjistruar në Mekanizmin Përcjellës vetëm pasi këto raste janë zgjedhur nëpër prokurori. Në total kemi 146 raste me 358 persona, për të cilat PSh, ka dështuar për të raportuar këto rastet të korrupsionit në mekanizmin përcjellës. Edhe përkundër faktit se plani i veprimit ka paraparë obligimin e Kryeprokurorëve të Prokurorive që mbulojnë për të ndërmarr veprime ndaj prokurorëve apo personelit administrativ që kanë dështuar në zbatimin e obligimeve të tyre në trajtimin dhe regjistrimin e rasteve, në praktikë kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

---

<sup>138</sup> Kreu II, Parimet Themelore, Neni 3, Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit. Ligji për Prokurorin e Shtetit. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 30 shtator 2010. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Ligji\\_per\\_prokurorin\\_e\\_shtetit\\_\(shqip\).pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Ligji_per_prokurorin_e_shtetit_(shqip).pdf)

Dështimet e Prokurorive në Mekanizmin Përcjellës	Të regjistruara me vonesë		Nuk ekzistojnë në regjistra		Të regjistruara tek të zgjidhurat		TOTAL	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK	9	59	8	24			17	83
PTh Prishtinë	63	137	18	46	4	18	85	201
PTh Prizren	1	1	7	12			8	13
PTh Pejë	1	1	3	3			4	4
PTh Gjilan	6	11	2	2	1	1	9	14
PTh Mitrovicë	1	1	3	11	2	6	6	18
PTh Ferizaj	4	5					4	5
PTh Gjakovë	5	9	2	4	6	7	13	20
<b>TOTAL</b>	<b>90</b>	<b>224</b>	<b>43</b>	<b>102</b>	<b>13</b>	<b>32</b>	<b>146</b>	<b>358</b>

Tabela 9 – Rastet e mos respektimit të Mekanizmit Përcjellës

Dështimin në lidhje me regjistrimin e rasteve të korrupsionit e ka konstatuar vetë KPK, përmes Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, duke krijuar (shkurt 2014) Komisionin për Mbikëqyrjen dhe Verifikimin e lëndëve të korrupsionit nëpër prokurori<sup>139</sup>. Rezultatet e punës së këtij komisioni, nxorën në shesh papërgjegjshmëri të madhe të një zinxhiri të zyrtarëve nëpër prokurori, prej prokurorëve deri te zyrtarët e stafit mbështetës, të cilët nuk kishin respektuar rregullat e Mekanizmit Përcjellës për regjistrimin e rasteve të korrupsionit në bazën e të dhënave. Këto gjetje dhe rekomandime të Komisionit, ishin miratuar në mbledhjen e KPK-së, të mbajtur më 25 shkurt 2014, ku ishte nxjerrë vendimi me nr. 45-2014<sup>140</sup>, përmes të cilit janë obliguar të gjithë Kryeprokurorët që të iniciojnë masa disiplinore ndaj personave që kanë dështuar të respektojnë rregullat për regjistrimin e lëndëve të korrupsionit në Mekanizmin Përcjellës. Përkundër shkeljeve të shumta të cilat ishin evidentuar nga Komisioni dhe vendimit të prerë të KPK-së që të merreshin masa ndaj personave përgjegjës, Kryeprokurorët asnjëherë nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim për


<sup>139</sup> Raport i Komisionit për mbikëqyrjen dhe verifikimin e të dhënave statistikore, miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës më 5 mars 2014. Shih linkun [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti\\_i\\_Komisionit\\_per\\_mbikqyrjen\\_dhe\\_verifikimin\\_e\\_te\\_dhenave\\_statistikore.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Komisionit_per_mbikqyrjen_dhe_verifikimin_e_te_dhenave_statistikore.pdf)

<sup>140</sup> Vendimi Nr. 45/2014, miratuar me 25 shkurt 2014 nga KPK. Shih linkun

[http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.221.2014-Vendim-Aprovohet\\_Raporti\\_i\\_Njesitit\\_ne\\_luftimin\\_e\\_Korrupsio....pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.221.2014-Vendim-Aprovohet_Raporti_i_Njesitit_ne_luftimin_e_Korrupsio....pdf)

zbatimin e këtij Vendimi, respektivisht nuk kanë iniciuar procedura disiplinore ndaj asnjë prokurori dhe punonjësi, për dështimet e tyre. Duke parë hezitimin e Kryeprokurorëve për të mbajtur përgjegjës zyrtarët e tyre, KPK në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014<sup>141</sup>, ka marrë vendim që Kryeprokurorët e PTh -ve dhe PSRK-së të raportojnë në lidhje me zbatimin e vendimit me nr. 45-2014 të datës 25 shkurt 2014.

KPK përmes këtij vendimi ka kërkuar përgjegjësi drejtpërdrejt nga Kryeprokurorët për mos ndëshkimin e prokurorëve dhe zyrtarëve të tyre për mos regjistrimin e rasteve të korrupsionit. IKD shpreh shqetësimin e dyfishtë për Kryeprokurorët, të cilët nuk e kanë zbatuar vendimin e organit më të lartë në sistemin prokurorial, KPK-së, por gjithashtu shpreh shqetësim të madh për moszbatimin e vendimit nga KPK, për t'i ndëshkuar Kryeprokurorët, në rast se ata, nuk i ndëshkojnë prokurorët dhe punonjësit e tyre për shkeljet e evidentuara. Ky reagim është në vazhden e reagimeve të IKD-së ndaj KPK-së, e cila po dështon të adresojë çështjet më të rëndësishme rreth zbatimit të vendimeve të veta që ndërlidhen me luftimin e korrupsionit në Kosovë.



**Grafika 4 - Rastet e mosrespektimit të Mekanizmit Përcjellës**

<sup>141</sup> Vendimi Nr. 472-2014, miratuar me 25 prill 2014, nga KPK. Shih linkun [http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.472.2014-Vendim-Zbatimi\\_i\\_Vendimit\\_KPK.Nr.45.2014,\\_lidhur\\_me\\_Raportim....pdf](http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.472.2014-Vendim-Zbatimi_i_Vendimit_KPK.Nr.45.2014,_lidhur_me_Raportim....pdf)

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, IKD gjatë tre mujorit të fundit, respektivisht gjatë muajve (korrik, gusht dhe shtator) ka identifikuar gjithsej 27 raste me 91 persona, të cilat janë regjistruara me vonesë, që nuk ekzistojnë në regjistra apo të regjistruara tek të zgjidhurat. Në bazë të grafikonit më lartë, IKD gjen se Prokuroritë kanë regjistruar me vonesë në mekanizmin përcjellës 20 raste me 60 persona, nuk kanë ekzistuar fare në regjistra 6 raste me 17 persona dhe janë regjistruara tek të zgjidhurat 27 raste me 79 persona.

### b) Hetimet disiplinore ndaj prokurorëve si rezultat i gjetjeve të monitorimit të IKD-së

Nga hyrja në fuqi e planit të veprimit deri më 30 shtator 2015, IKD ka publikuar gjashtë (6)<sup>142</sup> raporte periodike të monitorimit si dhe një raport analitik<sup>143</sup> të thuktë rreth dështimeve dhe sfidave që kanë prokuroritë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Pas publikimit të raporteve periodike, gjetjet e IKD-së të evidentuara në rastet e korrupsionit të trajtuara nga prokurorët, kanë shërbyer për ZPD, e cila sipas detyrës zyrtare, ka filluar hetime preliminare për të gjitha këto raste. Si rezultat i raporteve të publikuara nga IKD, ZPD ka trajtuar 93 lëndë të korrupsionit në hetime preliminare, 25 lëndë të korrupsionit janë përfshirë në hetime disiplinore, 17 raste të përfshira në hetime disiplinore, 9 raporte janë dërguar nga ZPD në Komisionin Disiplinor të Këshillit Prokurorial për procedurë disiplinore. Në bazë të raporteve të publikuara nga IKD, poashtu në 4 raste hetimet disiplinore të trajtuara nga ZPD janë mbyllur me gjetje, 4 lëndë hetimet disiplinore janë në procedurë të hetimit, 39 lëndë janë refuzuar, 4 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar, dhe 29 raste janë në fazën e vendosjes nga ZPD.

ZPD gjatë vitit 2014 dhe 2015, ka dërguar në Komisionin Disiplinor të KPK-së, 25 raporte për shkelje të supozuara nga prokurorët. Prej këtyre 25 rasteve, 9 raste janë si rezultat i gjetjeve të IKD-së në raportet e publikuara.<sup>144</sup> Që në përqindje i bie që 36% të raporteve të paraqitura nga ZPD në Komisionin Disiplinor të KPK-së, janë si rezultat i gjetjeve të IKD-së.<sup>145</sup>

<sup>142</sup> Prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit, IKD ka publikuar gjashtë (6) raporte periodike të monitorimit, të cilat mund të shkarkohen në këtë link: (<http://kli-ks.org/publikime/>)

1) Musliu B. dhe Gashi A. "Korrupsioni në Kosovë: Raport vlerësues mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 28 mars 2014, Prishtinë.

2) Musliu B. "Korrupsioni në Kosovë 2: Raport vlerësues gjithëpërfshirës mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 5 shtator 2014, Prishtinë.

3) Musliu B. dhe Nimoni G. "Korrupsioni në Kosovë 3: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 26 dhjetor 2014, Prishtinë.

4) Musliu B. dhe Nimoni G. "Korrupsioni në Kosovë 4: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 8 prill 2015, Prishtinë.

5) Musliu B. dhe Nimoni G. "Korrupsioni në Kosovë 5: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 25 qershor 2015, Prishtinë.

6) Musliu B. dhe Nimoni G. "Korrupsioni në Kosovë 6: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", publikuar më 20 nëntor 2015, Prishtinë.

<sup>143</sup> Musliu B. "Në kërkim të rrugës për luftimin e korrupsionit: Në mes dy zjarreve, persekutimit dhe dështimit", publikuar më 18 gusht 2015, Prishtinë.

<sup>144</sup> Shënim: Gjatë vitit 2014 janë pranuar gjithsej 140 parashtrësia për prokuror nga të cilat pas një hetimi preliminar janë ndërmarr veprime si: Janë refuzuar 84 parashtrësia janë hapur 30 hetime disiplinore për prokuror, prej të cilave ka rezultuar me 6 raporte në Komision Disiplinor Prokurorial dhe janë mbyllur pa gjetje të sjelljes së pretenduar të pahijshme 9 hetime për prokuror, ndërsa prej tyre janë marrë 3 vendime disiplinore nga Komisioni. Gjatë vitit 2015 (Janar -

RASTET E HETIMEVE NGA ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR TË INICUARA PREJ RAPORTEVE TË IKD-SË									
Raportet e publikuara të IKD-së	Lëndë të përfshira në hetime preliminare	Lëndë të përfshira në hetime disiplinore	Raste të përfshira në hetime disiplinore	Hetimet disiplinore të dërguara në Komisionin	Hetime disiplinore të mbyllura me gjetje	Hetime disiplinore në procedurë të hetimit	Lëndë të përfshira në refuzim	Refuzim pas hetimit preliminar	Rastet në fazën e vendosjes
Korrupsioni në Kosovë - I -	26	21	14	6	4	4	5	1	
Korrupsioni në Kosovë - II -	16	1	1	1			15	1	
Korrupsioni në Kosovë - II -	29								29
Korrupsioni në Kosovë-IV -	22	3	2	2			19	2	
<b>Total:</b>	93	25	17	9	4	4	39	4	29

Tabela 10 – Rastet e hetimeve të ZPD-së pas publikimit të raporteve të IKD-së

Nëntor) janë pranuar gjithsej 97 parashtresa për prokuror nga të cilat pas një hetimi preliminar janë ndërmarr veprime si: janë refuzuar 62 parashtresa dedikuar prokurorive, janë hapur 27 hetime disiplinore për prokuror, prej të cilave ka rezultuar me 19 raporte në Komision Disiplinor Prokurorial dhe janë mbyllur pa gjetje të sjelljes së pretenduar të pahijshme 5 hetime për prokuror, ndërsa prej tyre janë marrë 9 vendime disiplinore nga Komisioni. Të dhëna zyrtare të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Nëntor 2015.

<sup>145</sup>“Raportet me gjetjet e IKD-së i kanë shërbyer ZPD-së për të identifikuar sjelljen e mundshme të pahijshme. Bashkëpunimi me IKD në vazhdimësi ka qenë i mirë. Konsiderojmë se, gjetjet nga raportet e IKD-së, procedura hetimore disiplinore dhe procedura disiplinore në Komisionin Disiplinor Prokurorial ka ndikuar që prokuroret të mbahen llogaridhënës dhe puna e tyre të përmirësohet si rezultat i këtyre gjetjeve”, citat i Drejtorit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, z. Zef Prendrecaj. Nëntor 2015.

## IX. MONITORIMI I PROCESVEVE GJYQËSORE NË RASTET E KORRUPSIONIT


IKD prej qershorit 2015 ka filluar zbatimin e projektit për monitorimin e rasteve të korrupsionit edhe në sistemin gjyqësor. Gjatë muajit qershor, monitoruesit e IKD-së kanë vizituar të gjithë Kryetarët e GjTh-ve<sup>146</sup> dhe kanë kërkuar informacione rreth identifikimit të të gjitha rasteve të korrupsionit në punë, përfshi caktimin e lëndëve dhe informacionet se në cilën fazë të procedurës gjenden këto raste. Me përjashtim të GjTh në Prishtinë, e cila është gjykata më e madhe në Republikën e Kosovës, e cila ka marr më shumë kohë për identifikimin e rasteve të korrupsionit në punë, gjykatat tjera kanë arritur të bëjnë më lehtë identifikimin e këtyre lëndëve. Sfidat në identifikimin e rasteve të korrupsionit dhe sigurimin e orarit të seancave gjyqësore kanë qenë dhe mbetin të vazhdueshme për monitoruesit e IKD-së.<sup>147</sup>

Monitoruesit e IKD-së, prej 1 korrikut 2015 deri më 30 nëntor 2015 kanë monitoruar 276 seanca gjyqësore, ku përfshihen 171 raste të korrupsionit me 367 persona. Shih tabelën më poshtë.

---

<sup>146</sup> IKD intervista me Kryetarin e GjTh në Prishtinë, z. Hamdi Ibrahim; Kryetarin e GjTh në Mitrovicë znj. Kada Bunjaku Perçuku; Kryetarin e GjTh në Prizren, z. Ymer Hoxha; Kryetarin e GjTh në Ferizaj, z. Bashkim Hyseni; Kryetarin e GjTh në Pejë, znj. Elmaze Syka; Kryetarin e GjTh në Gjiilan, z. Zyhdi Haziri, Kryetarin e GjTh në Gjakovë, z. Vatton Durguti. Qershor, Korrik, Nëntor 2015.

<sup>147</sup> GjTh-të ende nuk kanë një sistem efikas dhe efektiv të azhurnimit të bazës së të dhënave për orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti për rastet e korrupsionit. Fillimisht, IKD ka vendosur komunikim përmes Kryetarëve të GjTh-ve dhe më pas përmes zëdhënësve të këtyre gjykatave, të cilët kanë informuar monitoruesit e IKD-së për orarin e caktimit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit. Megjithatë, sidomos në fillim, kjo praktikë nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë, sepse zëdhënësit kanë dërguar tek monitoruesit e IKD-së informacione jo të plota për orarin e seancave, gjë që ka shkaktuar probleme për monitorimin e tyre në mungesë të informacioneve. Ky komunikim përditë ka avancuar dhe tanimë është krijuar një sistem më efikas i qasjes në informacionet që ndërlidhen me orarin e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit. IKD është duke shfrytëzuar legjislacionin pozitiv për të pasur qasje në të gjitha informatat e nevojshme rreth këtyre rasteve, por në një të ardhme të afërt, kjo formë e komunikimit me gjyqësorin do të avancojë me formalizimin e ndonjë memorandumi të mirëkuptimit mes IKD dhe KGJK.




**Grafika 5 - Gjendja e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit për secilën gjykatë më 30.09.2015**

Prej këtyre 276 seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD, 85 seanca i takojnë rasteve të korrupsionit në GjTh në Prishtinë, 29 seanca GjTh në Prizren, 25 seanca në GjTh në Pejë, 45 seanca në GjTh në Gjilan, 30 seanca në GjTh në Mitrovicë, 42 seanca në GjTh në Ferizaj dhe 20 seanca në GjTh në Gjakovë. Në këtë periudhë kohore, për shkak të sfidave në sigurimin e orarit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit, ka mundësi që të jenë mbajtur më shumë seanca gjyqësore, por të cilat IKD nuk ka pasur informacion për t'i monitoruar.

**a) Analiza e rasteve të monitoruara për periudhën tre mujore (1 korrik - 30 shtator 2015)**

Në këtë raport, subjekti i hulumtimit dhe analizës janë rastet e korrupsionit të monitoruara në periudhën tremujore korrik, gusht, shtator 2015, ndërsa rastet tjera do të trajtohen në raportin e radhës. Sa i përket këtij tremujori (korrik, gusht, shtator 2015), IKD ka monitoruar 95 seanca gjyqësore, ku përfshihen 60 raste të korrupsionit me 117 persona. Në grafikonin më poshtë janë paraqitur numri i seancave dhe rasteve të korrupsionit të monitoruara nga IKD. Gjithashtu janë paraqitur edhe numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra për arsye të ndryshme.



**Grafika 6 - Rastet e monitoruara gjyqësore në periudhën 01.07.2015 deri më 30.09.2015**

Përgjatë seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD gjatë këtyre tre muajve (korrik, gusht, shtator 2015), janë identifikuar parregullsi të ndryshme. Nga 95 seanca të monitoruara, 83 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e të seancave 12 prej tyre janë shtyrë. Arsyet e shtyrjes së 12 seancave gjyqësore janë:

- Mungesa e të pandehurve/akuzuarve (4)
- Mosdorëzimi i shkresave të lëndës nga Prokuroria (3)
- Mungesa e Prokurorit (2)
- Mungesa e Trupit Gjykues (1)
- Mungesa e avokatëve të palës së dëmtuar (1)
- Mungesa e palës së dëmtuar dhe dëshmitarit (1)

Ndërkaq, parregullsi janë vërejtur edhe në ato seanca që janë proceduar. Prej 83 seancave të mbajtura, 38 prej tyre kanë filluar me mbi 15 minuta vonesë edhe atë: 5 në GJTh Prishtinë, 2 në GJTh Prizren, 1 në GJTh Pejë, 6 në GJTh Gjilan, 11 në GJTh Mitrovicë, 7 në GJTh Ferizaj dhe 6 në GJTh Gjakovë. Si arsye më të shpeshta të vonesës janë identifikuar vonesa e: Gjykatësit/Trupit Gjykses, Prokurorit, në disa raste Avokatit/Mbrojtësit dhe Dëshmitarëve.

Gjatë monitorimit janë vërejtur edhe parregullsi tjera që kanë penguar zhvillimin e seancave gjyqësore, ndër të cilat janë: përdorimi i telefonave celularë nga ana e palëve që marrin pjesë në procedurë, mospërdorimi i mantelit zyrtar nga ana e palëve që detyrohen ta mbajnë të njëjtin, moskoordinimi i Gjykatës me Policinë lidhur me sjelljen e të pandehurit në seancë, vështirësi gjatë përkthimit simultan nga gjuha e huaj në gjuhën shqip edhe anasjelltas, gjë që shkakton konfuzitet te gjykatësit dhe prokurori për rastin në fjalë.

### b) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Zvarritja e zgjidhjes së rasteve me vite të tëra nëpër institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet dështimi më i madh i këtij sistemi në realizimin e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës,<sup>148</sup> të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>149</sup>. Dështimet në trajtimin e rasteve të korrupsionit paraqiten në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshi zvarritjet në polici, prokurori dhe gjykata. Natyrisht, sfidat me lëndët e prapambetura afektojnë lëndët e të gjitha natyrave dhe jo vetëm ato të korrupsionit. Megjithatë, bazuar në prioritetet shtetërore të formalizuara në ligje, strategji dhe plane konkrete të veprimit për të luftuar me prioritet absolut korrupsionin,rezulton se të njëjtat kanë mbetur vetëm dokumente të pazbatuara në praktikë.

Mungesa e rezultateve konkrete në luftimin e korrupsionit ndërlidhet me shumë faktorë. Ndër faktorët kryesor hyjnë ndërhyrjet politike të dy pushteteve në pushtetin gjyqësor. KGJK dhe KPK vazhdojnë të mbështeten minimalisht në aspektin e realizimit të kërkesave buxhetore.<sup>150</sup> Mungesa e resurseve të mjaftueshme buxhetore, pamundëson ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur nga KGJK dhe KPK dhe kjo përkthehet si ndërhyrje e drejtpërdrejtë e politikës në këto institucione. Mungesa e resurseve buxhetore,

<sup>148</sup> Raporti i vjetor i punës 2014, Nr.14. Fq. 137. Avokati i Popullit. Prishtinë 2015. Shih linkun [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI\\_2014\\_-\\_SHQIP\\_932837.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_SHQIP_932837.pdf)

<sup>149</sup> Neni 31 “E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

<sup>150</sup> Buxheti për KGJK përkundër kërkesave të rritura buxhetore, vazhdimisht ka shënuar rënie. Në krahasim me vitin 2015, në vitin 2016 buxheti i KGJK-së është më i vogël. KGJK për vitin 2016 kishte kërkuar 22.054.181 euro, ndërsa janë aprovuar 20.465.770 euro. Shkurtim të buxhetit kishte pasur edhe në vitin 2015, ku KGJK kishte kërkuar 22.729.606 euro, ndërsa ishin aprovuar vetëm 21.288.771 euro. Gjithashtu gjatë vitit 2015, me rishikim të buxhetit, KGJK-së iu kishte shkurtuar buxheti në dy kategori: për linjën buxhetore “paga dhe mëditje” me rishikim ua kanë shkurtuar buxhetin prej 1,041,626 eurove, por jo edhe të pozitave dhe në linjën buxhetore “mallra dhe shërbime” me rishikim ua kanë shkurtuar buxhetin prej 164,449 eurove, përkundër kërkesës për rritje të buxhetit te kjo kategori. Të dhënat zyrtare të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Nëntor 2015. Buxheti i kërkuar nga KPK për vitin 2016 ka qenë 9.527.066.00, ndërsa janë aprovuar 8.013.619.00 euro.

afekton efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë, duke pamundësuar numrin e nevojshëm të prokurorëve dhe gjykatësve.<sup>151</sup> Ky fakt brengosës e ka përcjellë vazhdimisht sistemin prokurorial dhe sistemin e gjyqësor, i cili për çdo vit është ngarkuar me lëndë të pazgjidhura që janë trashëguar. Faktori tjetër më me rëndësi është mungesa e efikasitetit të sistemit të llogaridhënies në raport me prokurorët dhe gjykatësit që vazhdimisht kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre ligjore.

Derisa, Kodi Penal dhe Kodi i vjetër i Procedurës Penale, nuk kishte vendosur kufizime në disa faza të procedurës penale për zgjidhjen e rasteve, Kodi Penal dhe Kodi i ri Procedurës Penale, ka përcaktuar afate strikte kohore për trajtimin e rasteve në secilën fazë të procedurës penale. Gjithë ky avancim në drejtësinë penale, është bërë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Megjithatë, një ndryshim i tillë nuk është përkrahur me resurse të nevojshme që do të mundësonin zbatimin e drejtë të këtyre ligjeve. Respektimi i afateve kohore për trajtimin e rasteve në procedura penale dhe gjyqësore, kërkon resurse të mëdha për t'iu përgjigjur kërkesave që paraqiten në prokurori dhe gjykata. IKD vlerëson se avancimi i legjislacionit penal nuk i është përgjigjur rrethanave dhe kushteve ekzistuese të sistemit të drejtësisë si dhe ka munguar vullneti politik që të njëjtat të ndryshohen pozitivisht për të mundësuar zbatimin e kodeve në praktikë. Ndryshe, nëse do të ekzistonte një vullnet i tillë i pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, pushteti gjyqësor do të kishte mundësinë që të dëshmojë vetën, duke u këndellur, për të realizuar të liritë dhe të drejtat e qytetarëve, duke zbatuar me efikasitet dhe efektivitet dispozitat e dy kodeve, për të trajtuar rastet në një kohë të arsyeshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

IKD në të gjitha raportet periodike të monitorimit të publikuara gjatë vitit 2014 dhe 2015 ka paraqitur gjendjen reale të rasteve të korrupsionit, të cilat janë trajtuar në sistemin e drejtësisë, specifikisht në sistemin prokurorial. Nëpër prokurori ka raste të korrupsionit që janë denoncuar me dekada dhe ende nuk janë trajtuar nga prokurorët. IKD vetëm në gjashtë muajt e fundit të monitorimit të prokurorive, ka arritur të identifikojë 12 raste të korrupsionit të parashkruara. Ndërsa, gjatë monitorimit dy vjeçar, IKD ka arritur të identifikojë 62 raste të korrupsionit të parashkruara nëpër prokurori, problematikë kjo e shtjelluar më lart në këtë raport<sup>152</sup>.

---

<sup>151</sup> IKD intervista me drejtuesit e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, shtatë Kryetarët e Gjykatave Themelore, shtatë Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, ud. Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Shtator, nëntor 2015.

<sup>152</sup> Shih me lartë trajtimin e kësaj problematike në Kapitullin VII. “ Dështimet e prokurorëve në trajtimin e rasteve të korrupsionit”; “I – Rastet e parashkrimit të ndjekjes penale”.

Qasja e bartësve të funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore ndaj problematikës së rasteve të pazgjidhura me vite, duke u arsyetuar me numrin e vogël të prokurorëve, tashmë është shndërruar në retorikë, të cilën e pranojnë vet drejtuesit e sistemit prokurorial<sup>153</sup> dhe gjyqësor.<sup>154</sup> Drejtuesit e sistemit prokurorial dhe gjyqësor, pajtohen se politikat shtetërore dhe politikat e KPK-së dhe KGJK-së për të trajtuar me prioritet trajtimin e rasteve të korrupsionit, kanë dështuar të zbatohen nga prokuroritë<sup>155</sup> dhe gjykatat<sup>156</sup>. Dështimi për të respektuar afatet ligjore dhe politikat për luftimin e veprave penale të korrupsionit ndikojnë në shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në amnistinë e personave të përfshirë në korrupsion. Me qëllim të adresimit të kësaj çështje jo vetëm në rastet e korrupsionit por edhe tek veprat tjera penale, është e domosdoshme që Ministria e Drejtësisë, të konsideroj themelimin e një grupi punues të përbërë me përfaqësues dhe ekspertë nga institucionet që zbatojnë ligjin në Kosovë dhe akterë tjerë të rëndësishëm, për të bërë rishikimin e drejtësisë penale në Kosovë. Rishikimi i drejtësisë penale duhet të përfshijë një analizë të thuktë të ligjeve të miratuara dhe zbatimit të tyre në praktikë, nga institucionet përgjegjëse, identifikimin e problemeve dhe sfidave që paraqiten në praktikë, si dhe dhënien e propozimeve konkrete në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga institucionet e drejtësisë.

IKD përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata, përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, për herë të parë paraqet realitetin e jetës së një lënde të korrupsionit prej kohës së inicimit të kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit. Prej 60 rasteve të monitoruara në 95 seanca gjyqësore në shtatë GjTh, IKD ka identifikuar shkelje në të gjitha procedurat penale të udhëhequra në këto raste të korrupsionit. IKD ka vendosur disa indikatorë për të matur në secilën fazë të procedurës penale kohën e kaluar për trajtimin e rastit përfshi: 1) kohën e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve; 2) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve; 3) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 4) kohën e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 5) kohën e trajtimit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës; 6) koha prej ngritjes së aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar; 7) koha prej shqyrtimit fillestar deri në caktimin e shqyrtimit të dytë; 8) koha prej

<sup>153</sup>“...Unë mendoj që kjo nuk është arsytim numri i vogël e prokurorëve. Ne jemi duke e përdorë këtë argument prej vitit 2000 që është numri i vogël i prokurorëve. Nuk mundemi me thënë që për shkak të numrit të vogël të prokurorëve s’po trajtohen lëndët e korrupsionit. Kemi lëndë të korrupsionit për të cilat s’është marrë asnjë veprim procedural. Edhe nuk mundemi me thënë që aty është numri i vogël por neglizhenca e prokurorëve. Kemi raste që po parashkruhen, me një veprim procedural ja nisë me rrjedhë afati i ri i parashkrimit. Kështu që këto arsytetime që është numri i vogël i prokurorëve për mu janë të papranueshme”, citat i Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh Kryetarit të KPK-së, z. Aleksandër Lumezi. Mbledhja e 100-të e Këshillit Prokurorial të Kosovës, mbajtur më 26.06.2015. Shih linkun në kanal youtube të emisionit “Betimi për Drejtësi” (<https://www.youtube.com/watch?v=JgngHpVQW38>)

<sup>154</sup> IKD intervistë me Kryesuesin e KGJK-së, z. Enver Peci. Nëntor 2015.

<sup>155</sup> Kryeprokurori i Shtetit, njëherësh Kryetari i KPK-së, z. Aleksandër Lumezi. Mbledhja e 100-të e KPK-së, mbajtur më 26.06.2015 dhe Mbledhja e 106-të e KPK-së, mbajtur më 08.10.2015.

<sup>156</sup> IKD intervistë me Kryesuesin e KGJK-së, z. Enver Peci. Nëntor 2015.

*shqyrtimit të dytë deri në caktimin e shqyrtimit kryesor; 9) numri i seancave të mbajtura dhe 10) koha e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë.*

Bazuar në këta indikatorë, IKD ka bërë matjen e 60<sup>157</sup> rasteve të korrupsionit të monitoruara në periudhën tre mujore korrik, gusht, shtator 2015. Gjetjet e IKD-së tregojnë se prokurorët dhe gjykatësit vazhdimisht shkelin afatet e përcaktuara ligjore në Kodin e Procedurës Penale.

Profili i personave të akuzuar në këto 60 raste të monitoruara është i kryesisht i ulët dhe i mesëm dhe janë 4 persona të profilit të lartë. Në mesin e 177 personave të akuzuar në këto 60 raste të monitoruara përfshihen: 12 biznesmen, 5 zyrtarë të ministrive, 7 zyrtarë të bankave, 5 zyrtarë të policisë, 25 qytetarë, 1 punëtor sigurimi, 1 punëtor i ndërtimtarisë, 2 kryetarë të komunave, 1 zyrtarë prokurorimi, 2 drejtorë të shkollave, 1 gjykatës, 2 ekspertë, 11 drejtorë komunal, 15 zyrtarë komunal, 3 mësimdhënës, 1 menaxher i prokurimit, 2 inspektor tatimor, 1 analist kreditor, 2 drejtor të OJQ-ve, 1 arkatare në OJQ, 2 ish-këshilltarë komunal, 1 anëtarë i KGJK-së, 1 kryetar i OSHP-së, 1 menaxher komunal, 1 këshilltar komunal, 1 mjek, 1 infermierë, 3 zyrtarë doganorë, 1 drejtor i prokurorit në ministri, 2 inspektorë komunal, 1 drejtor i spitalit, 1 kryepunëtor në ndërmarrje, 1 punëtor i kompanisë së sigurimit dhe 1 oficer korrektues.

Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur të gjithë indikatorët e fazave të caktuara të procedurës penale dhe mesataren e kohës së kaluar për secilën fazë<sup>158</sup>.

Në fazën e parë është analizuar koha e kaluar prej ngritjes së kallëzimit penal deri në vendimin për fillimin e hetimeve. Për 39 raste të korrupsionit për të cilat IKD ka mbledhur të dhënat, rezulton se prokuroritë kanë kaluar mesatarisht 159 ditë prej kohës së pranimit të kallëzimit penal deri në nxjerrjen e vendimit për fillimin e hetimeve. Bazuar në procedurën e re penale, prej kohës së paraqitjes së kallëzimit penal, prokurori ka kohë që brenda 30 ditëve të vendos nëse do të fillojë hetimin apo të hudhë kallëzimin

<sup>157</sup> *Shënim:* IKD ka pasur sfida të shumta në grumbullimin e të dhënave për të gjitha rastet e korrupsionit të monitoruara. Gjykatësit në raste të caktuara kanë hezituar të japin informacione në lidhje me datat e kërkuara nga IKD për kohën e ngritjes së kallëzimit penal deri te mbajtja e shqyrtimit kryesor. Në disa raste ata kanë kërkuar që këto të dhëna të kërkohen tek prokurorët përkatës të lëndëve. Këta të fundit, në raste të caktuara janë treguar shumë bashkëpunues, por ka pasur raste të hezitimit për të ofruar vetëm datat e ndërmarrjes së këtyre veprimeve ligjore nga ana e prokurorisë. Sidoqoftë, IKD ka krijuar një bazë solide të të dhënave për të bërë matje të kohës që kanë kaluar rastet nëpër të gjitha fazat e procedurës penale.

<sup>158</sup> *Shënim:* Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

penal.<sup>159</sup> Ky kufizim i afatit kohor nuk ka qenë i përcaktuar në procedurën e vjetër penale dhe kjo ju ka krijuar mundësi të keqpërdorimit prokurorëve, të cilët me dekada nuk kanë ndërmarr asnjë veprim ligjor në trajtimin e kallëzimeve penale. Koha prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve mund të marr kohë 24 muaj, eventualisht nëse rasti është i komplikuar hetimi mund të zgjatet nga Gjykata edhe për gjashtë (6) muaj.<sup>160</sup> Prej momentit të ngritjes së aktakuzës në gjykatë deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar, procedura penale ka përcaktuar 30 ditë afat kohor.<sup>161</sup> Koha prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë, duhet të caktohet brenda periudhës jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë.<sup>162</sup> Prej shqyrtimit të dytë, brenda 30 ditëve duhet të caktohet mbajtja e shqyrtimit kryesor.<sup>163</sup> Ndërsa shqyrtimi kryesor duhet të zgjatë prej 90 deri në 120 ditë varësisht nëse

<sup>159</sup> Neni 82, "Hudhja e kallëzimit penal të policisë". 1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen.

2. Prokurori i shtetit menjëherë një kopje të aktvendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni ia dërgon policisë.

3. Prokurori i shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hudhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hudhjen e kallëzimit dhe arsyet për këtë. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>160</sup> Neni 159, "Afatet kohore të hetimit", 1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.

2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.

3. Nëse i pandehuri është arrestuar dhe mbahet në paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake nuk urdhëron vazhdimin nga paragrafi 2. të këtij neni apo vazhdimin e paraburgimit përveç nëse prokurori i shtetit tregon se hetimi po zbatohet në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>161</sup> Neni 242, "Procedura për ngritjen e aktakuzës"; Paragrafët 4 dhe 5; 4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. 5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.


<sup>162</sup> Neni 245, "Shqyrtimi fillestar", paragrafi 5. Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

<sup>163</sup> Kapitulli XIX, SHQYRTIMI GJYQËSOR, Neni 285 Caktimi i shqyrtimit gjyqësor, paragrafi 2) 2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton fillimin e shqyrtimit gjyqësor brenda një (1) muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga urdhri i fundit i lëshuar nga neni 254, paragrafi 5. i këtij Kodi. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012.

gjykohet prej një gjykatësi apo prej trupit gjykues. Ky afat kohor mund të shtyhet me aktvendim të arsyetuar nëse ekzistojnë rrethana specifike për një gjë të tillë.<sup>164</sup>

---

<sup>164</sup> Neni 314, "Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor"; 1. Përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor nga neni 310 i këtij Kodi, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: 1.1. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni; 1.2. nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni. 2. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë me aktvendimin të arsyetuar nga paragrafi 1. i këtij neni kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë, përfshirë por pa u kufizuar në:  
2.1. numër të shumtë të dëshmitarëve; 2.2. dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; 2.3. numri i provave është jashtëzakonisht i madh; 2.4. siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës.  
3. Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë për tridhjetë (30) ditë për secilin aktvendim nga paragrafi 1. i këtij neni.



### Grafika 7 - Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në 60 rastet e monitoruara të korrupsionit

Siç vërehet në tabelë, nga mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në 60<sup>165</sup> rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se prokuroritë dhe gjykatat në faza të ndryshme të procedurës penale bëjnë shkelje të afateve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

- Në 39 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal nga prokurorët është 159 ditë.
- Në 47 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve është 236 ditë.
- Në 47 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 247 ditë.
- Në 4 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 128 ditë.
- Në 11 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejtë është 355 ditë.
- Në 57 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar është 395 ditë.
- Në 22 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë është 49 ditë.
- Në 21 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor është 126 ditë.
- Në 59 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e seancave të mbajtura për secilin rast është 4 ditë.
- Në 8 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit është 255 ditë.

<sup>165</sup> *Sqarim:* IKD bën të qartë se për secilin indikatorë, për të cilët është nxjerrë mesatarja, është bazuar në rastet në të cilat janë kompletuar të dhënat dhe numri i rasteve për secilin indikatorë ndryshon. Pra, siç mund ta vëreni në tabelë, kalkulimet janë bërë vetëm për numrin e rasteve për të cilat ekzistojnë të gjitha të dhënat.

Në vazhdim është analizuar mesatarja e kohës së kaluar në secilën fazë të procedurës penale, për të gjitha rastet e monitoruara për secilën prokurori dhe gjykatë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në trajtimin e kallëzimeve penale janë PTh në Mitrovicë, PTh në Ferizaj, PTh në Prishtinë dhe PTh në Prizren. Mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në vendimin për fillimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

PTh në Mitrovicë për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 294 ditë.  
 PTh në Ferizaj për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 179 ditë.  
 PTh në Prizren për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 114 ditë.  
 PTh në Prishtinë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 107 ditë.  
 PTh në Gjilan për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 59 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në hetimet penale janë PTh në Ferizaj, PTh në Pejë, PTh në Prishtinë dhe PTh në Mitrovicë. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

PTh në Ferizaj për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 329 ditë.  
 PTh në Pejë për 2 raste të monitoruara ka marr kohë 311 ditë.  
 PTh në Prishtinë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 310 ditë.  
 PTh në Mitrovicë për 12 raste të monitoruara ka marr kohë 279 ditë.  
 PTh në Prizren për 7 raste të monitoruara ka marr kohë 164 ditë.  
 PTh në Gjilan për 7 raste të monitoruara ka marr kohë 113 ditë.  
 PTh në Gjakovë për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 106 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzave janë PTh në Mitrovicë, PTh në Ferizaj, PTh në Prishtinë dhe PTh në Prizren. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

PTh në Ferizaj për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 414 ditë.  
 PTh në Pejë për 2 raste të monitoruara ka marr kohë 311 ditë.  
 PTh në Prishtinë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 310 ditë.  
 PTh në Mitrovicë për 12 raste të monitoruara ka marr kohë 279 ditë.  
 PTh në Prizren për 7 raste të monitoruara ka marr kohë 164 ditë.  
 PTh në Gjilan për 7 raste të monitoruara ka marr kohë 113 ditë.  
 PTh në Gjakovë për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 107 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës janë PTh në Ferizaj dhe PTh në Gjakovë. Mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

PTh në Ferizaj për 2 raste të monitoruara ka marr kohë 510 ditë.  
 PTh në Gjakovë për 2 raste të monitoruara ka marr kohë 4 ditë.  
 PTh-të tjera në rastet e monitoruara i kanë ngritur aktakuzat brenda afatit të paraparë ligjor për zhvillimin e hetimeve.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Gjilan dhe GjTh në Prishtinë. Mesatarja e kohës prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

GjTh në Mitrovicë për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 733 ditë.  
 GjTh në Gjilan për 7 raste të monitoruara ka marr kohë 311 ditë.  
 GjTh në Prishtinë për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 274 ditë.  
 GjTh në Ferizaj për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 205 ditë.  
 GjTh në Pejë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 159 ditë.  
 GjTh në Gjakovë për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 121 ditë.  
 GjTh në Prizren për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 94 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë janë GjTh në Gjakovë, GjTh në Prizren dhe GjTh në Gjilan. Mesatarja e kohës prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

GjTh në Gjakovë për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 72 ditë.  
 GjTh në Prizren për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 53 ditë.  
 GjTh në Gjilan për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 38 ditë.  
 GjTh në Prishtinë për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 38 ditë.  
 GjTh në Ferizaj për 2 raste të monitoruara ka marr kohë 30 ditë.  
 GjTh në Pejë për 1 raste të monitoruara ka marr kohë 31 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor janë GjTh në Prishtinë, GjTh në Gjilan dhe GjTh në Ferizaj. Mesatarja e kohës prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:


GjTh në Prishtinë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 796 ditë.  
 GjTh në Gjilan për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 165 ditë.  
 GjTh në Ferizaj për 4 raste të monitoruara ka marr kohë 114 ditë.  
 GjTh në Gjakovë për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 73 ditë.  
 GjTh në Prizren për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 58 ditë.  
 GjTh në Pejë për 1 rast i monitoruar ka marr kohë 39 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Gjilan dhe GjTh në Prishtinë. Mesatarja e kohës prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:


GjTh në Prishtinë për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 525 ditë.  
 GjTh në Pejë për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 611 ditë.  
 GjTh në Prizren për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 447 ditë.  
 GjTh në Gjilan për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 209 ditë.  
 GjTh në Gjakovë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 177 ditë.  
 GjTh në Ferizaj për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 73 ditë.

**c) Kohëzgjatja e rasteve të korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit (10 raste të monitoruara nga IKD)**

Gjatë monitorimit të IKD-së në 60 rastet e korrupsionit, gjykatat kanë shpallur 10 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Në të gjitha këto raste të shpallura aktgjykimet, IKD ka analizuar kohëzgjatjen e secilës fazë të procedurës penale dhe respektimin e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në tabelat në vijim janë paraqitur dy faza të rëndësishme për të matur kohëzgjatjen e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, prej fillimit të kallëzimit penal dhe prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë. Shih tabelat në vazhdim.



**Grafika 8 - Kohëzgjatja prej trajtimit të kallëzimit penal në shpallje të aktgjykimit në 10 raste të monitoruara nga IKD.**



**Tabela 9 - Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpallje të aktgjykimit në 10 raste të monitoruara nga IKD.**

Bazuar në dy grafiket më lartë, IKD ka analizuar në këto 10 raste që kanë përfunduar me aktgjykim të shkallës së parë përgjatë kësaj periudhe të monitorimit (korri, gusht, shtator 2015). Në vazhdim është paraqitur mesatarja e kohëzgjatjes së secilës fazë në procedurën penale, sipas indikatorëve të vendosur nga IKD.

- Mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve në 5 raste të monitoruara ka marrë kohë 109 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve në 9 raste të monitoruara ka marrë kohë 88 ditë.

- Mesatarja e kohës së kaluar prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës në 9 raste të monitoruara ka marrë kohë 88 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejtë në 1 rast të monitoruar ka marrë kohë 190 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar në 9 raste të monitoruara ka marrë kohë 201 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë në 5 raste të monitoruara ka marrë kohë 77 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor në 6 raste të monitoruara ka marrë 145 ditë.
- Mesatarja e numrit të seancave të mbajtura në 10 raste në të cilat është shpallur aktgjykimi në shkallë të parë ka qenë 7 seanca.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në 9 raste të monitoruara ka qenë 159 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit në 10 raste të monitoruara ka qenë 723 ditë.
- Mesatarja e kohës së kaluar prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në 10 raste të monitoruara ka qenë 573 ditë.

Rasti që ka zgjatur më së shumti prej kohës së ngritjes së kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë ka marrë kohë 1405 ditë<sup>166</sup>, ndërsa rasti që ka marrë kohë më të shkurtër ka qenë në 281<sup>167</sup> ditë.

<sup>166</sup> IKD përshkruan detajet e këtij rasti prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda. Numri i lëndës: PPKP no. 144/13; Numri i aktakuzës: PPS.nr.30/2010; Data e parashtrimit të kallëzimit penal: 15.11.2011; Parashtrues: Policia e Kosovës; Data e Aktvendimit për fillimin e hetimeve: 10.12.2011; Data e Aktvendimit për mbarimin e hetimeve: 05.11.2012; Data e ngritjes së aktakuzës: 05.11.2012; Data e shqyrtimit fillestar: Ka pasur dy seanca 28.03.2013 dhe 18.06.2013; Datat e mbajtjes së seancave: 14.04.2014, 13.05.2014, 14.05.2014, 27.05.2014, 28.05.2014, 04.06.2014, 05.06.2015, 16.07.2014, 17.07.2014, 18.07.2015, 12.09.2014, 26.09.2014, 30.09.2014, 04.11.2014, 12.12.2014, 05.01.2015, 23.01.2015, 16.02.2015, 17.04.2015, 22.06.2015, 24.06.2015, 31.07.2015, 17.09.2015. Trupi Gjykoës i përbërë prej dy gjykatësve ndërkombëtarë dhe një vendor. Të akuzuar: N.K., A.Z., S.H., H.B. Data e shpalljes së aktgjykimit: 21.09.2015.

<sup>167</sup> IKD përshkruan detajet e këtij rasti prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit. Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda; Numri i lëndës: PKR. 258/14; Numri i aktakuzës: PP.I.217/14; Data e parashtrimit të kallëzimit penal: 22.10.2014; Parashtrues: NJHKEK Ferizaj; Data e

Përderisa, rasti që ka marr më së shumti kohë nga ngritja e aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë ka marr 1050<sup>168</sup> ditë, ndërsa rasti që ka marr kohë më të shkurtër ka qenë në 242<sup>169</sup> ditë. Analiza e IKD-së lidhur me kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve të korrupsionit, siç mund të vërehet është e kufizuar vetëm në dhjetë rastet të cilat janë monitoruar nga hulumtuesit e IKD-së gjatë periudhës tremujore (korrik, gusht, shtator 2015). Realisht gjendja e paraqitur në këto grafika nuk e reprezenton gjendjen faktike dhe kohën reale që merr një rast i korrupsionit për t’u trajtuar në sistemin e drejtësisë, sidomos jo në fazën prej ngritjes së kallëzimit penal deri në vendimi për hüdhen e kallëzimit penal, fillimin e hetimit, pushimin e hetimit apo ngritjen e aktakuzës. Në raportin e radhës, IKD është duke analizuar një numër shumë më të madh të rasteve të korrupsionit, të cilat janë monitoruar dhe po monitorohen gjatë kësaj periudhe raportuese.

Sa i përket politikë së dënimeve në këto 10 raste të korrupsionit të monitoruara në të cilat është shpallur aktgjykimi në shkallë të parë, rezulton se gjykatësit kanë një politikë të butë ndëshkimore. Në vazhdim është paraqitur tabela e cila pasqyron gjykimet e gjykatësve në këto 10 raste të korrupsionit. Shih tabelën.

Dënim me burg		Dënim me kusht		Dënim me gjobë		Aktgjykim lirues	Hudhje aktakuzës - parashkrim
Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Shuma në euro	Persona	Persona
4	60	1	25	3	10950	5	1

Tabela 10 - Rastet e aktgjykimeve të monitoruara nga IKD

Gjetjet e IKD-së tregojnë se ndaj 13 personave ndaj të cilëve është marr aktgjykim në shkallë të parë, gjykatat, ndaj 4 personave kanë marr aktgjykim me dënim me burg, në total prej pesë (5) viteve për të gjithë personat e dënuar, ku një person është dënuar me 26

Aktvendimit për fillimin e hetimeve: 22.10.2014; Data e Aktvendimit për mbarimin e hetimeve: 30.12.2014; Data e ngritjes së aktakuzës: 31.12.2014; Data e shqyrtimit fillestar: 20.01.2015; Data e shqyrtimit dytësor: 18.02.2015; Datat e mbajtjes së seancave: 18.05.2015, 27.07.2015, 18.07.2015, 30.07.2015. Trupi Gjykues prej tre vendorëve. I akuzuar A.Z. Data e shpalljes së aktgjykimit: 30.07.2015.

<sup>168</sup> Shih fusnotën ? PPKP no. 144/13

<sup>169</sup> Shih fusnotën PKR. 258/14

muaj burg, një person është dënuar me 18 muaj dhe me 3000 euro gjobë, një person me dhjetë muaj burg, dhe një person me 6 muaj burg efektiv.

Përderisa, gjykatat ndaj një personi kanë marr aktgjykim me dënim me kusht, tre persona janë shpallur fajtor dhe dënime me burg janë zëvendësuar me dënime me gjobë në lartësi prej 10950 euro. Ndërsa 5 persona janë liruar me aktgjykim lirues, kurse ndaj një personi është hudhur aktakuza për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

Në përqindje del se gjykatat kanë dënuar me burg efektiv 4 persona, nga 14 persona të akuzuar, që i bie 28.57 % të personave të akuzuar. Ka liruar 5 persona nga 14 të akuzuar, që i bie 35.71 % të personave të akuzuar.

Pa e paragjykuar meritën e vendimmarrjes gjyqësore në rastet konkrete të cilat janë monitoruar nga IKD, shqetësuese mbetet politika ndëshkimore lidhur me rastet e korrupsionit. Praktika e tillë ndëshkimore, duke shqiptuar dënime të buta më burg apo dënime me kusht dhe me gjobë, përçon mesazh negativ tek qytetarët dhe publiku. Po ashtu, këto masa të buta të shqiptuara nuk mund të arrijnë qëllimin e vet për të cilat është shqiptuar dënimi, qoftë atë të karakterit ndëshkimesor ndaj atyre të cilët janë gjetur fajtor se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë tek personat të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit.

#### **d) Dënime për rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës KGJK (nëntë mujori 2015)**


Sistemi gjyqësor ende nuk ka dëshmuar përkushtim për të zbatuar politikën e KGJK-së, përmes të cilave trajtimi i rasteve të korrupsionit konsiderohet prioritet absolut.<sup>170</sup> Njëjtë sikurse në sistemin prokurorial edhe në sistemin gjyqësor mbetet sfida trajtimi me prioritet i lëndëve të korrupsionit.<sup>171</sup> Sindromi i praktikës së moszbatimit të politikave dhe vendimeve të KPK-së nuk dallon shumë as në KGJK sa i përket trajtimit të rasteve të korrupsionit. Numri i rasteve të pazgjidhura të sfidojë gjykatësit, të cilët janë të ngarkuar me lëndë të shumta në punë. Fenomeni i parashkrimit të rasteve të korrupsionit nuk ka kursyer as gjykatësit, të cilët në periudhën 2001-2012 kanë nxjerrë vendime për të parashkruar 32 lëndë të korrupsionit.<sup>172</sup> Gjatë vitit 2014, Gjykatat Themelore kanë

<sup>170</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2012 ka nxjerr vendim për të trajtuar lëndët e korrupsionit si lëndë me prioritet absolut.

<sup>171</sup> IKD intervistë me Kryesuesin e KGJK-së, z. Enver Peci. Nëntor 2015.

<sup>172</sup> Kalaja B. "Parashkruhen lëndët e korrupsionit". Preportr. Sipas këtij artikulli në Preportr parashkrimi i lëndëve të korrupsionit sipas gjykatave komunale (themelore) është si në vazhdim: Ferizaj: 8 lëndë të parashkruara; Prishtina: 7 lëndë të parashkruara; Gjakova: 5 lëndë të parashkruara; Kamenica: 5 lëndë të parashkruara; Istogu: 3 lëndë të parashkruara; Lipjani: 1 lëndë e parashkruar; Theranda: 1 lëndë e parashkruar; Vushtrri: 1 lëndë e parashkruar; Gjithsej 32 lëndë të korrupsionit janë parashkruar përgjatë viteve 2007-2012. Shih linkun <http://preportr.com/sq/Siguri-dhe-Gjyqesi/Parashkruhen-lndt-e-korrupsionit-328>


pasur në punë gjithsej 677 lëndë me 1348 persona. Prej këtyre lëndëve gjykatat kanë zgjidhur 232 lëndë ndaj 313 personave. Gjatë vitit 2015 nuk vërehet trend pozitiv në trajtimin e rasteve të korrupsionit nga gjykatësit. Shih tabelën më poshtë.



Grafika 10 - Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore në nëntëmujorin 2015

Gjykatat Themelore gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2015, kanë pasur në punë gjithsej 559 lëndë me 1239 persona në punë. Nga këto lëndë gjykatat kanë trashëguar nga viti paraprak 2014, 405 lëndë me 953 persona, kurse gjatë këtij nëntëmujor kanë pranuar në

punë 154 lëndë të reja me 286 persona të përfshirë. Gjatë këtij nëntëmujori, gjykatat kanë zgjidhur 123 lëndë me 245 persona. Përderisa në fund të shtatorit 2015, gjykatave iu kanë mbetur në punë të pazgjidhura 436 lëndë me 994 persona. Në bazë të tabelës më lartë shihet se gjykatat kanë zgjidhur më pak lëndë (123) se sa kanë pranuar (154). Poashtu kanë zgjidhur më pak rastet me persona të përfshirë (245) se sa kanë pranuar në punë (286).



Grafika 11 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore në nëntëmujorin 2015

Gjykatat gjatë nëntëmuorit të parë të vitit 2015, nga 123 lëndët e zgjidhura ndaj 245 personave, kanë marrë këto vendime, 28 persona janë dënuar me burgim, 20 persona me dënim me gjobë, 33 persona me dënim me kusht, 90 persona me dënime tjera, 26 persona janë liruar me aktgjykim lirues dhe ndaj 48 personave gjykata ka marr vendim refuzues.

Siç shihet edhe përmes kësaj tabele, vërehet se e njëjta praktikë është zbatuar edhe gjatë tërë nëntëmuorit të parë të vitit 2015, ku numri më i madh e dënimeve të shqiptuara nga gjykatat dënime me gjobë dhe dënime me burg, respektivisht ndaj 53 personave, ndërsa vetëm 28 persona janë dënuar me burgim. Në përqindje duke marr parasysh vetëm këto tri kategori, i bie që gjykatat kanë shpallur dënim me burgim ndaj 34.56 personave të dënuar, kurse ndaj 65.46 personave janë shqiptuar dënime me gjobë apo me dënim me kusht.

Duke parë këtë trend në trajtimin e rasteve të korrupsionit nga gjyqësori, IKD ka analizuar problematikat dhe ka bërë rekomandime konkrete për KGJK-në.<sup>173</sup> IKD në bashkëpunim me Kryesuesin e KGJK-së z. Enver Peci, ka hartuar propozimin e një plani të veprimit për KGJK për trajtimin e lëndëve të korrupsionit me prioritet nga gjykatat. Planit të veprimit<sup>174</sup> është miratuar në mbledhjen e KGJK-së më 25 shtator 2015 dhe menjëherë ka filluar zbatimin e tij nga gjykatat. Në fazën e parë të këtij plani të veprimit, përcaktohet obligimi i Kryetarëve për të identifikuar lëndët e korrupsionit dhe për t'i caktuar ato me prioritet absolut. Monitorimi dhe zbatimin e këtij plani është duke u bërë nga monitoruesit e IKD-së dhe gjetjet kryesore do të publikohen në raportin e radhës.

## X. KONFISKIMI I PASURIVE TË FITUARA PËRMES VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT

Më 21 janar 2014, me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen e kryesve të veprave penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituara me vepër penale, ishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi<sup>175</sup> në mes të KPK, KGJK, Ministrisë së Drejtësisë,

<sup>173</sup> b) Rekomandimet për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. "1. KGJK rekomandohet të hartojë një Plan të Veprimit, i cili i përgjigjet zbatimit të vendimit për të trajtuar me prioritet lëndët e korrupsionit nga gjykatat. Ky plan rekomandohet të përfshijë identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha lëndëve të korrupsionit të cilat janë në punë dhe ndarjen e tyre sipas vjetërsisë së rasteve (që të evitohet mundësia e parashkrimit të rasteve) dhe rëndësisë së rastit (prioritet korrupsionit të nivelit të lartë)." Musliu B."Në kërkim të rrugës për luftimin e korrupsionit: Në mes dy zjarreve, persekutimit dhe dështimit(Analizë dhe rekomandime rreth zbatimit të Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit). Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë. Gusht 2015. Shih linkun <http://kli-ks.org/ne-kerkim-te-rruges-per-luftimin-e-korrupsionit-ne-mes-dy-zjarreve-persekutimit-dhe-deshtimit-2/>

<sup>174</sup> Vendim për miratimin e planit të veprimit për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 25 shtator 2015.

<sup>175</sup> Memorandum Bashkëpunimi, shih në: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014\\_-\\_Memorandum\\_Bashkepunimi\\_fin.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014_-_Memorandum_Bashkepunimi_fin.pdf)

Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Përmes këtij memorandumit palët nënshkruese përcaktonin parimet bazë dhe shprehnin vullnetin për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik (në vazhdim KKLKE).

KPK në pajtim me obligimet e dalura nga ky memorandum i bashkëpunimit me datë 27 dhjetor 2013, kishte miratuar Rregulloren për themelimin dhe funksionalizimin e KKLKE-së.<sup>176</sup>

Përkundër marrëveshjes së nënshkruar në mes të institucioneve të lartë përmendura dhe themelimit të KKLKE-së, respektivisht ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe sekuestrimit dhe konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprë penale, rezultatet në konfiskim të pasurisë së kryesve të veprave penale të korrupsionit mungojnë dhe ende janë të rralla.<sup>177</sup>

Të dhënat zyrtare të mekanizmit përcjellës të KGJK-së për vitin 2014 dhe nëntë mujorin e vitit 2015, tregojnë se në asnjë rast nuk është konfiskuar dobi pasurore e fituar përmes veprës penale të korrupsionit.

Perceptimi i krijuar në opinion publik përmes deklarimeve nga PSh, lidhur me sekuestrimin apo konfiskimin e aseteve të fituara me vepra penale të korrupsionit, në realitet nuk vërtetohet, madje as nga raportet e miratuara nga vet KPK. IKD gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit të sistemit prokurorial për luftimin e korrupsionit, gjatë sigurimit të të dhënave prej shtatë Prokurorive Themelore dhe PSRK-së, si dhe përmes intervistave me Kryeprokurorët<sup>178</sup> rezultojnë me një numër shumë të kufizuar të kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të aseteve të fituara me vepra penale të korrupsionit.

IKD ka kërkuar të dhëna zyrtare nga KKLKE rreth pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara si rezultat i kryerjes së veprave penale të korrupsionit. Zyra e KKLKE nuk ka qenë në gjendje të ofroj të dhëna rreth dobisë pasurore që i është kthyer buxhetit të shtetit si rezultat i sekuestrimit apo konfiskimit nga dënimi i personave për veprave penale të korrupsionit.<sup>179</sup>

---

<sup>176</sup> Rregullore për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për luftimin e krimit ekonomik, Këshilli Prokurorial i Kosovës, 31 mars 2014, shih: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1511.2013-Rregullore\\_per\\_themelimin\\_dhe\\_funksionalizimin\\_e\\_Koordinatorit\\_Kombetare.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1511.2013-Rregullore_per_themelimin_dhe_funksionalizimin_e_Koordinatorit_Kombetare.pdf)

<sup>177</sup> Raporti i Progresit 2015, shih faqe 14: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)

<sup>178</sup> IKD intervista me u.d. Kryeprokurorin e PSRK-së, z. Reshat Millaku, Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë, z. Imer Beka, Kryeprokurorin e PTh në Pejë, z. Agron Galani, Kryeprokurorin e PTh në Gjiçan, z. Jetish Maloku, Kryeprokurorin e PTh në Ferizaj, z. Agron Qalaj, Kryeprokurorin e PTh në Prizren, z. Sylë Hoxha, u.d. Kryeprokurorit të PTh në Mitrovicë, z. Ismet Ujkani dhe u.d. Kryeprokurorin e PTh në Gjakovë, z. Ali Selimaj. Tetor, Nëntor 2015.

<sup>179</sup> IKD komunikim përmes postës elektronike me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, z. Shqipdon Fazliu. Dhjetor 2015.

IKD gjatë monitorimit të rasteve të aktakuzave të publikuara nga PSh për vepra penale të korrupsionit ka gjetur se në rastin e Komunës së Prishtinës, në të cilën PSRK kishte ngritur aktakuzë, thuhet se nga të pandehurit janë konfiskuar dobi pasurore të fituar me veprën penale në vlerë prej 111.740.00 euro, 2.600.00 dollar dhe një (1) banesë 76.3 m<sup>2</sup>. Përderisa në rastin konkret, PSRK konfirmon se dobia financiare nga veprat penale e paraqitur në aktakuzë kap vlerën prej 28.503.922.00 euro, konfiskimi kap vlerën minimale që nuk shkon mbi 200.000.00 euro, apo as 1 % të vlerës së dëmit të shkaktuar.

Përderisa, në bazë të raporteve të KKLKE, që i referohet të gjitha veprave penale, rezulton se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, prokuroritë kanë paraqitur kërkesa për ngrirje apo sekuestrim në vlerë prej 16.123.010,00 euro, përderisa, pothuajse të gjitha prokuroritë kanë raportuar se nuk kanë paraqitur kërkesa për ngrirje apo sekuestrim me përjashtim të një rasti në PTh në Ferizaj, me vlerë prej afërsisht 2.000.000 euro. Po ashtu, sipas raportit të KKLKE të miratuar në KPK, vlera e konfiskimit total të dobisë së fituar me vepër penale është vetëm 64,487.65 euro.

## **XI. REKOMANDIMET**

1. Ministria e Drejtësisë rekomandohet të themeloj grup punues të përbërë me përfaqësues të MD-së, KGJK-së, KPK-së, gjykatës dhe prokurorë me përvojë, ekspert të jashtëm me përvojë dhe ekspertizë nga e drejta penale, ekspertë nga shoqëria civile për rishikimin e drejtësisë penale. Grupi punues rekomandohet të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të gjendjes aktuale lidhur me drejtësinë penale në Kosovë, të identifikoj problemet që paraqitën në praktikë nga zbatuesit e ligjit dhe të del më një raport të detajuar lidhur me veprimet dhe hapat që duhet të ndërmerren me qëllim të zbatimit të drejtë të ligjit penal në Kosovë, respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut, ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies. Rishikimi i drejtësisë penale rekomandohet të përfshij edhe funksionimin dhe rezultatet e çdo mekanizmi apo zyre të themeluar përmes memorandumeve të bashkëpunimit apo ndonjë dokumenti tjetër strategjik me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftimin e korrupsionit.
2. KGJK rekomandohet të monitoroj në mënyrë proaktive Gjykatat Themelore në zbatimin e obligimeve të tyre që dalin nga plani i veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit.

3. Gjykatat Themelore në tërë Kosovën, në veçanti Gjykata Themelore në Prishtinë rekomandohet që rastet e korrupsionit t'i trajtojnë me prioritet absolut.
4. Gjykatat Themelore në tërë Kosovën, në veçanti Gjykata Themelore në Prishtinë, rekomandohet që rastet që paraqitën nga PSRK, t'i trajtojnë me prioritet absolut, duke u siguruar që aktakuzat e paraqitura nga kjo prokurori të trajtohen në pajtim të plotë me afatet e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale.
5. Gjykatat Themelore në tërë Kosovën të ofrojnë transparencë të plotë për publikun, mediat dhe shoqërinë civile në monitorimin e rasteve të korrupsionit në pajtim me ligjin e aplikueshëm.
6. KPK vullnetin dhe përkushtimin e shprehur përmes politikave të miratuara në Këshill, lidhur me luftimin e korrupsionit në Kosovë ta zbatojë në praktike, me veprime konkrete.
7. KPK të ndërtoj mekanizëm efikas të mbikëqyrjes dhe kontrollit të punës së PSRK dhe PTh-ve në trajtimin e rasteve të korrupsionit, duke u siguruar në ruajtjen e pavarësisë individuale të prokurorëve gjatë trajtimit të rasteve të korrupsionit.
8. PSh dhe KPK rekomandohet të ndërmarrin masat urgjente të parapara me ligj, për të luftuar korrupsionin e brendshëm në sistemin prokurorial të Kosovës, respektivisht të ndaloj praktikat e deri tanishme të mos ndëshkimit të prokurorëve, të cilët kanë dështuar në zbatimin e planit të veprimit.
9. KGJK dhe KPK në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë që mbështesin sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës rekomandohet të themelojnë një Komision të përzier me vendorë dhe ndërkombëtarë, për të analizuar të gjitha rastet disiplinore në ZPD, të cilat mund të jenë parashkruar si rezultat i plotësim ndryshimit të ligjeve të gjyqësorit. Komisioni, duhet të përgatisë raport të detajuar lidhur me numrin e rasteve të parashkruara, llojin e rasteve të parashkruara, dhe përgjegjësinë eventuale të zyrtarëve në ZPD, lidhur me këto raste.

10. PSRK rekomandohet të inicioj hetime urgjente lidhur me emërimet e fundit në bordet e pavarura dhe në autoritetet rregullative. PSRK të hetoj lidhur me procesin e emërimit të anëtarëve të këtyre bordeve nëse janë respektuar procedurat dhe ligji i aplikueshëm.
11. PSRK rekomandohet të trajtoj vetëm lëndët e korrupsionit të nivelit të lartë, lëndët e korrupsionit më komplekse dhe sensitive.
12. Kryeprokurori i Shtetit të anuloi Vendimin me numër A.nr.404/2015. 6 tetor 2015 për krijimin e një Komisioni Mbikëqyrës për rastet penale të korrupsionit në përbërje me Zëvendës Kryeprokuroren e Shtetit, Sevdije Morina dhe tre prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Lulëzim Sylejmani dhe Laura Pula. Ky vendim ka përcaktuar që Komisioni ka për detyrë të vizitojë të gjitha prokuroritë dhe të kërkoj nga secili prokuror rastet e korrupsionit që i kanë në punë, për të vlerësuar veprimet e ndërmarra nga ta. Pas verifikimit, Komisioni ka për detyrë të përgatisë raport tek Kryeprokurori i Shtetit. Një vendim i tillë është në kundërshtim me frymën e ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe cenon rëndë pavarësinë e prokurorëve në trajtimin e lëndëve individuale dhe mund të konsiderohet ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e prokurorëve.
13. KPK në bashkëpunim me KGJK, institucionet dhe agjencitë tjera që e zbatojnë ligjin duhet të kenë rol më proaktiv në ngritjen e bashkëpunimit, komunikimit dhe koordinimit në rastet e korrupsionit.
14. KPK rekomandohet të bëjë një vlerësim të gjithëmbarshtëm të zbatimit të obligimeve që dalin nga Plani i Veprimit dhe i njëjti duhet të plotësohet në fushat ku janë paraqitur pengesa në zbatimin e tij; veçanërisht vëmendje duhet t'i kushtohet kualitetit të kallëzimeve penale të hudhura poshtë dhe rasteve kur janë pushuar hetimet, në mënyrë që të zgjidhet kjo problematikë dhe të mundësohet krijimi i politikave adekuate për luftimin e korrupsionit.
15. KPK rekomandohet që përmes plotësimit ndryshimit të Planit të Veprimit, të bëjë kategorizimin e niveleve të korrupsionit nëpër Prokurori; IKD përsëritë rekomandimin për tri kategori që do të përfshinin:
  - a. Kategoria 1 rekomandohet të përfshijë rastet e korrupsionit që hyjnë në kuadër të kompetencës së PSRK-së, të cilat duhet të kenë prioritet absolut. Në këtë kategori do duhej të hynin lëndët ku të dyshuar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit janë personat zyrtar që ushtrojnë funksione të larta, siç janë të përcaktuara në Udhëzimin për caktimin

e korrupsionit të nivelit të lartë të nënshkruar nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokuroreve të EULEX-it;

- b. Kategoria 2 e rasteve të korrupsionit rekomandohet të përfshin të gjitha rastet kur vlera monetare e keqpërdorimit kalon 100.000 Euro dhe këto lëndë do të duhej të trajtoheshin më prioritet absolut.
- c. Kategoria 3 e rasteve të korrupsionit rekomandohet të përfshihen të gjitha rastet që janë parashtruar para vitit 2013, dhe ku do të duhej të caktohej një afat prej maksimum një viti që të njëjtat të përfundohen.

16. KPK rekomandohet të përgatisë formularë që do të përfshiheshin në bazën e të dhënave, ku do të regjistroheshin rastet e zgjidhura, duke përfshirë pozitat e personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet (nëse janë hudhur kallëzimet penale, janë pushuar hetimet apo janë ngritur aktakuza) në mënyrë që të mundësohet identifikimi i saktë i rezultateve të luftës kundër korrupsionit.
17. PSh të identifikoj lëndët që ndërlidhen me prokurimin publik dhe të njëjtat të trajtohen nga prokurorët me përvojë dhe ekspertët anti-korrupsion në PSRK, në koordinim të ngushtë të aktiviteteve dhe veprimeve në mes të prokurorit të rastit me policinë dhe agjencitë tjera të pavarura dhe të specializuara, në trajtimin e këtyre rasteve.
18. KPK të organizoj trajnime të detyrueshme me të gjithë prokurorët lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga ligji për paraqitjen e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale të korrupsionit.
19. KPK urgjentisht të shpall konkurs për prokurorë në PSRK, sipas procedurave të parapara me ligj për plotësimin e pozitave të lejuara në këtë prokurori.
20. KPK urgjentisht të shpall konkursin për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK.